të ardhura të larta, ose do të detyrojë kompanitë të zhvendosen në vendet e tjera, ose të ulin investimet ose do të rezultojë me përjashtime nga puna. Këto kritika janë të pabazuara dhe të pambështetura nga të dhënat. Së pari, shumë vende të Evropës Lindore tashmë kanë braktisur tatimin e sheshtë (Republika Çeke, Sllovakia, Mali i Zi, Shqipëria, Letonia) pa ndonjë efekt të dëmshëm. Përkundrazi, rezultatet ekonomike të këtyre vendeve pas braktisjes së tatimit të sheshtë janë edhe më të mira se më parë (Ministria e Financave, 2018). Së dyti, përvoja jonë me kthimin e tatimit progresiv në 2019 ka treguar se asnjë nga këto kritika nuk është vërtetuar. Pas kthimit të tatimit progresiv në 2019, punësimi u rrit, pagat vazhduan të rriten, madje edhe në sektorët më të paguar si teknologjia informatike, të ardhurat e buxhetit u rritën më shumë sesa pritej dhe aktiviteti ekonomik u përshpejtua (Ministria e Financave, 2019). Kjo nuk do të thotë që nuk duhet pasur kujdes dhe se tatimi progresiv nuk mund t'i bëjë dëm ekonomisë nëse ndryshimi është shumë i madh, por prapëseprapë, nëse është i moderuar, siç ishte me ne në vitin 2019 dhe në vendet e tjera të Evropës Lindore vitet e kaluara, nuk ka asnjë arsye për të pasur frikë.

## REKOMANDIME:

- Në afat kohor sa më të shkurtër të vendoset tatimi progresiv i të ardhurave personale, ku tatimi do të kishte të paktën 3 nivele dhe do të mbulonte të paktën 2% të personave me të ardhura më të larta në vend. Fokusi duhet të përqendrohet veçanërisht në ata më fitimprurës disa promilë, për të cilët do të kishte një normë të veçantë të lartë.
- Të anulohet ose dukshëm të rritet baza maksimale për llogaritjen e kontributeve, në mënyrë që ato të mos jenë regresive. Anulimi do të përfshinte njerëzit me paga mujore më të larta se 10.000 euro (16 paga mesatare bruto) dhe të ardhurat që do të siguroheshin do të ishin të konsiderueshme. - mbi 10 milion euro në vit. Paralelisht, mund të konsiderohet një zhvendosje e lehtë në kufirin e sipërm të pensionit maksimal.
- Të vendoset progresi të të gjitha tatimet mbi pronën - përfshirë tatimin për posedim të pronës, tatim për qarkullim të patundshmërive dhe tatim mbi trashëgiminë dhe dhuratat. Normat aktuale janë ndër më të ulëtat në Evropë. Për shkak se këto të ardhura shkojnë te komunat, me to do të mund të plotësohen nevojat lokale. Njëkohësisht, për të zvogëluar disproporcionin e madh midis normave të tatimit mbi pronën dhe qarkullimit të pasurive të patundshme.
- Seriozisht të mendohet për vendosjen e tatimit progresiv mbi të ardhurat e korporatave për kompanitë me fitime më të larta. Një mundësi është që të mbulohen ndërmarrjet me fitim prej mbi 1 milion euro, të tilla në vend ka rreth 200. Megjithatë nuk bëhet fjalë për numër të madh të ndërmarrjeve, të ardhurat shitesë nga kjo mund të jenë të konsiderueshme, madje edhe më të theksuara sesa tatimi progresiv i të ardhurave personale, pasi fitimet e këtyre ndërmarrjeve janë mjaft të larta. Tatimi progresiv mbi fitimin, për momentin aplikohet në Belgjikë, Francë, Gjermani, Greqi, Spanjë, Hungari, Portugali, Norvegji.
- Tatimet e drejtpërdrejta të ngelin neutrale për nga aspekti sektorial përkatësisht të mos vendosen norma më të ulëta tatimore për sektorë të caktuar. Nëse mbështetja e sektorëve të caktuar është e nevojshme,

ajo duhet të bëhet brenda kornizës së një strategjie industriale, dhe jo përmes tatimeve.

6. Të rriten tatimet për ndotjen, si akciza për karburantin dizel, vendosja e akcizës për qymyr, dhe vendosja graduale e ETS (Emissions Trading System) sistemit të BE-së.
7. Nuk duhet të ketë ndryshime në normat e TVSH-së, përveç ndoshta për produkte të caktuara.
8. Ngadalë të fillohet me shmangien e praktikës së ofrimit të lirimit nga tatimi për investitorët e huaj. Që të realizohet kjo pa "dëbuar" investitorët në vendet e tjera, të iniciohet bashkëpunim rajonal për një politikë të koordinuar tatimore. Kjo do të shmangte "garën drejt fundit", përkatësisht tendencën e vendeve të Ballkanit Perëndimor për të konkurruar me njëri-tjetrin me tatime më të ulëta dhe përjashtime nga tatimet dhe kështu të privoheshin nga të ardhurat e shtetit.
9. Të ndiqen dhe të pranohen shpejtë praktikata evropiane dhe botërore në lidhje me disa tatime dhe praktika të reja, si tatimi digjital, tatimi mbi plastikata të pa riciklueshme, tatimi mbi transaksionet financiare, tatimi mbi pasurinë, etj.
10. Të kryhet revizion i taksave të ndryshme të shërbimeve komunale dhe administrative, dhe detyra të tjera të ngjashme publike që në publik janë prezantuar si tarifa "parafiskale", në mënyrë që të vlerësohet nëse disa prej tyre duhet të eliminohen ose zvogëlohen.
11. Të gjitha këto ndryshime që do të bëhen si pjesë e një strategjie gjithëpërfshirëse të tatimeve shtetërore, e cila do të jetë afatgjatë dhe e pranuar përgjithësisht, përkatësisht do t'i referohet një periudhe prej të paktën 10 vjetësh dhe nuk do të varet nga vullneti personal i individëve, por do të jetë një angazhim strategjik i vendit, siç është, për shembull, angazhimi për anëtarësimin në BE.

#### 4.4. STRATEGJIA E BORXHIT PUBLIK DHE DEFICITIT

Politikat fiskale moderne mbështeten në rregullin që në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme nuk është e nevojshme të ekzistojë bilanc buxhetor dhe se duhet të "sakrifikohet" për të siguruar ekuilibrin makroekonomik. Ekzistenca e cikleve afariste i detyron politikë bërësit fiskalë dhe monetarë të kërkojnë një rrugëdalje dhe të veprojnë në mënyrë anticiklike kur është e nevojshme. Një nga instrumentet fiskalë më të përdorur është krijimi i çekuilibrave buxhetorë, më shpesh deficite, përmes huazimit të shtetit nga sektori privat dhe si pasojë e shfaqjes së borxhit publik.

Ato u përdorën veçanërisht gjatë krizës financiare dhe recesionit të vitit 2008 dhe 2009 dhe sot për të luftuar efektet e pandemisë. Megjithatë, u tregua se efektet mund të jenë modeste. BE-ja, për shembull,


zgjodhi një "stimul monetar të paparë" në të cilin eurozona realizoi një rekord të lartë prej 10 përqind të BPV-së, në programe të ndryshme stimuluese fiskale. Asnjë nga këto nuk e ka ndaluar ekonominë të tregojë shenja të ngadalësimit." (Laccale D, 2020). BPV-ja, e eurozonës, për shembull, në Tr.2/2020 u ul me një rekord 15,0% krahasuar me Tr.2/2019. Shumë ekonomi të tjera kanë marrë masa të kombinuara për të "rritur kostot dhe për të ulur tatimet- për të mbështetur ekonominë e tyre". (J. Honda and H. Miyamoto, 2020). Në kushte të tilla, rëndësia e politikës fiskale madje është rritur, sepse politika monetare është e kufizuar nga ekzistenca e normave të interesit afër zero përqind.

Krijimi i deficiteve buxhetore dhe borxhit publik në Maqedoninë e Veriut është e një date më të re. Në tranzicion kemi hyrë me një nivel relativisht të ulët të BP . Krijimi i tyre intensiv filloi në dy dekadat e fundit përmes përdorimit të tyre në bërjen e politikës fiskale anti-ciklike, por edhe për nevoja politike dhe elektorale. Deficitet e larta u krijuan gjatë dhe pas konfliktit ushtarak (2001-2002) kur deficitet ishin përkatësisht 5,9% dhe 5,2% dhe gjatë periudhës 2012-2015 kur pa nevojë të veçantë arritën nivelin prej 3,5% - 4,2% në vit. Për shkak të pandemisë së Covid-19 në vitin 2020, deficitet mund të kalojnë 8% të BPV-së. Në vitet e tjera, deficitet ishin të moderuara ndërsa në vitin 2005 dhe 2007 kishte suficit të moderuar buxhetor prej 0,2% dhe 0,6%. Zhvillime të tilla kanë rritur borxhin publik të Maqedonisë Veriore nga rreth 25,8% të PBB-së në 2007 në 48,9% në 2019, me shqetësime të justifikuara se gjendja aktuale e BP nga 59,5% në shtator të 2020 ([www.finance.gov.mk](http://www.finance.gov.mk) dhe [www.nbrm.mk](http://www.nbrm.mk)) do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Disa hulumtime tregojnë se stimuli fiskal në ekonominë me popullsi më të re ka efekt të rëndësishëm pozitiv mbi rritjen, dhe efekti është shumë më i dobët në ekonominë me popullsi më të vjetër (J. Honda dhe H. Miyamoto, 2020), por Maqedonia e Veriut as nga kjo nuk përfitoi shumë.

Niveli aktual i BP ka arritur kufirin e kategorisë së vendeve me borxh të lartë (BP 60% e BPV-së) me perspektivën që të mos jetë më në gjendje të kthehet në kategorinë e mëparshme të vendeve me borxh të moderuar. Për të sqaruar - edhe në BE ky kufi prej 60% e BPV-së pranohet si më i larti i lejuar, megjithëse shumica e anëtarëve të eurozonës e tejkalojnë atë edhe në kohën e trajtimit të pasojave të krizës financiare dhe ekonomike të vitit 2008/2009 dhe veçanërisht me deficite të reja të shkaktuara nga pandemia mbi ekonominë. Niveli aktual i BP, të BE-27 është 79,5%, ndërsa e eurozonës 86,3% (Tr. 1, 2020 - grafiku 4.8.) (Eurostat, 2020)

Struktura e borxhit në Maqedoninë e Veriut është e pafavorshme. Financimi i tij angazhon fonde relativisht të mëdha dhe në rritje nga buxheti. Në vitin 2019,

Grafiku 4.8.  
Raport mbi borxhin publik të Qeverisë në raport me PBB, 2020T1, në përqindje



ec.europa.eu/eurostat

Tabela 4.1.  
Situata e borxhit publik në Maqedoninë e Veriut, 2019

(milionë euro)	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Borxhi shtetëror	2.771,6	3.262,5	3.453,3	3.851,5	3.958,5	4.344,4	4.556,8
Borxhi publik i garantuar	509,8	658,9	774,0	859,9	828,4	857,7	942,2
Borxhi publik i pa garantuar	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
<b>Borxhi publik i përgjithshëm*</b>	<b>3.281,4</b>	<b>3.921,3</b>	<b>4.227,2</b>	<b>4.771,4</b>	<b>4.786,9</b>	<b>5.202,2</b>	<b>5.540,9</b>
Borxhi publik i jashtëm	2.078,7	2.725,1	2.847,5	3.286,0	3.187,5	3.537,8	3.709,3
Borxhi publik i brendshëm	1.202,7	1.196,2	1.379,7	1.425,4	1.599,4	1.664,4	1.831,6
<b>Borxhi publik i përgjithshëm si % e BPV</b>	<b>40,3%</b>	<b>45,8%</b>	<b>46,6%</b>	<b>48,8%</b>	<b>47,7%</b>	<b>48,6%</b>	<b>48,9%</b>

\*) Përfshirë vitin 2018, borxhi publik i përgjithshëm është shumë e borxhit shtetëror dhe atij të garantuar. Në vitin 2019 (të T2), borxhi publik përfshin edhe borxhin e pa garantuar të NP dhe SHA të themeluara nga shteti ose nga komunat. Burimi: Ministria e Financave dhe Banka Popullore e RMV-së

për shembull, 145,4 milion euro ose 1,29% e BPV-së janë paguar vetëm për norma interesi, ndërsa në vitin 2018 janë paguar 135,3 milion euro ose 1,26% e BPV-së. (Ministria e Financave, 2020, f. 14).

Në fund të vitit 2019 në strukturën e BP, borxhi i jashtëm publik mori pjesë me 66,9% dhe i brendshmi me 33,1% (tabela 4.1.). Sipas strukturës së normës së interesit, 76,2% kanë normë interesi fikse, ndërsa 23,8% kanë normë interesi të ndryshueshme. Borxhi është kryesisht i euroizuar, kështu që 71,3% e borxhit është në euro, 23,2% në denarë, dhe pjesa tjetër në valuta të tjera (4,4% në SDR). Sipas maturitetit, në vitin 2019 koha mesatare e maturimit të borxhit është 5,36 vjet (i jashtëm 3,97, dhe i brendshëm 7,51 vjet). Kreditorët privatë mbajnë 66,9% të borxhit të jashtëm të vendit.

Situata me nivelin e deficiteve dhe BP në Maqedoninë e Veriut nuk është kritike, por trendi është

shqetësues. Deficitet e përgjithshme të qeverisë janë bërë të konsiderueshme dhe, më e rëndësishmja, ato janë tashmë strukturore. Ato jo vetëm që përdoren si një masë kundër ciklike, por gjithashtu shërbejnë për të kompensuar ndryshimin midis të ardhurave më të ulëta publike dhe nevojave në rritje të shpenzimeve publike. Shteti modern dhe ndërhyrja fiskale që është intensifikuar në botë në dekadën e fundit është vetëm një justifikim shtesë për këtë. Si pasojë, duke pasur parasysh ritmet relativisht të ulëta të rritjes së ekonomisë, BP është në një fazë të rritjes, fundi i së cilës nuk mund të shihet.

Prandaj, vendi në të ardhmen duhet të përballët me një politikë shumë më të fortë dhe më të parashikueshme të deficiteve dhe nivelit të BP, duke përfshirë vendosjen e një sërë rregullash ligjore dhe rregulla të tjera, kryesisht sasiore, të cilat do të zbatohen - të ashtuquajtura "rregulla fiskale", veçanërisht sepse politika monetare e kursit devizor fiks do të duhet të zgjasë

më shumë, kështu që ajo fiskale do të duhet të mbajë një pjesë të madhe të barrës së ruajtjes së kursit devizor. Rregullat fiskale duhet të parandalojnë krijimin e deficiteve të larta buxhetore dhe rritjen e pakontrolluar të BP-së. Disa prej tyre mund të jenë cilësorë, por shumica e tyre mund të jenë sasiorë. Disa nga më të famshmit janë ato të BE-së.<sup>2</sup>

Rregullat fiskale të kuptuara si kufizime numerike për performancën fiskale janë "kufizim i vazhdueshëm i politikës fiskale përmes kufijve të thjeshtë numerikë të agregateve të buxhetit" (Kopits dhe Symanski, 1998, f. 162). Ato duhet të detyrojnë autoritetet të angazhohen për qëndrueshmëri fiskale në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë dhe të zvogëlojnë pasigurinë e politikës fiskale përmes kufizimeve institucionale. Ato përdoren në botë sot me frekuencë në rritje në mënyrë që të kufizojnë diskrecionin në zhvillimin e politikës fiskale dhe të kontrollojnë, të ashtuquajturën "alkimi fiskale që është baza e politikave kapricioze fiskale" (Leeper, 2011). Rregullat fiskale nuk janë garanci e plotë që politikëbërësit nuk do të mund të marrin vendime diskreionale, megjithatë, ato kufizojnë hapësirën për diskrecion dhe largpamësi të politikëbërësve.

Në këtë fazë të zhvillimit, Maqedonia e Veriut duhet të prezantojë rregulla fiskale që do të mundësojnë qëndrueshmërinë e financave publike dhe të përmirësojnë performancën e ekonomisë duke kanalizuar tërë politikën fiskale dhe duke ndihmuar në stabilizimin e ekonomisë, me çka do lejojnë agjentët ekonomikë të optimizojnë sjelljen e tyre (Andritzky, 2011). Disa prej tyre mund të jenë në drejtim të kufizimit të deficitit ose deficitit primar dhe BP-së, përveç në rastet e parashikuara saktësisht; lidhjen e deficitit me nivelin e normës së parashikuar të rritjes së ekonomisë, ose nivelin e investimeve publike; aktivizimin e kufizimeve shtesë nëse pagesat e interesit tejkalojnë nivel të caktuar të BPV-së (për shembull 2%) etj. Në këtë mënyrë, rregullat fiskale nuk duhet të jenë shumë të rrepta dhe nuk duhet të lënë hapësirë për zhvillimin e një politike fiskale autonome të përqendruar në qëllimet e përcaktuara.

Zbatimi i rregullave do të sigurohet me ligj dhe do të duhet të krijohet një organ i posaçëm këshillimor me profil të ulët ekzekutiv, përgjegjës për monitorimin e situatës dhe propozimin e zgjidhjeve. Ai organ do të ishte një lloj "këshilli fiskal" me mandat të bëjë vlerësime dhe monitorim mbi zbatimin e politikës fiskale (Kumar M., 2009). Sipas një studimi të FMN-së (Beetsma & others, 2018, pp. 6-8) ka 39 këshilla të pavarura në botë, 2/3 e të cilave u formuan pas vitit

2008. dhe gjithashtu 2/3 e tyre janë në Evropë. Rregullat fiskale janë të nevojshme për të vendosur kufij për politikanët për të ndjekur interesat e tyre afatshkurtra dhe për të marrë parasysh interesin e shtetit, dhe në të njëjtën kohë rregullat duhet të mundësojnë politikë fiskale anti-ciklike. Këshilli Fiskal i përbërë nga disa ekonomistë cilësorë duhet të monitorojë zbatimin e rregullave fiskale dhe të japë mendime mbi drejtimin e politikës fiskale.

Një mënyrë për të kontrolluar BP në rritje, në ekonomi është trajtimi i vazhdueshëm i normave të rritjes ekonomike që janë më të larta se normat e deficitit. Në planin afatgjatë, kjo do të zvogëlojë pjesën e BP në BPV. Ky opsion është i favorshëm për Maqedoninë e Veriut, por presupozon një disiplinë të përshatshme fiskale pa mundësi për dështime në shkallët e rritjes. "Politika normale fiskale konsiston në huazimin e borxheve që financojnë deficitet rrjedhëse. Kredi të tilla premtojnë suficit më të madh buxhetor në të ardhmen." (Cochrane, 2020, f. 31). Nëse ka dështim të "suficitit buxhetor artificial premtues në të ardhmen", deficitin do të duhet të rregullohet menjëherë, përkatësisht lartësia e shpenzimeve publike.

Një nga problemet serioze strukturore të shpenzimeve publike është niveli i lartë i të ashtuquajturave shpenzime indiskrete që janë jo fleksibile në periudhën afatshkurtër dhe kufizojnë fushën e politikës fiskale. Ato janë mbi 80% të shpenzimeve totale dhe janë të përqendruara për pagesa të pagave, pensioneve dhe mbrojtjes shëndetësore, transferime tek NJVL-të etj. Prandaj, ndryshimet strukturore afatgjata janë të nevojshme në anën e shpenzimeve, veçanërisht në buxhetin qendror për të mundësuar realizimin e funksioneve të BP.

Pandemia shëndetësore aktuale ka shkaktuar përgjigje të paparë ndaj politikave fiskale në botë prej afro 11 mijë miliarda dollarë amerikanë dhe në vendin tonë ka rezultuar me deficit shtesë prej rreth 6% të BPV-së. Për shkak të rënies së theksuar të prodhimit global dhe reagimit masiv fiskal për rritjen e kapaciteteve shëndetësore, për të mbuluar të ardhurat e humbura të familjes dhe për parandalim të humbjeve të mëdha, bota ka përgatitur përgjigje fiskale që "kontribuoi borxhi publik global të arrijë nivelin më të lartë në historinë e vërejtur me mbi 100 përqind të BPV-së globale" (Gaspar and Gopinath, 2020). Por, edhe përpos kësaj për shkak të rritjes së sëmundjeve dhe vdekshmërisë, politikë bërësit, do të duhet të mbajnë prioritetin e financimit ndaj shëndetit publik, ndërsa përgatiten për ndryshimet e mëdha ekonomike në të ardhmen.

2 B. Zbatuar nga Traktati i Mاستrihtit i vitit 1992 dhe Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes të vitit 1997, ato kufizojnë deficitin vjetor në 3% të PBB-së dhe FD në 60% të PBB-së. Rishikimi i vitit 2005 dhe futja e strategjive buxhetore afatmesme siguruan fleksibilitet prej -1% në +2% të PBB-së nëse bëhen rregullime strukturore.

## REKOMANDIME:

1. Trendet e zgjerimit të deficiteve buxhetore aktuale dhe rritjes së BP-së, në Maqedoninë e Veriut janë shqetësuese. Maqedonia e Veriut nuk duhet të hyjë në zonën e vendeve me borxh të lartë dhe çdo vit të ketë probleme me sigurimin e shumave të larta të mjeteve për servisimin e BP-së. Kontrolli dhe ulja e nivelit të BP-së, nuk duhet të bëhet me zvogëlimin e tij rigoroz absolut, por me kombinim matematikor të parashikimeve të ardhshme të deficiteve buxhetore dhe ritmeve të rritjes, ku ekspozimi ndaj rrezikut ndaj ndryshimeve më drastike në rritje në normat e interesit në tregjet financiare ndërkombëtare është më pak i sigurt, por gjithsesi një kërcënim afatgjatë.
2. Duhet me ligj të krijohet rregulla fiskale numerike dhe të formohet organ i posaçëm publik (Agjenci, Këshill, Institut) me funksionin e Këshillit Fiskal klasik që do të kujdeset për zbatimin e rregullave, për analizimin e situatës dhe propozimit të zgjidhjeve.
3. Situata me pandeminë dhe ndikimi i saj në ekonomi duhet të adresohet me kujdes sepse stimuli i madh fiskal në formën e deficiteve të krijuara rishtas nuk mund të japë rezultatet e pritura dhe të rrisë ndjeshëm nivelin e BP-së.
4. Në mënyrë që të sigurohet më shumë hapësirë për zhvillimin e një politike fiskale aktive dhe fleksibile, është e nevojshme të zvogëlohet niveli i të ashtuquajturit shpenzim publike indirekt me rreth 10 - 12 përqind të nivelit aktual dhe t'i jepet më shumë hapësirë shpenzimeve publike diskrete, veçanërisht ato në buxhetin qendror.

## 4.5. NJË VALË E RE E REFORMAVE PËR PËRAFRIM DREJT STANDARDEVE TË BE-SË

Programi për reforma të menaxhimit me financa publike 2018 - 2020 ishte programi i duhur që synonte të vendoste plan afatmesëm për reformimin e të gjithë elementëve të rëndësishëm të sistemit në drejtim të përafrimit drejt standardeve të BE-së, në kundërshtim me praktikën e ndryshimit ad hoc të elementeve të sistemit të financave publike. Ajo u miratua në dhjetor 2017 dhe bazuar në të, u bënë reforma në disa fusha.

Transparenca fiskale u siguroi përmes disa masave: vendosja e buxhetit të qytetarëve; vendosja e detyrimit ligjor për përdoruesit e buxhetit për publikimin e pasqyrave financiare në ueb faqet e tyre; raportim i rregullt mujor dhe tremujor i detajuar i buxhetit të shtetit; publikimi i të gjitha të dhënave të Ministrisë së Financave në format të hapur; pranimi i SDDS +, standardi më i lartë për shpërndarjen statistikore të të dhënave të FMN-së, si vendi i 18-të në botë ndërsa në Evropë si vendi i parë që nuk është vend anëtar i BE-së;

detyrimi ligjor për publikim të plotë të çdo kontratë ose aneks për prokurime publike në ueb faqen për prokurime publike; vendosje e konsultave publike për të gjitha dokumentet kryesore të Ministrisë së Financave - Strategjia Fiskale, Buxheti, Programi i Reformës Ekonomike, etj.; përgatitja e platformës Financa të hapura, e cila publikon realizimin e detajuar të buxhetit në kohë reale.

Mobilizimi më efikas dhe më i drejtë i të ardhurave ishte qëllimi i reformave të mëposhtme: vendosja e tatimit progresiv; prezantimi i legjislacionit për çmimet e transferimit së bashku me përmirësimin e kapacitetit të DAP për monitorimin e tyre; ligj i ri për parandalimin e pastrimit të parave me detyrimin për regjistruar të pronarit të vërtetë. Për më tepër, Ministria e Financave së bashku me Bankën Popullore zbatuan një strategji për uljen e pagesave me para në dorë në ekonomi me synimin të rreptësohen mundësitë e pagesave në ekonominë informale, e cila përbante pesëdhjetë masa, ndërsa një nga më të rëndësishmet ishte ulja e kufirit për pagë me para në dorë nga 15.000 euro në 500 euro.

Reforma pensionale ishte menduar të siguronte funksionimin e qëndrueshëm të FSPI, ndërsa u instalua indeksimi i pensioneve me çmime konsumi dhe rritja e kontributeve sociale.

Reforma e sistemit të transfereve sociale përmes vendosjes së programit për të ardhura minimale të garantuara si vendi i parë në Ballkan, i cili siguroi shënjestrimin më të mirë të shpenzimeve sociale dhe reformën e prokurimeve publike përmes ligjit të ri me të cilin sistemi u harmonizua me direktivat e BE-së.

Digjitalizimi i proceseve në elementët më të rëndësishëm të sistemit u zbatua përmes disa masave.<sup>3</sup>

Përmirësimi i projeksionit në thesarin e Ministrisë së Financave dhe lidhja e tij më e mirë me sektorët e borxhit publik dhe buxhetit, gjë që rezultoi në realizimin jo-selektiv dhe automatik të të gjitha detyrimeve.

Përmirësimi i menaxhimit të borxhit publik përmes stabilizimit të rritjes së borxhit publik (46,6% të BPV-së në vitin 2019 tr. 2), emetimi i Eurobondit me normën më të ulët të interesit, emetimi i parë i letrës me vlerë të brendshëm tridhjetëvjeçarë, ulje e konsiderueshme e normave të interesit në të gjitha letrat me vlerë të vendit dhe rritja e maturitetit të portofolit, e cila rezu-

3 Vendosija e deklaratës elektronike të para-plotësuar për tatim në Drejtorinë e të Ardhurave Publike (DAP), procedura doganore pa letra në Doganat dhe sistemi elektronik për monitorimin e deklaratave doganore, sistemi digjital për këqyrje të plotë nga qytetarët për çdo individ dhe lëndë në Drejtorinë e të Ardhurave Publike (DAP),



Itoi në vitin 2019 me përmirësimin e parë të rejtëngut kreditor për vendin pas 13 vjetësh (që nga viti 2006).

Për më tepër, u bënë ndryshime në procesin e buxhetit të komunave, me rregullin fiskal që kufizonte anën e të ardhurave të mos jetë më e lartë se 10% e mesatares në tre vitet e fundit në mënyrë që të parandalohet krijimi i detyrimeve të papaguara. Ndërkaq është realizuar edhe pastrimi i detyrimeve të papaguara në të gjithë elementët e sistemit të financave publike.

Më vonë, në fund të vitit 2019, disa reforma të rëndësishme u anuluan, si: tatimi progresiv u zëvendësua nga tatimin e sheshtë, kufiri për pagesë me para në dorë u rrit në 3.000 euro dhe rregulli fiskal në komuna u rrit në 30% të mesatares në tre vitet e fundit.

Vala e re e reformave në sistemin e prokurimit publik në periudhë afatmesme mund të bazohet në strategjinë në periudhën nga 2018 në 2020.

## REKOMANDIME:

1. Sigurimi i funksionimit të plotë të të gjitha platformave dhe mjeteve elektronike që sigurojnë transparencën fiskale.
2. Publikimi i deklaratave tatimore të çdo qytetari në ueb faqen DAP në një ditë të caktuar të vitit (për shembull, 1 tetor), në mënyrë që qytetarët përmes këqyrjes së plotë të parandalojnë abuzimet në sistem, siç janë pronarët e kompanive me prona të mëdha të luajtshme dhe të paluajtshme që deklarojnë të ardhura të ulëta, ose persona që punojnë në administratën publike, dhe fitojnë të ardhura shtesë shumë të larta dhe të ngjashme.
3. Përmirësimi i kornizës buxhetore afatmesme përmes forcimit të strategjisë fiskale me buxhetin, vendosja e rregullave fiskale dhe këshillit fiskal, ndryshim të kalendarit buxhetor, por edhe vendosje e mjeteve të reja për planifikimin e programeve të reja midis përdoruesve buxhetor. Reforma gjithashtu duhet të përmirësojë strukturën hierarkike të përdoruesve të buxhetit, duke ngritur një strukturë të qartë të ministrisë që krijon politika, dhe nën të cilën do të ketë agjenci dhe inspektorate që i zbatojnë, duke parandaluar për të njëjtin qëllim, të ketë më shumë agjenci ose agjencitë që nuk janë të varura nga ministria përkatëse dhe të ngjashme.
4. Ndërtimi i sistemit informatik që do të lidhë të gjitha sistemet ekzistuese të pavarura në një sistem të integruar të menaxhimit të financave publike. Sistemi duhet të sigurojë regjistrim në kohë reale të secilit detyrim dhe faturë në mënyrë që të parandalojë plotësisht krijimin e detyrimeve të papaguara. Është e rëndësishme të jepet përparësi këtij projekti të integruar të softuerit, pasi zbatimi i tij do të thotë një hap i madh përpara për sistemin e financave publike në dekadën e ardhshme.
5. Ndërtimi i një sistemi efektiv për krijimin dhe monitorimin e koncesioneve dhe partneriteteve publiko-privat (PPP), të cilat do të jenë pjesë e MF-së, për parandalimin e abuzimeve të mundshme, duke i dhënë opinionit publik qasje në çdo koncesion / PPP dhe zbatimin e tyre.
6. Reformat në sistemin e menaxhimit të ndërmarrjeve publike në mënyrë që të zvogëlohen rreziqet fiskale që lidhen me to.

## LITERATURA E PËRDORUR

**Andritzky Jochen R.**, (2011): "Evaluating Designs for a Fiscal Rule in Bulgaria", IMF WP/11/272, Washington, USA, November 10, 2011

**Beetsma R. & others**, (2018): "Independent Fiscal Councils: Recent Trends and Performance", WP/18/68, IMF, March 2018

**Cochrane J. H.**, (2020): "The Fiscal Theory of the Price Level", 2020

**Eurostat**, (2020): "Government debt", News release 116/2020 – 22 July 2020

**Gaspar V. and Gopinath G.**, (2020): "Fiscal Policies for a Transformed World", web, July 10, 2020

**Honda J. and Miyamoto H.**, (2020): "Aging Economies May Benefit Less from Fiscal Stimulus", 7 Aug. 2020

**Jovanović, Branimir** (2020), "Flat Taxes, Bumpy Economies?", mimeo

**Kopits & Symanski**, (1998): "Fiscal Rules", IMF Occasional paper, Washington, USA, 1998

**Kumar M.**, (2009): "Fiscal rules – Anchoring Expectations for Sustainable Public Finances", Fiscal Department IMF, 2009

**Lacalle D.**, (2020): "Massive Stimulus Won't Prevent a Eurozone Slowdown", Mises Institute, 28.08. 2020

**Ministria e Financave** (2018), „Vendosja e tatimit të drejtë në Republikën e Maqedonisë”, në dispozicion në: <https://finance.gov.mk/files/%D0%92%D0%BE%D0%B2%D0%B5%D0%B4%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5%20%D0%B%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%B5%D0%B4%D0%B5%D0%BD%20%D0%B4%D0%B0%D0%BD%D0%BE%D0%BA%20%D0%B2%D0%BE%20%D0%A0%D0%9C.pdf>

**Ministria e Financave** (2019), "Tevdovski: Arkëtimi i tatimit personal më i lartë se sa pritej, me tatimin e drejtë sigurohen fonde për reformën sociale", në dispozicion në: <https://finance.gov.mk/mk/node/8023>

**Ministria e Financave**, (2020): „Raporti vjetor për menaxhimin e borxhit publik të RMV për vitin 2018”; „ Raporti vjetor për menaxhimin e borxhit publik të RMV për vitin 2019qershor 2020

**World Bank** (2015), "FYR Macedonia Public Expenditure Review – Fiscal Policy for Growth", p. 53, available at: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/895641468269982851/pdf/Macedonia-PER-2015-Revised-for-Submission-Final-clean.pdf>

## 5

POLITIKA MONETARE NË  
PERIUDHËN AFATMESME

GLIGOR BISHEV DHE MARIJA DRENKOVSKA

## HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është, para së gjithash, të ofrojë një analizë të sfidave dhe perspektivave të politikës monetare të Maqedonisë së Veriut. Nga aspekti i kontekstit ndërkombëtar dhe sfidave globale, dhe duke pasur parasysh karakteristikat e ekonomisë kombëtare dhe orientimin strategjik të vendit, ky punim ofron rekomandime për udhëzimet dhe instrumentet optimale të politikës monetare të Maqedonisë së Veriut në periudhë afatmesme. Duke pasur parasysh këto synime, punimi është strukturuar në dy pjesë. Duke pasur parasysh që spiranca e politikës monetare të Maqedonisë së Veriut është politika monetare në Eurozonë, pjesa e parë paraqet përmbledhje të shkurtër të politikave të institucioneve kryesore monetare në botë (me një fokus në Bankën Qendrore Evropiane) në kontekstin e arritjes së qëllimeve monetare, por edhe në kontekstin e ndikimit të këtyre politikave në ekonominë reale. Pjesa e dytë e punimit ofron përmbledhje të aspekteve të përmendura, por me një fokus të vetëm në Maqedoninë e Veriut. Të dy kontekstet përfshijnë përgjigje të politikës monetare ndaj çrregullimeve të shkaktuara nga pandemia e Covid-19. Konkluzioni përmbledh rekomandimet bazuar në analizat e paraqitura.

5.1 PASOJAT MAKROEKONOMIKE  
PËR SHKAK TË INFLACIONIT TË ULËT

Lufta kundër goditjeve të inflacionit dhe zbutja e normave të larta të interesit ishte një sfidë e madhe për bankat qendrore në periudhën midis anulimit të standardit ar- dollar në fillim të viteve 1970 dhe krizës financiare globale të vitit 2008. Zhvillimet globale pas krizës dhe zhvillimet makroekonomike kanë sjellë sfida të reja dhe paralajmërojnë një epokë të re për politikën monetare dhe ekonominë globale në përgjithësi, e mbizotëruar nga norma jashtëzakonisht të ulëta të inflacionit.

*Inflacioni i ulët, nga pikëpamja makroekonomike, është i padëshirueshëm për disa arsye. Ndër të tjera, në nivele të ulëta inflacioni, një goditje relativisht e vogël*


*negative e inflacionit mund të shkaktojë shpejt deflacion, i cili, sipas literaturës mbizotëruese ekonomike, ka disa implikime negative. Së pari, deflacioni shkakton prolongim të konsumit dhe investime për shkak të pritjeve për rënie të mëtejshme të çmimeve. Për më tepër, kombinimi i rënies së çmimeve të mallrave dhe jo elasticitetit të pagave<sup>4</sup> ndikon negativisht në përfitimin e kompanive dhe zvogëlon kërkesën për punë. Dhe së treti, në kushtet e deflacionit, shuma reale e borxhit nominal rritet, gjë që e bën më të vështirë ri pagimin e borxhit për familjet, ndërmarrjet dhe shtetin.*

*Kujtojmë që norma nominale e interesit është shuma e normës reale të interesit dhe inflacionit. Kështu, kombinimi i normave të ulëta reale të interesit dhe dështimi i qëndrueshëm për të arritur objektivin e inflacionit<sup>5</sup> i autoriteteve kryesore monetare (Banka Qendrore Evropiane (BQE), Sistemi i Rezervave Federale (FED), Banka Kombëtare e Kinës, etj.) zvogëlon hapësirën për manovrim të instrumenteve konvencionale të politikës monetare (përmes normës së interesit) në rast të goditjeve të mundshme të pafavorshme. Ilustruar me shembuj, me një normë të qëndrueshme inflacioni prej, për shembull, 2 për qind dhe normë reale interesi prej 0 për qind, autoritetet monetare që synojnë inflacionin kanë hapësirë për manovrim prej 200 pikësh bazë mbi normën nominale të interesit. Në nivele më të ulëta të inflacionit, kjo zonë është më e vogël. Kjo është arsyeja pse normat e ulëta të interesit real që mbizotëruan në dekadën e fundit janë problematike për politikën monetare të bankave kryesore qendrore. Ato kufizojnë hapësirën për të luftuar inflacionin e ulët dhe vonojnë kthimin e inflacionit drejt vlerës së qëllimit.*

4 Në literaturë, joelastikiteti i pagave përshkruhet përmes ngadalësisë me të cilën përshtaten (në këtë rast bëhet fjalë për përshtatje më të ulët) ndaj ndryshimeve në vlerën e tyre reale dhe ndryshimeve të çmimeve.

5 Shënjestrimi i inflacionit është një politikë monetare në të cilën banka qendrore ndjek një objektiv të qartë të inflacionit në periudhën afatmesme dhe ia komunikon atë publikut. Kjo strategji bazohet në supozimin se politika monetare mund të luajë një rol në mbajtjen e rritjes afatgjatë duke ruajtur stabilitetin e çmimeve, i cili, nga ana tjetër, arrihet duke kontrolluar inflacionin. Mjeti kryesor i bankës qendrore në këtë rast janë normat e interesit. (Për më shumë informacion mbi këtë lloj strategjie monetare shih: Jahan, Sarwat. „Inflation Targeting: Holding the Line“. International Monetary Funds, Finance & Development.)

Grafiku 5.1  
Normat kryesore të interesit



Norma reale e ekuilibrit e interesit (e njohur gjithashtu si "norma reale e interesit neutral") në përgjithësi shënon rënie që nga vitet 1980 të shekullit të kaluar. Në shtojcë të kësaj janë vlerat historike të normave bazë të interesit të FED dhe BQE (grafiku 5.1.). Normë e ekuilibruar e interesit (në literaturë zakonisht referohet si ) është ajo ku barazohen nivelet e dëshiruara të kursimeve dhe investimeve. Vlera e saj pasqyron forcat jo-monetare (siç janë faktorët demografikë, produktiviteti dhe prirje ndaj rrezikut<sup>6</sup>) të cilat ndikojnë në normën e dëshiruar të kursimeve dhe investimeve.

Normat e ulëta të interesit janë veçanërisht të rëndësishme për vitet pas krizës financiare globale e cila, me "fundin e dyfishtë" (grafiku 5.2.) solli pasiguri të madhe në ekonomi. Kjo pasiguri ndikoi në uljen e investimeve dhe produktivitetit, rriti kursimet dhe uli oreksin për investime me rrezik më të lartë, të cilat kontribuuan në rritjen e pjesëmarrjes së investimeve të shtetit në portofolat e investimeve.

*Nga perspektiva e politikës monetare, bankat qendrore nuk kanë pasur shumë mundësi në kontekstin e masave monetare konvencionale. Që nga kriza e fundit financiare, përveç normës reale të interesit në ekuilibër të ulët, në dhjetë vitet e fundit, zhvillimet në anën nominale të ekonomisë janë gjithashtu të pafavorshme. Në shumë vende evropiane, tregjet e punës në periudhën pas krizës karakterizohen nga probleme të konsiderueshme në përdorimin optimal të tregut ekzistues të punës (labor market slack) dhe kapacitetit të prodhimit. Duke qenë se në Evropë në periudhën pas krizës pozicioni fiskal nuk ishte në shërbim të stimulimit të kërkesës së brendshme, Banka Qendrore Evropiane*

*plane ndërmerr një kombinim të masave ekspansioniste të politikës monetare si norma kryesore e interesit negativ, program për blerjen e flet obligacioneve qeveritare, ri financim afatgjatë dhe një mënyrë e re e komunikimit me publikun për lëvizjet e ardhshme në normën bazë të interesit (forward guidance<sup>7</sup>)*

*Në favor të përfundimit të mësipërm, dëshmojnë edhe disa analiza (Birdsall & Fukuyama (2011), Rodrik (2006), Stiglitz (2008)) sipas të cilave në kontekstin e vendeve evropiane dhe më gjerë, ngadalësimi i rritjes ekonomike pas krizës financiare globale në një farë mase është pasojë e kthimit të Konsensusit të Uashingtonit<sup>8</sup>, përkatësisht masave për kursim (austerity measures). Rritja e ngadaltë ekonomike që nga kriza e vitit 2008, me gjithë normat e ulëta afatgjata të interesit, ka promovuar hipotezën e "stagnimit sekular". Është një term i shpikur për herë të parë në vitet 1930 nga ekonomisti Keynesian Alvin Hansen, por u rikthye në vitin 2013 nga ish ministri i Financave i SHBA-ve, Larry Summers. Sipas tij, ulja e normave të interesit nuk ka gjasa të kontribuojë në rritjen e investimeve dhe konsumit, dhe përgjigja duhet të kërkohet në rritjen e shpenzimeve publike. Arsyet e rënies së normave reale të interesit janë objekt i studimeve të shumta<sup>9</sup> mirëpo, Rachel & Summers (2019) në studimin e tyre marrin në konsideratë analizat empirike të marrëdhënies midis borxhit dhe normës reale të interesit neutral dhe analizojnë një gamë të gjerë të kanaleve teorike përmes të*


6 Në ekonomi dhe financa, shmangia e rrezikut zakonisht i referohet tendencës për të zgjedhur një veprim që nënkupton ndryshim më të madh në epilogjet monetare të mundshme, krahasuar me një opsion tjetër me më pak ndryshim në rezultate (por vlerë të barabartë të pritshme).

7 BQE filloi këtë mënyrë raportimi me deklaratën për mbajtjen e normave të interesit në nivelin aktual ose më të ulët në periudhën e ardhshme, në kushtet kur pritjet e inflacionit janë të qëndrueshme dhe performanca ekonomike është e dobët. Kjo mënyrë e raportimit, mbi të gjitha, synon të zvogëlojë paqëndrueshmërinë e normës së interesit dhe të stabilizojë pritjet për normën bazë të interesit rreth nivelit të nevojshëm për të ruajtur stabilitetin e çmimeve. (Raporti Tremujor i BPRMV, Tetor 2013 )

8 Krahasimi i politikave të Konsensusit të vjetër dhe të ri të Uashingtonit është paraqitur në Tabelën A1 në Shtojcën A.

9 Përmbledhje e studimeve sasiore mbi këtë temë është dhënë nga Rachel & Summers (2019).

Grafiku 5.2.  
Fundi i dyfishhtë i recesionit në Evropë



Burimi i të dhënave: Eurostat

*cilave realizohet kjo marrëdhënie. Përmes zbrërthimit të tyre të normës reale të interesit në ekonomitë e zhvilluara, ata veçojnë faktorët që qëndrojnë pas trendit në rënie të normës së interesit neutral që janë më të fuqishmit në sektorin privat. Sipas tyre (dhe bazuar në studime të tjera që konfirmojnë gjetjet e tyre), barazimi i kursimeve private dhe investimeve private do të kërkojë mirëmbajtje afatgjatë të normave të ulëta të interesit në vendet e zhvilluara. Vlerësuar, sipas këtij studimi, po flasim për një normë interesi të ekuilibruar midis 1% dhe -2% në 30 vitet e ardhshme.*

## 5.2. PËRGJIGJE NDAJ POLITIKËS MONETARE TË BQE-SË DHE FED-IT, NË KUSHTE TË KOVID PANDEMISË

Ashtu si në krizën e mëparshme, FED u obligua të injektojë sasi të mëdha dollarësh në tregjet financiare botërore dhe me pritjet e tregut që FED do të ndjekë një politikë monetare shumë më ekspansive sesa BQE, vlera e dollarit amerikan në raport me euron, u zvogëlua. Politika e tillë monetare sigurisht që do të ndikojë në dinamikën e kurseve devizore, të cilat nga ana tjetër luajnë një rol të madh në konkurrencën e eksportit. Në këtë drejtim, autoritetet e tjera kryesore monetare kanë shumë pak hapësirë për të manovruar, përveçse të ndjekin politikat lehtësuese të FED dhe BQE.

BQE e bëri këtë përmes: blerje shtesë të 120 miliardë euro të bonove deri në fund të vitit 2020 nën programin ekzistues (APP); dhe ankande të përkohshme shtesë të fondeve për likuiditet të përkohshëm me normë depozite dhe kushte më të favorshme për operacionet ekzistuese të rifinancimit afatgjatë (TLTRO-III) në periudhën midis qershorit 2020 dhe qershorit 2021, me norma interesi që mund


të bien deri në 50 pikë bazë nën normën mesatare të interesit në fondet e depozitave. Kohët e fundit, BQE prezantoi një program të ri të likuiditetit (PELTRO), i cili përbëhet nga një seri operacionesh jo të synuara me rifinancim afatgjatë në kohë pandemie për raste emergjente me normë interesi që është 25 pikë bazë nën normën mesatare të rifinancimit kryesor (MRO) deri në fund të vitit.

## 5.3. KUADRI MONETAR NË MAQEDONINË E VERIUT

Zona valutore e Maqedonisë së Veriut nuk është zona optimale e valutës për sa i përket kërkesave të modelit Mundell-McKinnon. Është një ekonomi e vogël, e hapur, e cila merr pjesë në prodhimin botëror matur sipas BPV-së me 0,015 përqind, është një ekonomi për të cilën janë dhënë çmime ndërkom-bëtare (price taker), me zëvendësim të valutës së lartë (pjesa e depozitave në valutë të huaj në depozitat totale prej 41,2 për qind), me transferime të larta të dërgesave mesatare prej 17 përqind të BPV-së.


*Kjo kufizon jashtëzakonisht shumë zgjedhjen e kornizës monetare për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare dhe e redukton atë në shënjestrimin e kursit devizor. Bartësit e politikës monetare kanë njoftuar zyrtarisht që nga tremujori i katërt i vitit 1995 se kanë ndjekur një strategji të shënjestrimit të kursit devizor të denarit në raport me markën gjermane ndërsa që nga viti 2001 në raport me euron. Megjithëse nuk u plotësuan dy parakushte për shënjestrimin e kursit devizor: hyrja dhe dalja e lirë e kapitalit nga / në vendet e huaja dhe tregjet e zhvilluara të kapitalit, u konsiderua që zëvendësimi i lartë i valutës dhe pjesëmarrja e lartë e dërgesave të parave do të eliminonte këto mangësi. Kjo strategji ishte e suksesshme në uljen e in-*

Grafiku 5.3.  
Burimi: Seri Statistike nga BPRMV-së



Burimi: Seri Statistike nga BPRMV-së

Grafiku 5.4.  
Normat e interesit bazë të BQE, FED dhe BPRMV



Burimi: BPRMV, Bloomberg.


flacionit dhe shtypjen e pritjeve të inflacionit (grafiku 5.3). Mirëpo, me përjashtim të periudhës 2004 - 2008, rritja ekonomike ishte nën potencialin, ndërsa normat e interesit konvergjuan ngadalë drejt normave të interesit në eurozonën, valuta e së cilës shërbeu si spirancë e politikës monetare (grafiku nr. 5.4.).

Për më tepër, në kushte krize, kur politika monetare duhet të akomodohet shpejt, për shkak të rritjes së zëvendësimit të valutës, udhëhequr nga pasiguria dhe zhvendosja në valuta të sigurt dhe ndërprerja e flukseve hyrëse të kapitalit të huaj, politika monetare "shkonte kundër erës", rriste kufizimet dhe forconte efektet e krizës. Kështu, gjatë recesionit të madh 2008-2009, kur normat e interesit dhe politika monetare

në eurozonën, e cila shërben si spirancë e politikës monetare, u lehtësuan, në Maqedoninë e Veriut ato u forcuan dhe normat e interesit u rritën, për shkak të nevojës për mbrojtjen e kursit devizor dhe humbjen e rezervave devizore (grafiku nr. 5.4.). Politika monetare është akomoduar me një vonesë dy-vjeçare, pas shkrirjes së tregjeve financiare ndërkombëtare dhe rritjes së flukseve hyrëse të kapitalit të huaj.


Liberalizimi i plotë i transaksioneve të kapitalit me vendet e huaja u arrit në tremujorin e tretë të vitit 2019. Mos zhvillimi dhe çekëtina e tregut të kapitalit mbeti një faktor kufizues në strategjinë e shënjestrimit të kursit devizor.

Grafikoni 5.5  
Shkallët e rritjes të kredisë



Burimi: Seritë statistikore nga BPRMV

Grafikoni 5.6.  
Shkallët nominale dhe reale të kredisë, %



Burimi: BPRMV dhe llogaritë personale

Megjithatë kjo strategji rezultoi me rritje solide të kredive në dobi të sektorit privat, mesatarisht në nivel vjetor prej 6,5 përqind në periudhën 2009-2019. Mirëpo, rritja e kredive të kompanive (4,7 përqind, mesatarisht në vit) ishte pothuajse dy herë më e ulët se rritja e kredive popullore (8,6 përqind mesatarisht në vit). Në tre vitet e fundit, kreditë e kompanive janë rritur me një normë mesatare vjetore prej 2,9 përqind mesatarisht në vit (grafiku 5.5). Kjo është e pamjaftueshme për dinamizimin e rritjes ekonomike në nivelin e potencialit, edhe pse niveli i borxhit të sektorit korporativ është në nivel të ulët (23,9 përqind të BPV-së).

Shkalla reale bazë e kamatës të BPRMV, në kushte të ekspansionit ekonomik është sjellur në kufi nga 0 deri në 3 përqind në vjet. Për shkak të rrezikut të lartë kreditor, shkallët reale të interesit të kredive në denarë në ndërmarrje kanë lëvizur në zonë prej 4 deri në 7 përqind. Në dy vitet e fundit ata janë sjellur në zonën prej 0,5 deri në 1,5 përqind (grafikoni nr. 5.6.). Megjithatë, në kushte të kontraksionit, në vend të zvogëlimit, shkallët e kamatës janë rritur për shkak të rritjes të zëvendësimit valutor dhe ndërprerjes të prurjes të kapitalit dhe remitencat nga jashtë (viti 2009, shkalla reale bazë e interesit e BPRMV prej 9,2 përqind, përballë 2,8 përqind në vitin 2008 dhe 1,3 përqind në vitin 2008).

Banka popullore e Republikës të Maqedonisë së Veriut, pas recesionit të madh, gjatë dizajnit dhe realizimit të strategjisë të kursit devizor, gjithnjë e më shumë është mbështetur mbi parimet e konsenzusit neo-uashington. Ajo ka pranuar se është i nevojshëm rol më i rëndësishëm i politikës monetare dhe fiskale në stabilizimin e rrjedhave ekonomike. Stabilitet i çmimeve, është bërë qëllimi themelor i politikës monetare, por ajo ka pranuar se duhet të jap një kontribut të konsideruar në stabilizimin e cikleve afariste.

Futja dhe respektimi i standardeve makprudente është bërë po aq e rëndësishëm si edhe mirëmbajtja e stabilitetit të çmimeve. Sigurimi i stabilitetit të sektorit financiar dhe bankar është bërë një çështje kryesore për mirëmbajtjen e stabilitetit të ekonomisë. Banka popullore ka inkuadruar një numër të madh të standardeve makprudente në fushën e fuqisë kapitale të bankave, menaxhimit me rreziqet, sidomos të rrezikut kreditor, standardet për nivelin e huamarrjes, për nivelin e rritjes të kredive, standardet për likuiditetin dhe të ngjajshme. Me këtë është rritur kapaciteti i bankave që të apsorbojnë shokun dhe më lehtësisht që të tejkalojnë gjendjet e krizës.

Edhe krahas asaj që bankat qendrore kanë zgjeruar arsenalin e masave në politikën monetare: a) lehtësimi sasior: për të injektuar drejtpërdrejtë mjetet e tregut të kredive dhe kapitalit dhe të ndikohet në shkallët afatgjate të interesit dhe të bëhet blerja e letrave me vlerë (asset purchases), në pajtim me strategjinë e targetimit të kursit devizor të BPRMV, nuk mund të përdor këtë instrument në përmasa të mëdha, për shkak të faktit se gjatë kësaj strategjie, mjetet që blihen janë devizat-euro b) orientimi afatgjat (2 – 3 vite) të pritjeve (forward guidance) dhe në këtë mënyrë koordinimi dhe ndikimi mbi formimin e pritshmërive afatgjatet

për gjendjen e politikës monetare, sidomos lëvizja e shkallëve afatgjate të interesit dhe lëvizjet makroekonomike. Për shkak të shfrytëzimit të shkallëve të interesit si instrument primar për stabilizimin e kursit devizor, horizonti kohor në të cilin kufizohen projektet monetare të BPRMV janë 12-18 muaj.

Politika fiskale, gjithashtu duhet të jetë orientuar në afat të mesëm dhe të ketë funksion kontraciklik. Funksioni i saj kryesor duhet të jetë stabilizimi i rritjes ekonomike në nivel të atij potencial dhe stabilizimi i deficiteve buxhetore dhe borxhit publik në afat të mesëm.


Edhe pse, futja e kufizimeve devizore dhe tregtare në kushte të recesionit është bërë e lejuar, Maqedonia e Veriut nuk ka ikur drejtë përdorimit të këtyre instrumenteve pas recesionit të madh.

#### 5.4. PËRGJIGJE TË POLITIKËS MONETARE NË KUSHTE TË PANDEMISË ME VIRUSIN KORONA

Reagimi i tregjeve ndërkombëtare financiare me fillimin e krizës me virusin korona ka ndjekur formularin e krizave të mëparshme ekonomike: rritjen e pasigurisë, rritjen e premisë për rrezik në shkallët e interesit, ikja në letra me vlerë të sigurta me rrezik të ulët, zvogëlimin e lëvizjeve të kapitalit në vendet në zhvillim.

Në pajtim me këtë formular të sjelljes, rendimentet e euroobligacionit maqedonas në tregjet ndërkombëtare financiare për periudhën prej 40 ditës janë trefishuar (nga 1,1 përqind në shkurt të vitit 2020 në 3,60 përqind në prill të vitit 2020), duke rritur dallimin

Grafikoni 5.7. Redimentet e euroobligacionit maqedonas të lëshuar në janar të vitit 2018 dhe obligacioni 10 vjeçar i Gjermanisë



Burimi: Bloomberg



në raport me obligacionin gjerman në dhjetë vitet nga 1,7 përqind në 4,10 përqind (grafikoni 5.7). Njëkohësisht, prurja e mjeteve në vend në bazë të remitencave është përgjysmuar dhe largimet në euro dhe dollar janë rritur (rritje të zëvendësimit valutor). Banka popullore është përballur me dilemën – të mbrojë kursin devizor përmes rritjes të shkallëve vendore të interesit në denarë që kanë kërkuar investitorët, apo të përpiqet që në afat të gjatë të relaksojë politikën monetare përmes zvogëlimit të rezervave devizore dhe/ose rritjen e konsideruar të huamarrjes nga jashtë vendit. Duke patur parasysh lartësinë e rezervave devizore, akomodimi i politikës monetare në afat të gjatë, vetëm duke u mbështetur mbi rezervat devizore, nuk është i mundur. Përkundrazi, përpjekja që të mbrohet kursi devizor përmes intervenimeve të pasterilizuara të tregut devizor dhe zvogëlimi i shkallëve të interesit, mund të sjellë deri te humbja e besimit në bankën qendrore në afat të gjatë.

Nëse e shohim nga ai aspekt, bartësit e politikave ekonomike (BPRMV dhe Ministria e financave) kanë vendosur, që në afat të shkurtër të mbrojnë kursin devizor përmes humbjes të rezervave devizore, kurse akomodimi i politikës monetare të mundësohet përmes huamarrjes afatgjate nga jashtë vendit. Kështu, nga fundi i shkurtit të vitit 2020, banka qendrore ka filluar me intervenime të pasterilizuara të tregut devizor, kurse në fund, në mars të vitit 2020, ka zvogëluar shkallën bazë të interesit për 25 pikë bazë (në 1,75 përqind). Në periudhën mars-maj të vitit 2020, banka qendrore ka intervenuar me reth 200 milion euro në tregun devizor. Në fund të majit të vitit 2020, ka vijuar akomodimi shtesë i politikës monetare me zvogëlimin e politikës monetare të shkallës bazë të interesit të BPRMV edhe për 25 pikë bazike në 1,5 përqind, (grafikoni 5.8). Njëkohësisht, është rritur


likuiditeti përmes zvogëlimit të vlerës të bono thesarit që ofrohet në aukcion për 30 përqind.

Njëkohësisht, banka qendrore në koordinim me Ministrinë e financave, kanë arritur që të sigurojnë mjete financiare shtesë në vlerë prej 1,2 miliard euro, që paraqet 9,5 përqind nga PBB. Ndërkohë, përmes Instrumentit për financim të shpejtë nga nga FMN (Rapid Financing Instrument), janë siguruar 177 milion euro; përmes Instrumentit për mbështetje makrofinanciare nga BE (Macro-Financial Assistance) janë siguruar 160 milion euro, kurse nga Banka Botërore janë siguruar 140 milion euro dhe atë përmes Instrumentit për përgjigje urgjente të krizës 50 milion euro (Contingent Emergency Response Crisis) dhe Instrumenti për masa për përgjigje urgjente të Covid -19 90 milion euro (Emergency Covid-19 Response Project). Gjithashtu, përmes lëshimit të euroobligacionit janë siguruar 700 milion euro nga tregjet private financiare. Me atë, politika akomodative monetare do të duhet të jetë e qëndrueshme në afat të mesëm.

Megjithatë, nëse tregohen të sakta parashikimet se kriza aktuale do të jetë në formë të shenjës të brenndit "Najk" (Financial Times, 2020, June 4th), apo edhe më keq, se do të jetë si edhe e mëparshmja e karakterit afatgjatë në formë të "W", atëherë për mirëmbajtjen e afatgjate të politikës akomodative monetare politike ndoshta do të nevojiten mjete të nevojshme shtesë në vlerë prej 5 deri në 8 përqind të PBB.

Ndërkohë, BPRMV në fillim të majit të vitit 2020, ka dalur me projeksion të ri monetar dhe makroekonomik (forward guidance) deri në fund të vitit 2022 pa projeksion për lëvizjen e shkallëve të interesit, me vërejtje se BPRMV do të ndjek zgjuar lëvizjet që të reagojë në mënyrë përkatëse për të njëjtat.

Grafikoni 5.8.  
Shkallët e interesit për bonot e thesarit Janar – Qershor 2020



Burimi: BPRMV

Drejtëpërdrejtë me akomodimin e politikës monetare, banka qendrore ka kryer përshtatjen e standardeve të caktuara makroprudente.

Janë relaksuar standardet për rrezik kreditor deri në fund të vitit 2020 me çfarë është mundësuar që bankat të kryejnë shtyrjen e kthimit të kredive të kompanive dhe popullsisë mesatarisht për gjashtë muaj. Mesatarisht të kompanitë kryhet shtyrja e reth 25 përqind të kredive, kurse të popullsia reth 55 përqind të kredive të përgjithshme në bazë masovike. Në shtator të vitit 2020, bankat kanë kryer edhe një shtyrje të kredive të popullsisë, por kësaj rradhe në bazë individuale, vetëm për personat që kanë mbetur pa punë apo kanë ulje të të ardhurave për më shumë se 10 përqind.

Që të përforcohet fuqia kapitale e bankave, BPRMV, ka rekomanduar mbajtjen e fitimit nga viti 2019. Numri më i madh i bankave kanë respektuar këtë rekomandim dhe nuk kanë bërë pagesën e dividendës.

Nga ajo që është paraqitur është dukshëm e qartë se kapaciteti për akomodim i politikës monetare dhe zbutja e ciklit afarist në kushte të synimit të kursit devizor është i mundur vetëm nëse banka qendrore ka arranzhim të huamarrjes me institucionet e caktuara ndërkombëtare financiare, arranzhim me BQE si Kroacia apo disponon me tepriçë të konsideruar të rezervave devizore dhe/ose fondin valutor që do të kumulohej në periudhat e ekspansionit. Në këtë plan, rekomandojmë përfshirjen e arranzhimit për likudim në kushte urgjente të karakterit të mesëm me FMN që do të qëndronte në dispozicion për akomodimin e politikës monetare, arranzhim suop me BQE dhe/ose formimin e fondit valutor përmes kumulimit të tepriçave të prurjeve të devizave në kushte të ekspansionit. Në këtë plan, tashmë është bërë hapi i parë për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet BQE dhe BPRMV për shfrytëzimin e linjës repo-kreditore prej 400 milion eurosh në kushte të krizës me Kovid, në gusht të vitit 2020. Kushti për përdorimin e këtyre mjeteve ishte mbajtja e instrumenteve financiare të cilat janë në listën për intervenime të BQE. Kjo e kufizon përdorimin e kësaj linje në nivel të rezervave devizore të sistemit monetar të Maqedonisë së Veriut (banka dhe banka qendrore) në nivel të mjeteve devizore të plasuar në letrat me vlerë të klasës të parë në shtetet e eurozonës, që kufizon hapësirën manovruese për përshtatjen e politikës monetare. Akumulimi i tepriçës të devizave mund të bëhet nga prurjet aktuale devizore apo përmes privatizimit të kompanive të caktuara shtetërore.

Ndryshimi i regjimit monetar dhe pranimi i këshillit valutor apo targetimi i inflacionit nuk rekomandohet. Këshilla valutore do të ishte një regjim më rigjid, që do të pamundësonte akomodimin e politikës mone-

tare edhe në afat të shkurtër, pa huamarrje nga jashtë shtetit. Targetimi i inflacionit në kushte të pasigurisë të lartë do të rrëronte besimin në politikën monetare. Në pajtim me këtë, BPRMV në përballjen me shokun ekonomik të shkaktuar nga Kovid -19, rekomandohet që të realizojë regjimin aktual të politikës monetare dhe përparimin e tij me arranzhimin suop të BQE apo FMN. Regjimi ekzistues i politikës monetare rekomandohet edhe për periudhën e konvergencës të përshpejtuar dhe anëtarësimin në BE.

Duke u parë nga ky aspekt, reformat strukturore jo vetëm që përshpejtojnë rritjen ekonomike, por çojnë edhe në zvogëlimin e shkallëve të interesit dhe dallimin ndërmejt shkallëve të interesit në Maqedoninë e Veriut dhe në eurozonë. Në afat të shkurtër, pritet dallimi ndërmjet euroobligacioneve afatgjate gjermne të dhjetë viteve dhe obligacionet maqedonase me maturim të përparë ndërmjet 1,75 dhe 2,25 përqind. Në afat të mesëm parashihet që ky dallim të zvogëlohet ndërmjet 1,25 dhe 1,75 përqind, kurse në periudhën e hyrjes të drejtëpërdrejtë në BE në 0,5 – 1,0 përqind.

## PËRFUNDIM

Kriza me Kovid-19 ka vendosur bankat qendore para përvojave të reja: si mëtutje të akomodohet politika monetare në kushte të shkallëve negative të interesit në vendet me zhvillim të lartë dhe të shmangët gracka e huamarrjes shumë të madhe të sektorit privat.

Vala e re e instrumenteve jokonvencionale të politikës monetare fillohet me qëllim që të mbahet likuiditeti i tregjeve dhe institucioneve financiare dhe të rritet kapaciteti i tregjeve të kapitalit që të apsorbojnë deficitet buxhetore.

Maqedonia e Veriut ka akomoduar politikën monetare përmes huamarrjes të mjeteve devizore nga jashtë shtetit: nga institucionet ndërkombëtare financiare dhe tregjet private financiare. Që të pajiset BPRM ashtuqë në mënyrë më efikase të akomodojë politikën monetare për neutralizimin e shokut ekonomik, në të ardhem, ajo do të duhet të ketë instrument për huamarrje të shpejtë të mjeteve financiare në formë të suopit të pakushtëzuar të arranzhimit me BEQ apo FMN. Alternativa do të ishte formimi i Fondit valutor në periudhën e ekspansionit ekonomik. Ndryshimi i regjimit të politikës monetare ndaj këshillit valutor apo drejtë targetimit të inflacionit, në kushte të krizës me Kovid nuk rekomandohet. Rekomandimi i parë, do të bënte akomodimin e politikës monetare edhe më rigjide, kurse regjimi i dytë mund të sjellë deri te rrënim i besimit në politikën monetare. Me shumë gjasa, Maqedonia e Veriut do të mbajë regjimin e targetimit të kursit devizor deri në anëtarësim në BE

## SHTOJCA A

Tabela 5.1.

Krahasimi i politikave të konsenzusit të Uashingtonit në vitet e 1980-ta – 90-ta dhe politika e institucioneve ndërkombëtare financiare nga viti 2010 e këndeje

Konsenzusi i Uashingtonit 1980-ta – 90-ta	MF nga viti 2010 e këndeje
1. Disiplina financiare dhe zvogëlimi i shpenzimeve.	Njësoj
2. Ridrejtimi i shpenzimeve publike, respektivisht subvencioneve (përveç në mbrojtje dhe ndihmë të kompanive) për mbështetje të rritjes me përjashtim të shpenzimeve të caktuara kundër varfërisë.	Njësoj
3. Reforma tatimore, zgjerimi i bazës të tatimeve të konsumatorëve (TVSH), tatime me të ulëta korporative, tatim i kufizuar i të ardhurave, akciza të ulëta/ jo-ekzistuese dhe tatime për import/eksport.	Në thelb e njëjta
4. Liberalizimi financiar (psh. Zvogëlimi i rregullimit financiar në qëllime të efikasitetit dhe kursimet më të larta, privatizimi i bankave zhvillimore publike, shkallët e interesit të tregut).	Njësoj
5. Kurs konkurrues devizor.	Njësoj
6. Liberalizimi i tregtisë, rritja e bazës të eksportit.	Njësoj.
7. Hapje drejtë investimeve të huaja direkte.	Njësoj.
8. Privatizimi, promovimi i sektorit privat, që është karakterizuar si efikas.	Njësoj
9. Derregullimi (largimi i Deregulation (removal or reduction of public regulations, rules and standards on private sector activities).	Njësoj
10. Sigurimi juridik i të drejtave pronësore.	Njësoj
11. Menaxhimi korporativ	Njësoj.
12. Minimizimi i shtetit, mishërimi i joefikasitetit dhe korrupsionit, kush e kufizon sektorin privat.	Njësoj.
13. Tregjet fleksibile të punës.	Njësoj vetëm me programet aktive të tregut të punës.
14. Hapja prudentet e llogarisë kapitale.	Njësoj, por me masa të makrobonitetit për menaxhimin e rrjedhave kapitale dhe kontrollit si masë përfundimtare në rast të daljeve të mëdha kapitale.
15. Bankat e pavarura qëndrore, targetimi i inflacionit.	Njësoj
16. "Rrjetet e sigurisë" Minimale sociale.	Njësoj
17. Reduktimi i targetuar i varfërisë, mikrokreditëve.	Njësoj.
18. Reforma/privatizim i sistemit pensional.	Reforma pensionale, reduktim të kontributeve për sigurim social, që çon në fonde private.
19. Komerçializim i shërbimeve sociale, mbulimi i shpenzimeve për shpenzimet e realizuara, taksa për përdoruesit, politika minimale sociale.	Njësoj
20. Vëmendje e kufizuar drejtë grupeve sociale, pabarazia dhe burimet e konfliktit social.	Analiza e pabarazisë dhe pakicave; intervenimet e caktuara të drejtuara.

Eshtë marrë nga Ortiz & Cummins (2019) ku është adaptuar në bazë të Williamson (2004, 1–10); Rodrik (2006, 11–17); Stiglitz (2008); UN (2008).

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

**Bishev Gligor**, Reliability of the exchange rate as a monetary target in an unoptimal currency area – Macedonian case, Vienna, December, 1997.

**Бишев Глигор**, Богов Димитар, Финансирање на растот и конвергенција кон ЕУ – Како да се одржи стабилноста при повисока интермедијација, МАНУ, Република Македонија на патот кон Европската Унија (2020) – Искуства, Предизвици, Перспективи, 6 мај i vitit 2016, Shkup.

**Бишев Глигор**, Предизвици на монетарната политика и финансискиот сектор во периодот на забрзано пристапување кон ЕУ, МАНУ, Идни предизвици на економскиот развој и економските политики на Република Македонија, Shkup, 2019.

**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut**, Revizioni i projekteve makroekonomike, maj 2020.

**Birdsall, N.; F. Fukuyama**. 2011. "The Post-Washington Consensus: Development After the Crisis." *Foreign Affairs*, Vol. 90, No. 2, pp 45–53.

**Gordon Paul**, ECB seen with only one choice tomorrow to avoid market rout, Bloomberg, June 3 2020

**Krugman Paul**, How to Create a Pandemic Depression, The New York Times, May 13 2020

**Lütz, Susanne and Kranke, Matthias** (2010) The European rescue of the Washington Consensus? EU and IMF lending to Central and Eastern European countries. LSE 'Europe in Question' discussion paper series (22/2010). The London School of Economics and Political Science, London.

**Nielsen Erik**, Expect Europe's biggest peacetime recession in nearly 100 years, Financial Times, June 4 2022

**Rachel, L and L Summers** (2019), "On Falling Neutral Real Rates, Fiscal Policy, and the Risk of Secular Stagnation", *Brookings Papers on Economic Activity* (forthcoming).

**Rodrik, D.** 2006. "Goodbye Washington Consensus, Hello Washington Confusion?" *Journal of Economic Literature* Vol. XLIV (December 2006), pp. 973–987.

**Stiglitz, J.** 2008. "Is there a Post Washington Consensus Consensus?", in N. Serra and J. Stiglitz (eds.) *The Washington Consensus reconsidered: Towards a new global governance* (Oxford, Oxford University Press).

**United Nations**. 2008. *Policy Notes for National Development Strategies* (New York).

**Williamson, J.** 2004. "A Short History of the Washington Consensus." Paper for the conference From the Washington Consensus towards a new Global Governance (Barcelona, CIDOB)

**Lane, P. R.** (2020), "The monetary policy toolbox: evidence from the euro area", speech at the US Monetary Policy Forum, New York, 21 February;

**Lane, P. R.** (2019), "Determinants of the real interest rate", remarks at the National Treasury Management Agency, Dublin, 28 November.

## 6

# SFIDAT DHE POLITIKAT E TREGUT TË PUNËS NË AFAT TË MESËM

MAJA GEROVSKA – MITEV, NIKOLLA POPOVSKI,  
MILLA CAROVSKA DHE BRANIMIR JOVANOVIQ

## HYRJE

Zhvillimi i shteteve, si në plan ekonomik, ashtu edhe në plan shoqëror, në masë të madhe është kushtëzuar nga lëvizjet e tregut të punës. Ky kushtëzim është me shumë drejtime, dhe kështu tregu i punës është gjithashtu i varur nga specifikat demografike, migruese, arsimore, kulturore dhe të tjera dhe trendet respektivisht tendencat në nivel nacional, por edhe në nivel global. Tregu maqedonas i punës në vitet e 90-ta të shekullit 20 deri sot, ka kaluar në disa transformime duke përfshirë: *ndryshimet strukturore* të shkaktuara nga tërheqja e kontrollit të drejtëpërdrejtë të shtetit mbi ekonominë dhe rritja e pronësisë private, duke rishpërndarë këtë me numrin dhe cilësinë e vendeve të punës në sektor të ndryshëm, degë dhe rajone; *ndryshime institucionale* – përmes përforsimit të dialogut social, inkuadrimit i pluralizmit sindikal, themelimi i agjencive private për punësim dhe të ngjashme.; si dhe *ndryshimet legjislativ* të cilat kanë përforsuar kornizën ligjore për standardet e punës, rrogat minimale dhe politikat aktive të tregut të punës. Nga perspektiva e sotshme, tregu maqedonas i punës sërish ndodhet në nevojë për transformim, si rezultat i disa faktorëve, mes të cilëve gjithsesi edhe përballja me ndikimet më të gjëra nga pandemia me virusin Kovid-19. Në këtë drejtim, ky kapitull dëshiron të theksojë disa prej sfidave kryesore të tregut të punës në afat të mesëm, si dhe masat e mundshme për t'i përmbushur ato.

## 6.1.TRENDET E EMIGRACIONI DHE PLAKJES TË POPULLSISË DHE NDIKIMI I TREGUT TË PUNËS

Puna ka qënë gjithmonë një faktor jashtëzakonisht i rëndësishëm ekonomik dhe zhvillimor të cilës i kushtohet shumë vëmendje. Ajo është karakteristike sepse bënë pjesë në faktorët klasik ekonomik të natyrës jomateriale dhe sipas natyrës të saj është endogjene. Figurat e saj sasiore dhe cilësore janë shumë të rëndësishme për zhvillim ekonomik në afat të shkurtër të mesëm, të gjatë dhe shumë të gjatë. Bartësi i punës është fuqia punëtore, edhe pse në 4-5 deka-

dat e fundit shkenca dhe praktika kanë bërë një dallim të qartë ndërmjet fuqisë punëtore si bartësi i punës me shkathtësitë e saj manuale dhe të tjera fizike nga njëra anë dhe njohuritë dhe shkathtësitë e saj nga ana tjetër. Kjo ka kontribuar në që në tre faktorët ekonomik (resurset natyrore, puna dhe kapitali) të shtohet edhe faktori i katërt në formë të teknologjisë të disponueshme (përparimit teknik) me elementet e tij materiale (teknike) dhe jomateriale (njohuri dhe shkathtësi). E fundit, njohuritë dhe shkathtësitë janë bërë shumë të rëndësishme për ekonominë dhe zhvillimin, për të cilin sot shumë shpesh në ekonominë e zhvilluara, por jo vetëm në ato, flasim si për „ekonomi të bazuara në njohuri” apo “ekonomi të njohurive”, dhe madje edhe “shoqëri të bazuara në njohuri”. Kjo nuk është e rastësishme sepse me matjet statistikore të kontributeve të faktorëve të zhvillimit, tashmë një kohë të gjatë është vërtetuar se pjesëmarrja e tyre nga tre faktorët klasik (të ashtq. TFP) është gjithmonë pothuajse për 50 edhe më shumë përqind nga të gjithë të tjerat bashkë. Sot për këtë pjesë të punës të fuqisë punëtore që ka këto karakteristika, më së shpeshti përdoret shprehja “kapitali njerëzor” (HC). Kur bëhet fjalë për tregun e punës, kjo është tepër e rëndësishme që të përmendet sepse bartësi i atij faktori, siç thamë, është pikërisht fuqia punëtore. Nga ana e tyre, burimi i fuqisë punëtore është popullsia me të gjithë shenjat dhe karakteristikat e saj të njohura.

Popullsia në ekonomi dhe zhvillimin e shoqërisë si tërësi ka një rol të dyfishtë, por edhe konfliktuoz. Të dyfishtë, sepse njëkohësisht paraqitet si bartësi i procesit prodhues, respektivisht të ofertës nga njëra anë, por edhe në anën e kërkesës finale në rolin e konsumatorit përfundimtar të të mirave dhe shërbimeve të prodhuara finale nga ana tjetër. Në rolin e parë është vetëm pjesë e popullsisë, kurse në të dytin është popullsia e përgjithshme. Konfliktuoz, sepse mund të jetë forca lëvizëse e zhvillimit, por edhe më shumë apo më pak faktor kufizues i zhvillimit. Popullsia e tepërt me rritje të shpejtë natyrore dhe me angazhim të pamjaftueshëm ekonomik mund të paraqes pengesë në zhvillim, por edhe anasjelltar, popullsia e pamjaftueshme dhe në mënyrë përkatëse me të edhe fuqia punëtore, mund të pamundësojë shfrytëzimin e tërësishëm të resurseve natyrore dhe sidomos të kapitalit fizik.

Në madhësinë e popullsisë si burim i fuqisë punëtore, në thelb ndikojnë dy faktorë-zhvillimi natyror dhe shkalla e tij (nataliteti-mortaliteti) dhe lëvizjet migruese në dhe nga vendi (imigrimi-emigrimi). Të gjithë këto katër faktor janë pothuajse me rëndësi të barabartë për popullsinë, dhe rrjedhimisht edhe për fuqinë punëtore dhe ekonominë në tërësi.

Lëvizja e popullsisë nga Maqedonia e Veriut kalon në periudhë shumë specifike. Ndodhemi në fazën e zhvillimit kur rritja natyrore dhe bilanci migrues janë negativ dhe me këtë ndikohet në zvoglimin e shpejtë të numrit të popullsisë, dhe rrjedhimisht edhe të fuqisë punëtore, që në masë të madhe mund të ndikojë në tregun e punës.

Nëse e shohim në aspekt historik, popullsia maqedonase në 80 vitet e fundit kishte zhvillim dinamik. Siç mund të shihet edhe nga tabela 6.1., prej 1,15 milionëve në vitin 1948 dhe 1,3 milion në vitin 1953 (Enti shtetëror për statistika, 1988), ajo ka arritur deri në 2,02 milion në vitin 2002 (Enti shtetëror për statistika, 2008).

Në periudhën 1944 – 2002 Maqedonia e Veriut ka kaluar procesin e tranzicionit demografik (periudhë në të cilën shkallët e deriatëhershme të larta të mortalitetit janë zvogëluar shumë shpejtë për shkak të përmirësimit të kushteve të jetës, kurse shkallët e natalitetit një kohë të caktuar janë mbajtur në nivelin e deriatëhershëm të lartë) dhe lirisht mund të vlerësojmë se edhe krahas procesit të lëvizjeve të moderuara emigruese, popullsia është rritur dyfish, e më këtë është rritur edhe numri i fuqisë punëtore dhe popullsisë aktive që paraqiste një nga bazat e zhvillimit të ekonomisë të vendit. Është i njohur fakti se pas vitit 2002 nuk është bërë regjistrimi i popullsisë dhe prandaj të dhënat e tashme janë mjaftë të pasigurta për analizë. BE vlerëson se në 1 janar të vitit 2019 në Maqedoninë e Veriut ka 2.1 milion banorë prej të cilëve 16.4 përqind janë nën 15 vjet, kurse 14,1 përqind mbi 65 vjet (Eurostat, 2020a), që është e rëndësishme për tregun e punës.

Në dy dekadat e fundit për të cilat nuk kemi të dhëna të sakta dhe relevante përveç vlerësimeve, numri i popullsisë në Maqedoninë e Veriut, ashtu si edhe në vendet tjera të rajonit dhe pjesës më të madhe të kon-

tinetit, filloi që të ndryshojë si rezultat i lëvizjeve të përforcuara migruese, sidomos emigruese. Për shembull, sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, ka mundësi që, në 2-3 dekadat e fundit nga vendi të kenë emigruar jashtë shtetit reth 300-400 mijë njerëz që paraqet reth 15-20 përqind nga popullsia e përgjithshme.

Problem tjetër serioz është se në procesin e plakjes të popullsisë (procesin shoqëror, dhe jo atë natyror) filloi të ndërlihet edhe procesi i rritjes gjithnjë e më të vogël, e madje edhe negative të popullsisë. Të dhënat nga ESHS në RMV tregojnë se rritja natyrore çdo vjet është gjithnjë e më e vogël: 15.772 në vitin 1994; 9.083 në vitin 2000; 3.963 në vitin 2008; dhe në vitin 2018 ishte vetëm 1606 persona, kurse në vitin 2019 për herë të parë në histori rritja natyrore ishte negative dhe ishte 601 persona (Enti shtetëror për statistika, 2019, fq.13). Kjo tendencë është shqetësuese dhe me shumë gjasa do të mbesë e përhershme në një periudhë më të gjatë kohore që do të ndikojë shumë në tregun e punës në 2-3 dekadat e ardhshme. Problemi i veçantë është se në strukturën emigruese të popullsisë femërore dominojnë gratë në periudhën e fertilitetit që në vete do të tërheq ulje shtesë të natalitetit në vend. Përkundrazi, BE(bashkë me OKB) për shembull, vlerëson se popullsia e tyre do të rritet nga 512milion në 2018 në 525 milion në vitin 2044, para se të fillojë që të zvogëlohet (Eurostat, 2019, p. 14).


Duke marrë parasysh se Maqedonia e Veriut tradicionalisht nuk është, por edhe realisht nuk mund të jetë zonë imigruese në të ardhmen e afërt, lëvizjet e tilla të popullsisë nga aspekti i lëvizjes natyrore dhe lëvizjeve migruese, pa dyshim se do të sjellin deri te zvoglimi i numrit absolut të popullsisë të moshës punëtore dhe numrit të rritur të personave më të vjetër, por edhe shumë persona të moshuar në shoqëri, një nga shqetësimet më të mëdha për shoqërinë dhe ekonominë, por edhe për krijuesit e politikave në të ardhmen do të jetë që të nxiten personat e moshuar që të mbesin sa më gjatë që është e mundur në kuadër të fuqisë punëtore dhe popullsisë aktive. Në këtë proces, Maqedonia e Veriut ka përparësi sepse kohëzgjatja e pritur e karrierës të popullsisë është vetëm 31,0 vite në vitin 2016 dhe 31,7 vite në vitin 2019 (fotografia 6.1 dhe 6.2.) dhe është relativisht e ulët në krahasim me vendet e Europës ku mesatarja është pak mbi 35 vite (Eurostat, 2020 b).

Tabela 6.1.  
Lëvizja e popullsisë në Maqedoninë e Veriut në periudhën 1948 – 2002 (në miliona)

Viti	1948	1951	1961	1971	1981	1991	1994	2002
Popullsia	1,15	1,30	1,41	1,65	1,91	2,03	1,95	2,02


Burimi: Enti shtetëror për statistika, vitet 1998 dhe 2008

Fotografia 6.1.  
Kohëzgjatja e pritur e karrierës, 2019, MB, EFTA



Eurostat, 2020 (lfsi\_dwl\_a) = Burimi: Eurostat, 2020 (lfsi\_dwl\_a)

Fotografia 6.2  
Expected duration of working life in time, 2000-2019, EU-27 (years)



Burimi Eurostat, 2020 (lfsi\_dwl\_a)

Proceset integruese të Maqedonisë së Veriut drejtë NATO-s dhe sidomos drejtë BE-së jo vetëm që nuk do ta ndërrojnë fotografinë, por në bazë të ngjarjeve dhe lëvizjeve në vendet e rajonit që kanë kaluar atë rrugë (Bullgaria, Romania, Kroacia, Sllovenia), të njëjtët do ta thellojnë. Popullsia bullgare, për shembull, në 25 vitet e fundit është zvogëluar nga rreth 9 në 7 milion banorë (World Bank, 2013). Në fakt, tregu i liberali-

zuar i fuqisë punëtore në kuadër të BE-së ka shkaktuar procesin e zhvendosjes të fuqisë punëtore nga shtetet anëtare më pak të zhvilluar drejtë më të atyre më zhvilluara të cilave u nevojitet fuqi punëtore shtesë.

Ka shumë mundësi që në afat të gjatë Maqedonia e Veriut të ketë nevojë që të tërheq fuqi punëtore nga ato pjesë të botës ku lëvizjet demografike ende

do të jenë pozitive, dhe këto janë pjesë nga Azia dhe Afrika që të mund të ekuilibrojnë tregun e fuqisë punëtore që do të mund të karakterizohet me ofertë të ulët kronike.

Procesi i plakjes të popullsisë dhe uljes të saj absolute mund të shkaktojë edhe probleme të tjera shtesë dhe sfida për ekonominë. Një studim i Bankës Botërore që nga viti 2017 (Chawla et al.) udhëzon në çëshjtet e plakjes të popullsisë në vendet tranzitore dhe pas-tranzitore dhe: tregun e punës; kursimin dhe tregjet financiare; shpenzimet shëndetësore dhe pensionale; arsimit etj.

## 6.2. JO HARMONIZIMI NDËRMJET OFERTËS DHE KËRKESËS DHE MUNGESA E MUNDSHME E FUQISË PUNËTORE

Para fillimit të pandemisë Covid -19, tregu i punës në Maqedoninë e Veriut ka treguar një tendencë në rritje, që mund të shihet si shkallë e rritur e aktivitetit, punësimit, si tërësi, ashtu edhe te gratë, rënie të shkallës të papunësisë, në tërësi, por edhe tek të rinjtë, si dhe rritje të ofertës, respektivisht një numër të vendeve të lira të punës (tabela 6.2.). Edhe pse statistika zyrtare, në pajtim me Anketën për fuqinë punëtore tregon rritje të vogël të punësimit në kuartalin e parë nga viti 2020, pritet që pandemia do të zhvendos performansat e tregut maqedonas të punës.

Nga aspekti i sektorëve të cilët më së shumti apsorbojnë fuqinë punëtore, të dhënat nga AFP (anketa për fuqinë punëtore) për vitin 2017 tregojnë se më shumë se gjysma e punësimeve në Maqedoninë e Veriut (65,1%) është përqëndruar në tre aktivitete kryesore ekonomike "Tregtia me shumicë dhe pakicë, transport, akomodim dhe shërbime të ushqimit" (23,4 %) dhe „Bujqësi, pylltari dhe peshkatar “ (21,9 %) dhe

„Industri, pa ndërtim“ (19,8 %). Në industrinë e përgjithshme, pjesa më e madhe e industrisë të përpunimit, përfshirja e të cilës është 16,8 % në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik të shtetit. (grafikoni 6.1.) Krahasimi me Bashkimin Evropian, tregon se përjashtim nga sektori i bujqësisë që është një nga tre sektorët më të mëdhenj që apsorbojnë fuqinë punëtore në Maqedoninë e Veriut për dallim nga BE, tre sektorët tjerë dominant janë të njëjtët (Tregtia me shumicë dhe pakicë, transporti, akomodimi dhe shërbimet e ushqimit “ „Industria, pa ndërtimin“ dhe „Administrata publike, arsimit, shëndetësia, mbrojtja sociale“). Ajo që është specifike për sektorin e bujqësisë në Maqedoninë e Veriut, është që në të njëjtin janë përfshirë një pjesë madhe e punëtorëve të papaguar familjar, dhe kështu ndër një pjesë të konsideruar të të punësuarve në këtë sektor, punësimi i tillë paraqet angazhim të pasigurt dhe angazhim të punës të paguar pak.

Pandemia me virusin Covid-19 nuk është shkaktari për sfidat kryesore të tregut të punës në kontekstin nacional, edhe pse të njëjtat gjithsesi se do i përmend dhe dimenzionojë. Hulumtimet dhe analizat para-prake tashmë kanë treguar në gjendjet e mospajtit ndërmjet ofertës dhe kërkesës në shtet, duke theksuar "përkeqësimin relativ të pozitës të punëtorëve me shkollim të lartë si rezultat i ofertës të madhe të punëtorëve të tillë, masës të tepërt të kualifikimeve të shërbimit dhe punëtorët e shitjes, si dhe punëtorët e kualifikuar bujqësor; dhe arsimit i pamjaftueshëm të menaxherët " (Mojsoska-Blazevski, 2019, стр. 48). Në pajtim me të dhënat nga Anketa për nevojën e shkollësive në tregun e punës në vitin 2020, sipas shkallës të njohurive të nevojshme (arsim) nga punësimet e pritura, 8,4 % do të jenë për personat me arsim të lartë të përfunduar, 9,3 % për personat që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe të lartë, dominante 46,9 % do të jenë për personat që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe 35,4 % punësime pritet të jenë për per-


Tabela 6.2.  
Treguesit e tregut të punës në Maqedoninë e Veriut

	2016	2017	2018	2019	2020/I
Shkalla e aktivitetit	56,5	56,8	56,9	57,2	57,4
Shkalla e punësimit	43,1	44,1	45,1	47,3	48,1
Shkalla e papunësisë	23,7	22,4	20,7	17,3	16,2
Shkalla e aktivitetit te gratë	43,8	44,3	44,6	46,6	46,4
Shkalla e punësimit te gratë	33,8	34,6	35,8	38,1	39,1
Shkalla e papunësisë te të rinjtë (15 – 24)	48,2	46,7	45,4	35,6	34,9
Shkalla e vendeve të lira të punës	1,3	1,5	1,6	1,6	/

Burimi: Enti shtetëror për statistika, MAKStat baza e të dhënave; Anketa për fuqinë punëtore, viti 2020




**Grafikoni 6.1.**  
Pjesëmarrja në 10 aktivitetet kryesore ekonomike në punësimin e përgjithshëm në Maqedoninë e Veriut dhe Bashkimin Evropian në vitin 2017



Burimi: Eurostat, <http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

**Grafikoni 6.2.**  
Popullsia aktive (15 – 64 vjet.), sipas arsimit më të lartë të marrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në mijera



Burimi: Eurostat, 2020, Ifsq\_agan

Shënim: Shkalla e arsimit në pajtim me klasifikimin standardizues ndërkombëtar të arsimit ISCED-2011, respektivisht ISCED 0 – 2: Pa arsim dhe arsim fillor të papërfunduar, ISCED 3 – 4: Niveli i mesëm i arsimit dhe ISCED 5 – 8: Arsimi terciar.

sonat që kanë përfunduar arsimin fillor (Agjencia e Punësimit, 2019). Këto të dhëna tregojnë një karakter tregues, tregojnë në nevojën për harmonizimin e profilit arsimor të fuqisë punëtore me kërkesën për të njëjtën. Siç mund të shihet edhe nga grafiku 6.2., në vitet e fundit vërehet rritje vetëm e popullsisë aktive me arsim terciar respektivisht tretësorë, ndërsa popullsia aktive pa arsim dhe pa arsim fillor të përfunduar, si dhe popullsia aktive me arsim të mesëm, shënojnë rënie.

Tendencat e tilla të cilat nuk janë me kërkesën aktuale për fuqinë punëtore, pa dyshim se duhet të shoqërohen me masa si në politikën arsimore, ashtu

edhe përmes politikës aktive të tregut të punës. Krahas ndryshimeve të filluara të cilat janë lajmëruar në arsimin e mesëm profesional, si dhe arsimin dual, janë të domosdoshme ndryshimet edhe në arsimin e lartë. Politika regjistrimit në arsimin e lartë është shumë "liberale" dhe e njëjta as që është në kontekst me nevojat e tregut e punës, as që lejon filtrimin e të rinjve në pajtim me arritjet dhe kapacitetet e tyre. Një nga masat që mund të tejkalojë këtë gjendje dhe të përmirësojë cilësinë e arsimit të lartë është kthimi i testeve pranuese në të gjithë aktivitetet, që ishte hequr për shkak të politikave të mëparshme për disponueshmëri të gjërë në arsimin e lartë. Politika e tillë, e plotësuar me ngopjen e ofertës nga arsimi i lartë, respektivisht


numri i madh i institucioneve të akredituara të arsimit të lartë të sektorit shtetëror dhe privat, janë pjesë e faktorëve për mospajtimin ndërmjet ofertës dhe kërkesës të tregut të punës. Provimet pranuese ishin një nga faktorët që do të mund të ndikonin për ridrejtimin e popullsisë aktive drejtë profesioneve në pajtim me potencialet dhe kapacitetet e tyre. Kontrolli më i madh gjatë akreditimi të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve studimore të cilat ofrojnë, me qëllim të shmangjes të ngopjes të ofertës arsimore në pajtim me nevojat e tregut, mundet që në mënyrë shtesë të kontribuojë për harmonizimin e profilit arsimor të fuqisë punëtore me kërkesë për të njëjtën. Politika publike në arsimin e lartë mund të pasqyrojë më së miri shumëllojshmërinë e shkathtësive të nevojshme dhe të mendojë se si krijohen këto shkathtësi gjatë të gjithë ciklit jetësor. Kjo kërkon shqyrtimin e pasojave të paqëllimshme nëse intervenimet publike e ndryshojnë trajektoren shkollë-punë, shqyrtimin e dallimeve ndërmjet asaj nëse dëshirohen shkathtësië kognitive apo jo kognitive, të kuptojnë si krijohen shkathtësitë e ndryshme dhe dinamika e arsimit të individëve dhe përzgjedhja e karrierës.

Përveç kësaj, masat dhe programet aktive për punësim mund të ndihmojnë për personat që kanë humbur punësimin nëse nuk kanë sukses që të gjinden në mënyrë të pavarur në tregun e punës. Oferta përmes politikës aktive të tregut të punës për trajnim, kualifikim shtesë dhe rikualifikim dhe punësim duhet të jetë profilizuar sipas nevojave të tregut të punës, por e përshtatur në pajtim me profilin arsimor të kërkuesve të punës, që të mundet e njëjta të shfrytëzohet. Rezultatet nga masat aktive për punësim duhet të shihen në afat të mesëm dhe të gjatë. Card, Kluge dhe Weber (2017) përfundojnë se ndikimet mesatare

të këtyre masave dhe programeve aktive janë afërsisht zero në afat të shkurtër, por shpeshherë bëhen më pozitive në afat të mesëm deri në afat të gjatë (dy deri në tre vite pas përfundimit të programit). Gjithashtu, ata zbulojnë se ka dallime të konsideruara në ndikim sipas llojit të programit. Efekt më të madh kanë programet që kanë potencuar akumulimin e kapitalit njerëzor, ndërsa programet të cilat ndihmojnë gjatë kërkimit të punës, janë më pak të efektive në afat të gjatë. heterogjeniteti i konsideuar është te pjesëmarrësit në raport me efektin e këtyre programeve: për shembull, tregohet se burrat dhe gratë të cilët do të ishin të papunë një kohë të gjatë, kanë më shumë përfitim nga kjo. Gjithashtu është treguar se masat aktive për punësim kanë ndikim më të madh gjatë kohës të recesionit ekonomik. Siç është theksuar nga Heckman, LaLonde dhe Smith (1999), megjithatë, një pjesë e madhe e këtyre programeve aktive për punësim nuk e tejkalojnë testin kosto-përfitim. Madje edhe kur ata janë rentabile, ata rrallëherë janë të lidhura me përmirësimin e shkathtësive. Në këtë drejtim nevojitet që investimet në masat aktive për punësim në Maqedoninë e Veirut të jenë të drejtuara mirë, ndërkohë duke marrë parasysh se ata janë një mjet ndihmës, por edhe një zgjidhje afatgjate për mospajtimin ndërmjet ofertës dhe kërkesës.

Një nga specifikat e tregut të punës është mungesa e fuqisë punëtore nga kualifikimet specifike të cilat nuk kërkojnë arsim të lartë. Analiza e të dhënave të Agjencisë për punësim, në raport me profesionet aktuale për të cilat ka numër më të madh të vendeve të lira të punës që janë shpallur (grafikoni 6.3.), tregon se përveç për vendin e punës inxhinier për teknologjitë e informacionit, si dhe për disa që nevojitet arsim i mesëm profesional (teknik biologjije, teknik kimie

Grafikoni 6.3. Profesionet me numrin më të madh të vendeve të lira të punës, të shpallura përmes Agjencisë për punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut



Burimi: Agjencia për punësim, viti 2020

dhe të ngjajshme) në numrin më të madh të rasteve bëhet fjalë për vende manuale të punës, për të cilat nevojitet shkathtësi themelore dhe shkathtësi bazë. Këto të dhëna gjithashtu flasin se Maqedonia e Veriut është larg nga ekonomitë që bazohen në njohuri.

Mungesa e mundshme e fuqisë punëtore, përveç për shkak të mospajtimit të kualifikimeve të kërkuara, mund të paraqitet edhe si rezultat i ikjes masovike të të rinjve, por edhe të punëtorëve më të rritur jashtë shtetit, si burim për të kërkuar një vend pune të paguar më mirë. Tendencat e tilla në mënyrë shtesë duhet të shoqërohen jo vetëm për politikën arsimore, tatimore dhe asaj të punësimit, por edhe përmes strategjive për shfrytëzimin e valëve gjithnjë e më të shpeshta të migrantëve, të cilët kalojnë përmes shtetit, si fuqi punëtore potenciale.

### 6.3. PAPUNËSIA E TË RINJVE

Të rinjtë përballen me shumë probleme për hyrje në tregun e punës siç janë: papërshtatshmëria e njohurive dhe shkathtësive dhe njohurive të përfituara në procesin formal arsimor me nevojat reale të tregut të punës, periudha mesatare për kalim të personave të rinj nga shkolla në punë (2,5 vjet), si dhe numri i pamjaftueshëm dhe cilësor i vendeve të lira të punës. Problem edhe më i madh është numri i madh i të rinjve në Maqedoninë e Veriut - mbi 130.000 persona, të cilët nuk janë në procesin arsimor, nuk janë të punësuar, dhe nuk janë në procesin e trajnimeve (NEET). Duke marrë parasysh atë që është theksuar më parë, dhe me qëllim që të tejkalohet sfida për zvogëlimin e shkallës të papunësisë te të rinjtë, në vitet e fundit janë zbatuar disa politika për punësim të drejtuar drejtë të rinjve, siç janë: programet aktive për punësim përmes planit operativ për punësim, futja e "Garancës për të rinj", futja e shtesës rinore, si dhe miratimi i Ligjit për punë praktike.


Këto masa dhe politika kanë sjellur deri te rritja e punësimit të të rinjve nga 30,2% në vitin 2017 në 34,4% në vitin 2019. Në nivel kuartal, rezultatet tregojnë një tendencë pozitive, respektivisht papunësia e të rinjve nga 15 deri në 29 vjet është 43,7% nga kuartali i parë i vitit 2015 është zvogëluar në 27,3 % në kuartalin e parë në vitin 2020.

Në vitin 2017 është bërë pilotimi i programit "Garancë për të rinjtë" (GR), që është pjesë e iniciativave udhëheqëse evropiane dhe ka për qëllim që t'u sigurojë të rinjve të moshës (15 – 29 vjet) ofertë cilësore për punësim, arsim të vazhdueshëm dhe trajnim, apo punë praktike në periudhën prej katër muajsh nga dita e evidentimit në Agjencinë për punësim. Maqedonia e Veriut është vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që ka futur dhe zbatuar "Garancën për të rinjtë". Programi konsiderohet se është i suksesshëm nëse të paktën 30% nga personat e përfshirë, dalin me sukses nga i njëjti në periudhën prej 4 muajsh, respektivisht do të punësohen, sërish do të përfshihen në procesin arsimor apo do të jenë të përfshirë në programet aktive dhe masat për punësim.

Plani për realizimin e GR në Maqedoninë e Veriut ishte planifikuar që të realizohet në dy faza: faza e pilotimit e viteve 2018/2019 dhe faza e dytë deri në vitin 2022 në të cilën periudhë do të këmbëngulet që të realizohet në të gjithë territorin e Maqedonisë së Veriut, me theks të veçantë në tre rajonet më pak të zhvilluara: Rajoni Jugperëndimor, Verilindor dhe i Pollogut.

Në vitin 2018 janë përfshirë gjithsej 5.266 persona (2.694 gra), prej të cilave 1.916 janë punësuar, kurse 281 persona ishin përfshirë në ndonjë prej masave aktive për punësim të cilat nuk çojnë në punësim të drejtëpërdrejtë, por e rrisin punësueshmërinë e tyre. Sipas kësaj, suksesi i "Garancës për të rinjtë" në vitin

Grafikoni 6.4.  
Shkalla e punësimit dhe papunësisë te personat e rinj të moshës 15 – 29 vjet në Maqedoninë e Veriut



Burimi: Eurostat, yth\_empl\_010; yth\_empl\_090

2018 është 41,7 % dhe ka tejkaluar atë që ishte planifikuar 30 %. Në vitin 2019, suksesi i "Garancës për të rinjtë" është 35,5 % dhe ka tejkaluar të planifikuarat 30 %.

Duke përfshirë fundin e korrikut të vitit 2020, gjithsej 14.040 persona të rinj janë përfshirë (6.958 gra) prej të cilëve 3.241 janë punësuar drejtëpërdrejtë, respektivisht janë përfshirë në ndonjë prej masava aktive për punësim nga PO të vitit 2020 të cilat nuk udhëheqin në punësim të drejtëpërdrejtë, por e rrisin punësueshmërinë e tyre (shembull 700 të rinj janë përfshirë në masën e Punës praktike). Nga gjendja faktike e paraqitur, mund të konstatojmë se edhe krahas kushteve specifike (të pafavorshme) të funksionimit të ekonomisë vendore të shkaktuara nga pandemia me virusin Covid -19, përfshirja e të rinjve në GR sërish ka tejkaluar pragun e pritur prej 10.000 personave të planifikuar.

Në bashkëpunim me sektorin real dhe kompanitë të cilat punojnë në prodhim, është parë nevoja për nxitjen e të rinjve që të realizojnë marrëdhënie të punës me këtë lloj të kompanive. Së bashku me organizatën e punëdhënësve dhe sindikatave përmes dialogut ekonomik social është futur shtesa rinore. Kjo shtesë është 3.000 denarë për person në muaj me orar të plotë për persona të rinj deri në 23 vjet. Në qershor të vitit 2020, 4000 persona kanë marrë shtesën rinore përmes Agjencisë për punësim.

Në procesin e realizimit të politikave për punësimin e të rinjve është vërejtur zbrazëtirë në pjesën e përgatitjes të të rinjve për punësim. Me qëllim që të tejkalohet kjo mangësi, është miratuar Ligji për punë praktike që ka rregulluar të drejtat dhe detyrimet e praktikantit dhe punëdhënësit dhe ka siguruar përparësi për të dy palët, siç janë:

- Shkathtësi dhe kualifikime për punësim më të shpejtë dhe më të suksesshëm;
- Punëdhënësve u lehtësohet përzgjedhja e punëtorëve pas përfundimit të punës praktike, kurse për kohëzgjatjen e të njëjtës, përveç kompenzimit për punën e kryer dhe tatimit për të ardhurat personale, punëdhënësi nuk ka detyrim për pagesën e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social;
- Puna praktike mund të zgjas nga 1 deri në 6 muaj me lidhjen e marrëveshjes për punën praktike.

Duke përfshirë edhe kuartalin e dytë të vitit 2020, gjithsej 196 punëdhënës kanë shfrytëzuar mundësinë që ofron Ligji për punë praktike.

Që të mundet më tutje të mbahet tendenca e njëjtë për zvogëlimin e papunësisë, dhe paralelisht edhe rritjen e punësimin të të rinjve, duhet të vazhdohet me realizimin e masave të cilat kanë dhënë rezultat, por

edhe të prezantohen të reja të cilat japin përvoja në shtete tjera të cilat përballem me të njëjtat probleme si ne.

Në periudhën e ardhshme është i domosdoshëm promovimi dhe përparimi i ofertës për programe të arsimit joformal dhe mësimin gjatë gjithë jetës, me qëllim që të përgjigjet në mungesën e shkathtësive dhe përvojave teknike të cilat përvetësohen edhe jashtë arsimit formal, kurse janë të domosdoshme për sektorin e biznesit. Informatat për këto programe duhet të jenë të disponueshme në shkollat e mesme dhe të vazhdojnë të promovohen gjatë studimeve. Kjo do të mund të zgjidhet me formimin e qendrave rajonale për trajnim dhe futjen e arsimit dual.

Masat të cilat janë të drejtuara kah përmirësimi i shkathtësive të të rinjve dhe zvogëlimi i papunësisë, duhet të jenë të disponueshme për të gjithë të rinjtë. Në këtë kuptim duhet të angazhohemi për një disponueshmëri më të madhe të masave dhe informimit të të rinjve për të njëjtat, sidomos që i referohen të rinjve nga mjediset rurale dhe kategoritë e rrezikuara të të rinjve.


Në mënyrë shtesë duhet të zhvillohen strategji për komunikim me prindërit/fëmijët nga mosha e hershme shkollore (arsimi fillor), të fokusuar në atë se profesionet të cilat nënkuptojnë përgatitjen e mesme profesionale, mundësojnë përfundimin të mirë dhe "nuk janë të turpshme" dhe me këtë shpëtojmë gjenera të tëra të të rinjve nga papunësia afatgjate dhe kërkesa e punës jashtë shtetit.

## 6.4. FLEKSIBILITETI I VENDEVE TË PUNËS

Arranzhimet alternative të punës, siç janë oraret fleksibile, puna nga shtëpia, puna me orar të shkurtuar, paraqesin një karakteristikë në rritje në ekonominë botërore, por është gjithnjë e më e shpeshtë edhe në ekonominë vendore. Përderisa këto angazhime mund të lehtësojnë bilancin e punës dhe jetës, ata nuk janë domosdoshmërisht të favorshme për punëtorët. Shumë vende të punës kanë orare jo të rregullta, me çrast punëtorët nuk mund të parashohin orarin e punës nga një javë në tjetrën; shumë punëtorë janë në thirrje apo punojnë gjatë orëve të mbrëmjes, netëve dhe fundjavave. Në mënyrë shtesë, në kontekst nacional format jostandarde të punës, siç edhe tregojnë edhe analiza e Anketës për fuqinë punëtore dhe të dhënat e Eurostat<sup>10</sup>, nuk janë rezultat i përzgjedhjes, por i pamundësisë për të gjetur punë me orar të plotë (36,4 %), detyrime tjera familjare apo personale (16,4

10 Eurostat, Arsyet kryesore për punë me orar jo të plotë të punës, 2020, [lfsa\\_epgar](#)

Grafikoni 6.5.  
Format jo-standarde të punësimit në Maqedoninë e Veriut, viti 2019, në mijëra



Burimi: Eurostat, 2020

%), kujdes për fëmijët apo personat e moshuar në familje (4,9 %), sëmundje apo aftësi të kufizuara (2,6 %), arsim dhe trajnim (3,3 %) dhe arsye tjera (36,4 %).

Pandemia Kovid-19 ka imponuar dhe theksuar nevojën për angazhime fleksibël të punës dhe punës nga shtëpia. Vlerësimi për vendet potenciale të punës të cilat mund të kryhen nga shtëpia që është bërë nga Dingel dhe Neiman (2020) tregon se 37 % e vendeve të punës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund të kryhen tërësisht nga shtëpia, me një ndryshim të konsideruar në qytetet dhe industrinë. Këto vende të punës zakonisht paguhet më shumë se vendet e punës të cilat nuk mund të kryhen nga shtëpia dhe përbëjnë 46 % nga të gjithë rrogat në SHBA: zbatimi i klasifikimit të tyre profesional në 85 vende tjera të botës zbulon se ekonomitë me të ardhura më të ulëta kanë një pjesë më të vogël të vendeve të punës që mund të realizohen nga shtëpia. Vendet në zhvillim dhe ato me nivel të PBB për kokë banori nën një të tretën nga PBB i SHBA, mund të kenë vetëm gjysmën e vendeve të përgjithshme të punës që mund të realizohen nga shtëpia (Dingel dhe Neiman, 2020). Duke zbatuar metodologjinë e Dingel dhe Neiman në shembullin e Kanadës, Gallacher dhe Hossain kanë përfunduar se një kategori e caktuar e të punësuarve, siç janë: të punësuarit të cilët janë në rrezik të varfërisë, punëtorët më të rinj, punëtorët me orar të shkurtuar të punës, punëtorët me kompani të vogla, punëtorët sezonal apo të kontraktuar, si dhe punëtorët pa arsim të lartë, kanë tendencë më të vogël dhe mundësi që të jenë të punësuar në vende të punës për të cilat është e mundur puna në distancë apo puna nga shtëpia (Gallacher и Hossain, 2020).

Format jostandarde të punës marrin me vete edhe rrezikun e sindikalizmit më të vogël, kurse me këtë edhe kufizim të mekanizmave për mbrojtje të të drejtave të punëtorëve.

Të drejtat e punëtorëve në shtetin tonë edhe ashtu janë ndër më të ulëtat në Evropë sipas raporteve relevante ndërkombëtare në këtë temë. Konkretisht, raporti më i ri i Konfederatës ndërkombëtare të sindikatave në Maqedoninë e Veriut tregon se "Qeveria dhe/ose kompanitë bëjnë përpjekje serioze për çrënjosjen e zërit kolektiv të punëtorëve". Nga vendet evropiane, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Romania janë në nivel të njëjtë me ne, ndërsa vetëm Greqia, Turqia dhe Ukraina kanë vlerësim më të vogël se ne në këtë fushë.

Përveç se të drejtat janë të pamjaftueshme, të njëjtat shpeshherë nuk respektohen. Vetëm sipas një hulumtimi nga "Gllasen tekstilec", në industrinë e tekstilit madje 40 % e punëtorëve janë të punësuar në orar të caktuar, 60 % e të punësuarve me 50 orë në javë, dhe madje 70% prej tyre nuk janë të paguar për këtë. Sipas raportit të Shoqatës maqedonase për mbrojtjen në punë për vitin 2018, në atë vit madje 33 persona kanë ndërruar jetë nga lëndimet e shkaktuara në punë, që është e barabartë me 4,3 raste të vdekjes në 100 000 punëtorë, që është niveli i dytë më i lartë në Evropë dhe është pothuajse tre herë më e lartë nga mesatarja evropiane prej 1.6. Kjo tregon se kushtet e punës janë të këqija dhe nuk respektohen masat për mbrojtje në punë.

Institucionet shtetërore të cilat janë të detyruara për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, si Inspektorati shtetëror i punës dhe gjykatat, nuk e bëjnë këtë në mënyrë të kënaqshme. Sipas një hulumtimi të Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut, madje 64 % nga punëtorët e anketuar kanë shprehur pakënaqshmërinë e plotë nga puna në Inspektoratin shtetëror të punës, kurse 13 % janë pjesërisht të kënaqur. Madje 50 % e të anketuarve janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur nga puna e gjykatave themelore, kurse 17,2% janë përgjigjur se pjesërisht janë të kënaqur.

Në mungesë të hulumtimeve dhe vlerësimeve për potencialet e punës në distancë dhe punës nga shtëpia në kontekstin nacional, nevojitet që të merren parasysh detajisht mundësitë që ofrojnë format fleksibile të punës, por gjithashtu edhe rreziqet që ata i mbajnë në vete. Siç tregojnë edhe Organizata ndërkombëtare e punës (2020) nevoja e rritur për punë nga shtëpia, gjatë kohës të krizës të shkaktuar nga pandemia e Covid-19, imponohet nevoja që qeveritë të sigurojnë se ata që punojnë nga shtëpia, kanë të drejtat dhe përfitime të njëjta sikur të punojnë në vendin e të punësuarve të tyre, duke përfshirë barazinë në trajtim gjatë pagesës edhe kushte tjera për punë. Në pajtim me të dhënat e theksuara në Raportin nacional për përshtatjen e marrëdhënieve industriale ndaj formave të reja të punës "rregullimi i pamjaftueshëm ligjor i punës nga shtëpia ka efekte negative mbi punën e më shumë industrive, sidomos mbi industrinë e teknologjisë informative të komunikimit, që i bën kompanitë më jo-konkurrese në treg sepse nuk kanë mundësi që të përmbushin kërkesat e punëtorëve, kurse përballen me mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar që emigron, para së gjithash për shkak të cilësisë të jetës dhe kushteve më të mira për punë jashtë vendit" (Trajkovski, 2019, fq. 107). Në këtë drejtim, nevojitet precizimi i dispozitave të Ligjit për marrëdhënie të punës në raport me kontratën për punësim për punë nga shtëpia, si dhe format tjera jo-standarde të punësimit, me qëllim të përcaktimit të të drejtave dhe detyrimeve të të punësuarit dhe punëdhënësit, si dhe sigurimin e mundësive që të njëjtat të jenë të ndryshueshme në praktik.

## PËRFUNDIM

Edhe krahas të gjithë ndryshimeve strukturore dhe transformimit të ekonomisë dhe aktiviteteve ekonomike, fuqia punëtore që është bartëse e punës edhe më tutje mbetet një nga faktorët kryesor ekonomik dhe zhvillimor që në mënyrë të konsideruar merr pjesë në krijimin e PBB në shtetin tonë, kurse rritja e ekonomisë, respektivisht PBB, në pjesë të konsideruar është rezultat i kontributit marginal të punës, sidomos i asaj manuale dhe më pak të kualifikuar në disa veprimtari të rëndësishme për ekonominë siç është bujqësia, ndërtimi, degët industriale të përpunimit dhe me punë intensive. Sigurisht që rritja e ekonomisë është rezultat edhe i pjesëmarrjes të veprimtarive më bashkëkohore dhe më fitimprurëse dhe degët e ekonomisë ku pjesëmarrja e njohurive dhe shkathtësive të fuqisë punëtore (kapitalit njerëzor) janë thelbësore, dhe këto janë veprimtari të shërbyese (shëndetësi, arsim, dhe shërbime financiare, shkencë, shërbime konsulente, krijim të softuerit dhe të tjera) dhe prodhim të produkteve me teknologji të lartë që janë intensive në njohuri (TIK, prodhime, farmaci, pajisje digjitale, pajisje të sofistikuar dhe të ngjajshme).

Fuqia punëtore në Maqedoninë e Veriut ka karakteristika të shprehura të fuqisë punëtore me sasi të

lartë të kapitalit njerëzor për shkak të nivelit relativisht të ulët të arsimit dhe shkathtësive që i posedon. Transformimi i saj drejtë fuqisë punëtore me nivel të lartë të kapitalit njerëzor duhet të jetë një nga detyrat kryesore të politikës ekonomike dhe sidomos asaj arsimore në afat të mesëm, të gjatë dhe shumë të gjatë.

Mungesa e fuqisë punëtore cilësore dhe kapitalit njerëzor në të ardhmen mund të shaktohen në mënyrë shtesë për shkak të tendencave të rritjes natyrore të zvogëluar, e madje edhe negative të popullsisë dhe bilanceve të saj negative në lëvizjen mekanike (emigrimit). Bashkarisht me procesin ekzistues natyror të plakjes të popullsisë, kjo mund të jetë një nga faktorët kryesor që do të ndikojë në gjendjen e tregut të FP përmes çrregullimit afatgjatë të niveleve të ofertës dhe kërkesës të fuqisë punëtore nga ana e ekonomisë. Nuk duhet të përjashtohet as mundësia që Maqedonisë të Veriut t'i nevojitet edhe fuqi punëtore shtesë, sidomos ajo me kualifikime të ulëta për veprimtari të caktuara tradicionale, por edhe ajo me shkathtësi më të larta të kualifikimit dhe shkathtësi në veprimtari më bashkëkohore, sidomos ajo me kualifikime të uëta për veprimtari të caktuara tradicionale, por edhe ajo me kualifikime dhe shkathtësi me të larta në veprimtari më bashkëkohore për çka tregjet rajonale dhe globale, duke përfshirë edhe ata të fuqisë punëtore, do të jenë të favorshme.

Gjendjet e tilla pjesërisht mund të tejkalohen me reforma të përshpejtuara dhe të konsideruara strukturore të ekonomisë që do të mbështeten me orientimin aktiv shtetëror të të ofertës të fuqisë punëtore drejtë një oferte të re me fuqi punëtore të cilësisë të lartë me sasi të lartë të njohurive dhe shkathtësive, për çka nevojiten ndryshime thelbësore në procesin formal dhe joformal arsimor, dhe që do mund të kompenzojë mungesën e fuqisë punëtore në disa veprimtari dhe degë (ata me të ardhura të ulëta dhe me punë intensive) me ofertë më të madhe në veprimtari me të ardhura të larta dhe degët që absorbojnë FP që është intensive në njohuri.

Problemet aktuale dhe afatmesme me ekzistimin e fuqisë punëtore me kualifikime të ulëta dhe të mesme do të duhet të kompenzohen me mirëmbajtjen e veprimtarive me punë intensive derisa fuqia punëtore ekzistuese tjetër me kualifikime më të ulëta në mënyrë të natyrshme nuk transformohet dhe zëvendësohet me nivel të lartë të kapitalit njerëzor.

Në fushën e të drejtave të punëtorëve, nevojitet një numër gjithnjë e më i madh në afat të mesëm, mes të cilave edhe miratimi i Ligjit të ri për marrëdhëniet e punës në drejtim të sigurimit të mbrojtjes më të madhe për punëtorët. Dy problemet më të mëdha me të cilat përballen punëtorët, janë angazhimi me kontrata në kohë të caktuar që i mban në pasiguri, dhe koha jashtë orarit që nuk paguhet. Prandaj në ligjin

e ri është veçanërisht e rëndësishme që të shkurtohet kohëzgjatja në angazhimin e punëtorëve me kontrata në afat të caktuar që tani është 5 vjet, në 6 muaj apo 1 vjet, si dhe të vendoset regjistrimi për orët e punës jashtë orarit, që të zvoglohet mundësia që punëtorët e angazhuar në këtë mënyrë të mos paguhen për këtë.

Paralelisht është i nevojshëm edhe investimi në Inspektoratin shtetëror të punës, edhe në pajisje dhe në punësime të reja, me qëllim që të përmirësohet kapacitetet e tij njerëzore dhe teknike, me çrast ai do të mund të punonte në mënyrë më profesionale. Sigurisht se është i pashmangshëm edhe fokusi mbi përmirësimin e punës të gjykatave nga fusha e të drejtës të punës.

Analiza e tendencave në tregun maqedonas të punës tregon në shqetësimin se ndikimi i kombinuar i faktorëve demografik dhe mospajtueshmërisë strukturore ndërmjet kërkesës dhe ofertës ndikon mbi fleksibilitetin dhe lëvizshmërinë e fuqisë punëtore. Megjithatë, të dhënat për ciklet e kaluara të punësimit dhe lëvizjet aktuale demografike nuk janë parashikues të mjaftueshëm për nevojat e ardhshme nga dhe për fuqinë punëtore. Politikat të cilat ndikojnë në tregun e punës, nuk janë mjaftueshëm të bazuara në hulumtime dhe të dhëna përfaqësuese. Përveç Anketës për fuqinë punëtore, që jep një segment të gjendjeve ak-

tuale të tregut të punës, nuk janë të realizuara hulumtime shtesë të bazuara në metodologjinë ndërkom-bëtare, as në parashikimet aktuale të cilat do të nxinin drejtime të reja në krijimin e politikës të tregut të punës. Në këtë drejtim, realizimi i regjistrimit të popullsisë është urgjentisht i nevojshëm, si parakusht kryesor për vlerësim të vëllimit dhe strukturës të popullsisë. Në mënyrë shtesë, nevojten vlerësime nacionale përfaqësuese për mungesën e mundshme të shkathëtësive dhe kualifikimeve të tregut të punës, të bazuara në projektme për lëvizjet e ardhshme të ekonomisë nacionale dhe globale, në vend të perceptimeve subjektive të punëdhënësve aktual. Harmonizimi i shkathëtësive me nevojat e kërkesës, si dhe shfrytëzimi i përmendur i potencialit nga valët e migrantëve si fuqi e mundshme punëtore, nuk do të ishte i mundur pa të dhëna dhe hulumtime të përmirësuara për nevojat dhe mundësitë e ardhshme të tregut nacional dhe lokal të punës. Politikat e tregut të punës të bazuara në të dhëna të fuqishme dhe të harmonizuara mund të kontribuojë për lehtësimin e bashkëpunimit krijues ndërmjet të gjithë palëve të përfshira: individëve, institucioneve arsimore, punëdhënësve, si dhe qeverive në të gjithë nivelet. Në këtë drejtim, arritja e shoqërisë produktive, me fuqi punëtore fleksibile, dhe shumë të motivuar, madje edhe në kushte kur ajo plaket, do të ishte më lehtësisht e realizueshme.

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Agjencia për punësim e Republikës të Maqedonisë së Veriut** (2019) Анкета за потреба од вештини на пазарот на трудот во Република Северна Македонија за 2020 година, Резултати од спроведеното истражување, Скопје: Agjencia për punësim e Republikës të Maqedonisë së Veriut.
- Card, D., Kluge, J. and Weber, A.** (2017) "What Works? A Meta Analysis of Recent Active Labor Market Program Evaluations" *Journal of the European Economic Association* 16 (3): 894-931. <https://doi.org/10.1093/jea/jvx028>.
- Chawla, M., Betcherman, G., Banerji, A. Bakilana, A.M., Feher, C., Mertaugh, M., Puerta, M.L.S., Schwartz, A.M., Sondergaard, L.** (2007) "From Red to Gray: the third transition of aging populations in Eastern Europe and the Former Soviet Union – overview, Washington: World Bank.
- Dingel, J.I. and Neiman B.** (2020) "How many jobs can be done at home?", NBER working paper No. 26948, Cambridge, MA: National Bureau of Economic Research.
- Enti shtetëror për statistika** (1998), Статистички годишник на СРМ 1988, Shkup: Enti shtetëror për statistika.
- Enti shtetëror për statistika** (2008), Статистички годишник на РМ 2008, Shkup: Enti shtetëror për statistika.
- Enti shtetëror për statistika** (2019) Природно движење на населението, Shkup: Enti shtetëror për statistika.
- Eurostat** (2020a) Basic Figures on Enlargement Countries, Luxembourg: Publications Office of the European Union.
- Eurostat** (2020b) Duration of working life statistics, Eurostat (online data code: lfsi\_dwl\_a)
- Eurostat** (2019) Ageing Europe, Looking at the lives of older people in the EU, 2019 edition, Luxembourg: Publications Office of the European Union.
- Eurostat** (2019), "Fatal Accidents at work", e disponueshme në: [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Accidents\\_at\\_work\\_statistics](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Accidents_at_work_statistics)
- Gallacher, G., & Hossain, I.** (2020) "Remote Work and Employment Dynamics under COVID-19: Evidence from Canada", *Journal of Scholarly Publishing*, Published electronically June 25, 2020. [muse.jhu.edu/article/759574](https://muse.jhu.edu/article/759574).
- „Гласен текстилец“** (2019) Резултати од спроведена анкета во рамки на проектот „Создади мрежа на знаење – препознај и пријави прекршување права“, Shkup: Porta e hapur dhe Komisioni Evropian.
- Heckman, J. J, LaLonde R.J. and Smith, J.A.** (1999) "Economics and Econometrics of Active Labor Market Programs" in *Handbook of Labor Economics*, Vol. 3, Par A, O.C. Ashenfelter and D. Card, 1865–2097, Amsterdam: Elsevier.
- International Labour Organization** (2020) Working from Home: Estimating the worldwide potential, Policy Brief, Geneva: International Labour Organization.
- International Trade Union Confederation** (2019) "2019 ITUC Global Rights Index - The World's Worst Countries for Workers", Brussels, ITUC International Trade Union Confederation
- Shoqata maqedonase për mbrojtje në punë** (2018) „Извештај на несреќи при работа – Годишен извештај за 2018 – Смртни случаи, повреди и несреќи при работа“, Shkup: Shoqata maqedonase për mbrojtje në punë.
- Mojsoska-Blazevski, H.** (2019) Skills mismatch measurement in North Macedonia, Turin: European Training Foundation.
- Трајковски, К.** (2019) Национален извештај: прилагодување на индустријските односи кон новите облици на работа, Shkup: Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave.
- Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë** (2019), „Мерење на степенот на задоволство од механизмите за заштита на работничките права во Република Северна Македонија“, Shkup: Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë.
- World Bank** (2013) Mitigating the Economic Impact of an Aging Population: Options for Bulgaria“, Washington: World Bank.



## 7

# TRANSPORTI I EKONOMISË MAQEDONASE SI DREJTUES I RRIJTJES EKONOMIKE

MARIJA DRENKOVSKA, VANÇO UZUNOV DHE JANE BOGOV

## HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është që të përpunojë dhe të jap bazë për një diskutim të mëtutjeshëm më të gjërë në Maqedoninë e Veriut në pesë hipoteza të lidhura me tregtinë e jashtme maqedonase, pjesëmarrjen e saj në rrjedhat botërore, si dhe drejtimet themelore për ndryshime të mëtutjeshme themelore në eksportin maqedonas me qëllim të nxitjes të shkëmbimit të jashtëm tregtar. Duke patur parasysh faktin se ky studim është përgatitur në kuadër të projektit „Fotografia e madhe për drejtimet zhvillimit të ekonomisë maqedonase“, ai paraqet ndërlidhjen dhe ripërpunimin e një pjese të tezave që janë paraqitur në punim nga projekti i njëjtë i cili i referohet rritjes të produktivitetit dhe ndryshimeve strukturore të ekonomisë maqedonase në afat të mesëm dhe të gjatë. Në këtë kuptim, pika e fillimit këtu është teza e paraqitur në pjesën e rritjes të produktivitetit, që të vendoset baza reale dhe e realizueshme për rritje të qëndrueshme të produktivitetit dhe standardit jetësor të qytetarëve në afat të gjatë, si më e përshtatshme për Maqedoninë e Veriut ndahet strategjia zhvillimore e ekspansionit eksportues (apo rritja ekonomike eksportuese-udhëheqëse). Duke patur parasysh këtë, në këtë punim në fakt bëhet fjalë për një përpunim më të detajuar të aspekteve të lidhura me çështjen se si eksporti në Maqedoninë e Veriut duhet të drejtohet dhe strukturohet që të mund të paraqesë bazën më të rëndësishme dhe drejtuesin e procesit të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në vend.

Punimi është strukturuar në pesë pjesë. Pjesa e parë është një pasqyrë e shkurtër e gjendjeve në tregtinë botërore dhe faktorët e konkurrencës, në pjesën e dytë fokusi kthehet drejt përshkrimit të gjendjeve në Maqedoninë e Veriut, ndërsa pjesët tjera i referohen drejtimeve të ndryshimeve që duhet të ndodhin në të ardhmen. Të gjithë të dhënat në punim janë llogari të autorëve, në pajtim me të dhënat e ndërmarra në muajin shtator të vitit 2020 nga baza Makstat e Entit shtetëtor për statistika të RMV.

## 7.1. INTEGRIMI TREGTAR VIS-A-VIS PROTEKSIONIZMIT DHE LUFTËRAVE TREGTARE

Ndërveprimi tregtar në dekadën e fundit shënon një ngadalësim të dukshëm në korniza botërore. Nëse periudha ndërmjet viteve 1990 dhe 2008 konsiderohet si periudhë e saj e artë, kur tregtia globale e prodhimeve dhe shërbimeve është rritur nga 39 % në 61 % nga PBB botëror, nga viti 2016 ka patur një konsensus të gjërë se rritja e ulët të tregtisë botërore është “normaliteti i ri”. Edhe analizat e fundit të institucioneve relevante ndërkombëtare (ECB, 2016; Constantinescu et al., 2015; Haugh, D. et al., 2016), parashohin se gjatë vitit të vogël që tregtia botërore të kthehet drejt trendit të para krizës. Zvogëlimi i shkëmbimit tregtar është shoqëruar me paraqitjen e proteksionizmit, pas të cilit qëndrojnë barrierat e rritura jodoganore<sup>11</sup>, dhe në kohë të fundit edhe barrierat doganore.

Tenzionet tregtare në korniza botërore kanë eskaluar në vitin 2018, kur kërcënimet proteksioniste nga ana e administratës të SHBA, si dhe reagimet e partnerëve të tyre kryesor global, ishin shoqëruar me veprime konkrete që kanë rritur rrezikun nga lufta tregtare. Këto ngjarje kanë kontribuar për zvogëlimin e mbështetjes të publikut drejt hapjes tregtare, ndër-sa proteksionizmi është rritur në nivel global.

Perceptimet për rreziqet e lidhura me tregtinë e hapur nuk janë faktorët e vetëm për rënien e popullaritetit të idesë për globalizim. Faktorët për dhe kundër janë shqyrtuar në punimin e Gunnella dhe Quaglietti (2019), ku si pasojë jo të favorshme nga tregtia e lirë përmenden: ekspozimi i rritur i krizave ndërkombëtare, derdhja e goditjeve negative nga jashtë vendit, si dhe pasojat e papërshtatshme në lidhje me shpërndarjen e pasurisë (dmth.rritja e pabarazisë në dhe ndërmjet shteteve) (Antràs, P. et al., 2017; Rodrik, 2011; etj.).

11 Barriera jo-tarifore është mënyrë për të kufizuar tregtinë me përdorimin e barrierave tregtare në formë tjetër nga tarifata. Barrierat jo-tarifore përfshijnë kuotat, embargot, sanksionet dhe tatimet. Si pjesë e politikës të tyre apo strategjisë ekonomike, disa vende shpesh përdorin barriera jo-tarifore që të kufizojnë sasinë e tregtisë që e zhvillojnë me shtete tjera.

Nga ana tjetër, tregtia ndërkombëtare u mundëson shteteve specializim në prodhimin e të mirave në të cilat ato kanë përparësi krahasuese, shumëllojshmëri më të madhe të të mirave konsumatore, të ardhura më të larta për banor, nxitjen e e produktivitetit dhe kontributit pozitiv drejtë zvogëlimit të varfërisë botërore (World Bank Group; World Trade Organization, 2015).

Megjithatë, siç theksojnë Gunnella dhe Quaglietti, përfitimet nga tregtia e hapur dhe shpërndarja e tyre në grupe të ndryshme shoqërore janë të ndryshme për shtetet e ndryshme. Ndërmjet parakushteve më të rëndësishme për realizimin e përfitimeve në tërësi janë sigurisht, struktura e eksportit, shkalla e specializimit të të mirave eksportuese, shkalla e diversifikimit të prodhimit, si dhe zhvillimi i institucioneve në vend.

Duke marrë paraysh se reth 70 % nga tregtia ndërkombëtare sot realizohet përmes zinxhirëve global të vlerave (global value chains – GVC), shtetet më të vogla dhe shtetet në zhvillim duhet të fokusohen në rritjen e efikasitetit të procesit, respektivisht cilësisë të të mirave që ofrohen në tregun e punës. Në këtë mënyrë ata do të mund të gjenerojnë vlerë më të lartë të shtuar, me të cilën do të jenë konkurrent në tregun e punës. Krijimi i vlerës të lartë të shtuar është i lidhur ngushtë me rritjen e inovacionit, që mund të drejtohet edhe ndaj rritjes të efikasitetit të proceseve, apo ndaj rritjes të cilësisë të prodhimeve. Gjithsesi, plasimi i produkteve dhe proceseve është mënyra më e sigurtë për gjenerimin e vlerës të lartë të shtuar, e cila do të ngrejë konkurrencën e tregjeve ndërkombëtare.

Shtetet dallohen edhe për nga resurset me të cilat disponojnë, dhe kjo i referohet edhe cilësisë të fuqisë punëtore, kapitalit të disponueshëm dhe nivelit të njohurive. Kjo, nga ana tjetër pasqyrohet në dallimin e shteteve edhe në raport me zhvillimin teknologjik dhe, rrjedhimisht, të niveleve të inovacioneve dhe llojit dhe intensitetit të hulumtimit dhe zhvillimit. Megjithatë shtetet në zhvillim (madje edhe ata që janë më të avancuara në aspekt teknologjik, vështirë mund të arrijnë "përpjekjet" për hulumtim dhe zhvillim të shteteve më të mëdha industriale, apo të korporatave më të mëdha, Forbes dhe Wield (2000) rekomandojnë rol të ndryshëm në procesin e hulumtimit dhe zhvillimit të ndjekësve teknologjik nga ajo e liderëve teknologjik. Në fakt, përpjekjet e hulumtimit dhe zhvillimit duhet të jenë të drejtuara drejtë forcës apsorbuuese për përdorimin e njohurive të cilat tashmë ekzistojnë në kuadër të vlerave të zinxhirëve dhe partneriteve me firma tjera.<sup>12</sup>

Në kohën e dominimit të njohurive dhe kapitalit intelektual, që ka imponuar globalizimi, zhvillimi i teknologjive të reja dhe konkurrenca e rritur, shtetet dhe kompanitë që janë të drejtuara drejtë rritjes ekonomike eksportuese-udhëheqëse, duhet të fokusohen në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e faktorëve të tyre endogjen në rritje. Nga perspektiva makroekonomike, investimet në njohuri dhe rritja e nivelit të inovacioneve, kanë për qëllim përfundimtar rritjen e prodhimtarisë, ashtu si edhe gjatë investimeve në pajisje dhe makineri. Për shtetet që janë të orientuara në aspekt strategjik drejtë zmadhimit të rritjes ekonomike dhe konkurrencës ndërkombëtare, kapitali intelektual është një nga faktorët themelor të prodhimit për arritjen e atyre qëllimeve.


## 7.2. STRUKTURA E EKSPORTIT NË MAQEDONINË E VERIUT

Në pajtim me të dhënat e paraqitura në grafikunin 7.1., eksporti, si dhe importi në Maqedoninë e Veriut, në pesëmbëdhjetë vitet e fundit shënojnë tendencë të rritjes të vazhdueshme (trendet lineare të lëvizjes janë të paraqitura me vijat më të ngushta të zeza). Është shumë lehtë e dallueshme se dy agregatët rriten paralelisht, që mund të tregojë se eksporti e mbështet zhvillimin ekonomik, dhe njëkohësisht tregon edhe varësinë importuese (për rritje të eksportit nevojitet pothuajse rritje proporcionale e importit). Njëkohësisht, kjo mund të shihet edhe nga eksporti neto (dallimi ndërmjet eksportit dhe importit) që është pothuajse konstant.

Nga ana tjetër, të dhënat e grafikunin 7.2. tregojnë shkallët vjetore të ndryshimit të eksportit dhe importit. Së pari, gjithashtu është qartë e dukshme se dy agregatët ndryshohen pothuajse në mënyrë paralele, dhe ndërkohë, shkalla mesatare vjetore e rritjes të eksportit për të gjithë periudhën 15 vjeçare është 10,5 % ndërsa e importit është 9 %. Megjithatë, trendet e rritjes janë të ndryshueshme nga viti në vit, dhe trendet lineare të ndryshimit të shkallëve vjetore të rritjes të eksportit dhe importit për periudhën e analizuar (gjithashtu janë të paraqitur me vijat e zeza më të ngushta), kanë tendencë të rënies (që të dy agregatët rriten, por janë në dinamikë rënëse). Rrjedhimisht, nëse shohim në mënyrë përmbledhëse, ndikimi i tregtisë të jashtme – faktikisht për ne në këtë temë është më i rëndësishëm se ndikimi i eksportit – në formimin e PBB të Maqedonisë së Veriut ka dinamikë të ndryshueshme: sipas të dhënave të BPRMV, në periudhën e viteve 2012 deri në vitin 2019, tregtia e jashtme ka ndikim pozitiv mbi formimin e PBB vetëm në 3 vite (2013, 2017 dhe viti 2018), kurse në të gjithë vitet tjera ky ndikim është negativ. Në këtë kuptim, edhe krahas tendencës permanente të rritjes të eksportit, *nuk mund* të flitet për realizim të suksesshëm të strategjisë të rritjes ekonomike të bazuar në ekspansionin eksportit.


12 Për dobietë (nga aspekti i rritjes të inovacionit, dhe me këtë edhe produktivitetit të kompanive) nga integrimi i zinxhirëve ndërkombëtar të vlerave dhe eksportit të tregjeve ndërkombëtare flasin teoritë e Grossman dhe Helpman (1991), kurse janë të mbështetura në analizat empirike të Helpman (2004, kapitulli. 5.6).

Grafikoni 7.1.  
Eksporti dhe importi në Maqedoninë e Veriut në vitet 2004 – 2019, në mil. EUR



Burimi: Enti shtetëror për statistika i RMV

Grafikoni 7.2.  
Shkallët vjetore të rritjes të eksportit dhe importit, në %




Burimi: Enti shtetëror për statistika i RMV

Nga ana tjetër, krahas dinamikës, një aspekt tjetër i rëndësishëm është struktura e eksportit, e parë për produkte dhe për tregje. Të dhënat e treguara në grafikoni nr 7.3 e ilustrjnë strukturën e eksportit të Maqedonisë së Veriut në vitin 2019 sipas kategorive themelore të produkteve. Dy të tretat e eksportit në Maqedoninë e Veriut janë produkte ndërmjetëse, kurse një e treta tjetër është pothuajse e ndarë për gjysëm ndërmjet produkteve kapitale për konsumin e gjërë. Në kuadër të grupit të produkteve ndërmjetëse, mbi 60 % janë furnizime të përpunuara industriale, 19 % janë pajisje transportuese dhe pjesë dhe mbi 11 % janë furnizime industriale primare; te produktet e eksportit të konsumit të gjërë, produktet gjysëm të qëndrueshme dhe të paqëndrueshme japin pothuajse 60 % nga ai grup, ndërsa produktet e qëndrueshme për konsum të gjërë dhe produktet e përpunimit ushqimor janë nën 18 %.


Shpërndarja e produkteve të eksportit, sipas veprimtarive ekonomike (grafikoni 7.4), tregon se 90% e tyre janë produkt i industrisë të përpunimit, 4 % janë produkte bujqësore, ndërsa veprimtaritë shërbyese janë të papërfillshme sipas vëllimit. Faktikisht, shërbimet e eksportit në Maqedoninë e Veriut nuk shënohen në statistikën zyrtare. Nga ana tjetër, në kuadër të industrisë të përpunimit (grafikoni 7.5), dominojnë produktet kimike (pothuajse 25 %), pastaj vijnë pjesët për mjetet motorike (15 %), pjesët për makineri dhe pajisje (pothuajse 13,4%) dhe veshjet (7 %, që është eksport i produkteve të tekstitit të përgatitura në të ashtq. "lon-bazë"), produktet ushqimore dhe mobiljet marrin pjesë me mbi 4 % ndërsa të gjithë veprimtaritë tjera janë pothuajse të papërfillshme. Apo, pjesëmarrja në vetëm tre grupe të produkteve (pjesë për katalizator, centrifuga dhe kablllo elektrike), përbëjnë 30 % nga eksporti i përgjithshëm.

**Grafikoni 7.3.**  
Eksporti i Maqedonisë së Veriut sipas kategorive themelore të prod në vitin 2019.



Vërejtje: Produktet me pjesëmarrje < 0,5% nuk janë të paraqitur në grafikun  
Burimi: Enti shtetëror për statistika i RMV

**Grafikoni 7.4.**  
Produktet e eksportit të Maqedonisë së Veriut të klasifikuara sipas veprimtarive në vitin 2019 %




Vërejtje: Produktet me pjesëmarrje < 0,5 % nuk janë të paraqitura në grafikun.  
Burimi: Enti shtetëror për statistika i RMV

Të rëndësishme janë të dhënat e paraqitura në grafikonin 7.6., që paraqesin strukturën e kualifikimeve mesatare të punës të përmbajtur në produktet e eksportit të Maqedonisë së Veriut në vitin 2019<sup>13</sup>.

13 Këto të dhëna janë kalkulime personale të autorëve, dhe janë marrë me përdorimin e "skemës" për shpërndarjen e punës në pajtim me kualifikimin e saj mesatar me çrast përdoret për përdorim të të mirave dhe shërbimeve në veprimtaritë e caktuara. Me përdorimin e asaj "skeme" në bazë të të dhënave për produktet e eksportit të Maqedonisë së Veriut të klasifikuara sipas veprimtarive në vitin 2019 (grafikoni 4), janë marrë të dhënat për kualifikimet mesatare të punës të përmbajtura në produktet e eksportit të Maqedonisë së Veriut në vitin 2019. "Skema" për shpërndarjen e punës pas kualifikimit mesatar për veprimtaritë e ndara është ndërmarrë nga: Michael R. Peneder (2007), A Sectoral Taxonomy of Educational Intensity, Journal of Applied Economics and Economic Policy, 2007.


Fuqia punëtore me kualifikime të mesme (arsim të mesëm) ka pjesëmarrje më dominante në punën e angazhuar në prodhimin e produkteve të eksportit të Maqedonisë së Veriut, pjesëmarrje të konsideruar ka edhe fuqia punëtore me kualifikime të ulëta dhe shumë të ulëta (pa arsim dhe me arsim fillor), por e papërfillshme është pjesëmarrja e kualifikimeve të larta dhe shumë të larta. Nënkuptohe se, kjo është rezultat i mospërfshirjes të pjesëmarrjes të shërbimeve në eksportin nga Maqedonia e Veriut, megjithatë, kur kjo strukturë do të krahasohet me strukturën e kualifikimeve të fuqisë të përgjithshme punëtore në Maqedoninë e Veriut, del fakti se në shtet nuk ka shfrytëzim të mjaftueshëm të potencialit të përgjithshëm të fuqisë punëtore në përgatitjen dhe krijimin e produkteve të eksportit.

**Grafikoni 7.5.**  
Produktet e eksportit të Maqedonisë së Veriut janë nga industria e përpunimit në vitin 2019, në %



Vërejtje: Produktet me pjesëmarrje < 0,5 % nuk janë të paraqitura në grafikun.  
Burimi: Enti shtetëror për statistika i RMV

**Grafikoni 7.6.**  
Kualifikimet e punës të përmbytur në prod eksportuese të Maqedonisë së Veriut në vitin 2019, në %




Vërejtje: Prodhimet me pjesëmarrje < 0,5 % nuk janë të paraqitura në grafikun.  
Burimi: Enti shtetëror për statistika i RMV

Nga ana tjetër, kur vëzhgohet struktura e eksportit maqedonas sipas tregjeve të eksportit (grafikoni 7.7. dhe 7.8.), vërehet rritja e pjesëmarrjes në eksport në shtetet anëtare të BE – dhe mes tyre sidomos në Gjermani, ku pjesëmarrja në eksportin e përgjithshëm të Maqedonisë së Veriut në vitin 2019 arrin 48,7 % – në kurriz të asaj që bie pjesëmarrja e të gjithë tregjeve tjera, si dhe edhe më shumë pjesëmarrje në tregjet e 6-të shteteve nga “Ballkani Perëndimor”.

Të dhënat nga grafikoni 7.8. tregojnë se Maqedonia e Veriut, e analizuar sipas sektorëve të Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Tregtisë (KNSI) dhe sipas

tregjeve eksportuese, janë më të mëdha në shtetet anëtare të BE-së pothuajse në të gjithë kategoritë e produkteve (duke përfshirë edhe ushqimin dhe pijet dhe duhanin), përveç në korniza të kategorive të karburanteve minerale dhe vajërave shtazor dhe bimor (pjesëmarrja e përgjithshme e të cilave në eksport të Maqedonisë së Veriut është jashtëzakonisht e ulët), ku dominojnë tregjet nga “Ballkani Perëndimor”.


**Grafikoni 7.7.**  
Eksporti i Maqedonisë së Veriut sipas grupeve të shteteve në vitet 2012, 2015 dhe 2019 në %



Source: State Statistical Office of the RNM

Note: Products with share of < 0,5% are not indicated in the chart

**Grafikoni 7.8.**  
Eksporti i Maqedonisë së Veriut të KNSI dhe tregjet më të rëndësishme të eksportit në vitin 2019, në %



Vërejtje: Produktet me pjesëmarrje < 0,5% nuk janë të paraqitura në grafik.

Burimi: Enti shtetëror për statistika të RMV

Të dhënat e analizuar e vërtetojnë përfundimisht se, edhe krahas tendencës të përhershme të rritjes të eksportit, në rastin e Maqedonisë së Veriut nuk mund të flitet për realizim të suksesshëm të strategjisë për rritje ekonomike të bazuar në ekspansion eksportues, dhe se nuk shfrytëzohen të gjithë potencialet. Struktura e eksportit, si dhe dinamika e rritjes së të tij, është kryesisht e përcaktuar nga prurjet e investimeve të huaja direkte në shtet të cilat, punën dhe fitimin e tyre e bazojnë në çmimin relativisht të ulët të punës, si dhe në tatimet e ulëta (dhe të sheshta) në Maqedoninë e Veriut dhe transferi i teknologjisë nga jashtë vendi. Por, përfshirja e kompanive vendore në zinxhirët

e vlerave të investimeve të huaja direkte (IHD) është pothuajse e papërfillshme, që flet për mungesën e efektit të derdhjes të njohurisë dhe efektit multiplikativ nga tërheqja e IHD. Prandaj IHD në Maqedoninë e Veriut, sidomos ato nga zonat teknologjike-industriale, krijojnë deri në 50 % ng eksporti i përgjithshëm i shtetit, por në formimin e PBB kanë kontribut me rreth 2 %, kurse në punësim me rreth 3%.

Në fakt, përmes IHD realizohet një lloj i "eksportit" të fuqisë të lirë punëtore maqedonase, kurse vlera e re e krijuar nga prodhimi i gjeneruar nga IHD është nën 10 %. Nga ana tjetër, shteti mbetet në nivel të lartë

të specializimit teknologjik. Kompanitë vendore shfrytëzojnë teknologji relativisht të vjetëruara dhe nuk janë të përgatitura që të pranojnë teknologjitë e reja. Niveli i investimit në hulumtim dhe zhvillim dhe futja e produkteve të reja dhe teknologjitë janë në nivel jashtëzakonisht të ulët. Rrjedhimisht, tendencat në rritje të eksportit të Maqedonisë së Veriut nuk tregojnë për ndërtimin e shkallëzuar të shkathtësisë të qëndrueshme eksportuese konkurrenente të ekonomisë.

### 7.3. EKSPORTI NË EVROPËN JUGLINDORE DHE POTENCIALI PËR NDËRVEPRIM RAJONAL

Fokusi i shkëmbimit tregtar të jashtëm të Maqedonisë së Veriut duhet të ndryshojë, në drejtim të gjetjes të tregjeve të "reja", dmth tregje alternative eksportuese. Proces që është plotësues me të është përfshirja e kompanive vendore në zinxhirët rajonal të vlerave dhe tregu rajonal (i përbashkët). Tregu rajonal paraqet një potencial të madh për një dinamizim relativisht të shpejtë në eksportin e kompanive vendore në Maqedoninë e Veriut për këto dy arsye: e para, meqenëse në shkathtësinë konkurruese për plasimin e produkteve dhe shërbimeve eksportuese të kompanive maqedonase është më e madhe në raport me tregun rajonal sesa që është në raport me tregun e BE; dhe e dyta, meqenëse një pasojë e çrregullimit të rrjedhave ekonomike që ka sjellur pandemia aktuale, është çregullimi i zinxhirëve të vlerave të kompanive nga BE me kompani nga Kina dhe tregje të tjera më të largëta. Në kuadër të KE është në përpunim e sipër procesi i planifikimit të konstelacionit të tillë në të ardhmen, kurse hapësira e Ballkanit Perëndimor do të bëhet gjithnjë e më e rëndësishme si hapësirë për përhapje të ardhshme të IHD nga shtetet e BE, si dhe për ndërlidhje më të madhe të kompanive nga BP në zinxhirët e vlerave të kompanive nga BE.

Nga ana tjetër, dinamika e integritimit rajonal ekonomik të "Ballkanit Perëndimor" dhe në ato korniza edhe rritja të shkëmbimit rajonal të jashtëm-tregtar, është penguar fuqishëm nga disa faktorë. Së pari, një problem i madh për lidhjen më të fuqishme ekonomike dhe për formimin e zinxhirëve rajonal të vlerave të kompanive nga ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, por edhe me shtetet/ekonomitë tjera në rajon (shtetet nga rajoni që nuk janë anëtarë në BE) janë karakteristikat strukturore të këtyre ekonomive. Strukturat e ekonomive të shtetet e Ballkanit janë të ngjajshme për shkak të faktorëve shumë të ngjajshëm të sistemeve shëndetësore etj. rrjedhimisht, këto ekonomi janë më shumë konkurrenente mes tyre sesa plotësuese. Së dyti, dinamika e integritimit rajonal ekonomik gjithashtu pengohet nga agjendat politike aktuale (por asnjëherë të zgjidhura) të shteteve të caktuara nga rajoni, si dhe barrierat ekzistuese institucionale dhe procedurale për shkëmbimin e jashtëm-tregtar.

Çdo shtet ka ndërtuar "sistemin tij të rregullave dhe instituicioneve" për shkëmbimin e jashtëm tregtar, kurse bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe barazimi i tyre i ndërsjellë shumë shpesh pengohet për shkak të qëllimeve politike. Është fakt se mbrojtja doganore ndërmjet shteteve nuk paraqet problem të madh, kurse kohët e fundit është përmirësuar gjendja dhe në lidhje me korridoret transportuese (por jo edhe për transportin hekurudhor), por kjo tregohet si e pamjaftueshme. Si anekdotë njihet një "thënie": "shtetet e Ballkanit ndërtojnë korridoret transportuese që të munden kamionët e transportit të mallrave të arrijnë në kalimet kufitare më shpejtë dhe të kenë kohë për pritje më të gjatë".

Megjithatë, strukturat ekonomike ndryshojnë në pajtim me potencialet për përparim. Në këtë kuptim, të gjithë ekonomive nga Ballkani Perëndimor i pret një proces intenziv i ndryshimeve strukturore dhe përshtatjes. Krahas kësaj, në vijim e sipër është realizimi i procesit të ndërlidhjes rajonale ekonomike (në fillim si zonë e tregtisë të lirë, si union doganor, dhe përfundimisht si treg i përbashkët). E gjithë kjo flet se ky potencial për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Maqedonisë së Veriut nuk mund të mos përfillet, apo të vazhdojë të konsiderohet si diçka e rëndësishme dytësore, përderisa tregu i BE-së ka kuptim parësor.

### 7.4. KONKURRENCA PËRMES PËRFSHIRJES NË ZINXHIRËT E VLERAVE DHE ZHVILLIMIN TEKNOLOGJIK

Në pajtim me atë që është paraqitur në punim për rritjen e produktivitetit, realizimi me sukses i strategjisë zhvillimore të ekspansionit eksportues nënkupton *ndërtimin* e nivelit relativisht të lartë të specializimit në ekonomi, nivel relativisht të lartë të zhvillimit teknologjik dhe modernizim, dhe ndërtim të shkallëzuar të konkurrencës të nivelit relativisht të lartë dhe shkathtësisë konkurruese në korniza globale. Që të realizohet kjo, duhet të krijohen *përparësitë konkurruese të bazuara në fuqinë punëtore cilësore, përparimi teknologjik dhe inovacionet*. Por, meqenëse bëhet fjalë për ekonomi të vogël, mund të pritet se ky do të jetë rasti në një numër relativisht të vogël të sektorëve.

Në këtë kuptim, Maqedonia e Veriut nuk duhet të ndalet dhe të mbështetet vetëm në import të njohurive dhe teknologjisë, por kjo duhet të kombinohet me zhvillimin e njohurisë personale, inovacioneve, ndërlidhjes të kompanive vendore me zinxhirët të vlerave të IHD që kanë hyrë në Maqedoninë e Veriut dhe në zinxhirë kontinental të vlerave. Nga ana tjetër, duke patur parasysh strukturën ekzistuese të eksportit maqedonas sipas tregjeve (me dominim të madh në tregun e shteteve anëtare në BE) realizimi relativisht i shpejtë dhe cilësor i procesit të reformimit

dhe anëtarësimit të shtetit në BE do të jetë shumë i rëndësishëm. Ky proces, krahas vendosjes të "rregullave të reja të lojës ekonomike", do të sjellë deri te procesi i përmirësimit të cilësisë të institucioneve, gjithsesi edhe atyre që janë më të rëndësishme për realizimin e mirë dhe të drejtë të "rregullave të lojës ekonomike", dhe me këtë do të dinamizojë edhe zhvillimin ekonomik për rritje të eksportit.

## 7.5. EKSPORTI I SHËRBIMEVE – ASPEKTI I RËNDËSISHËM PËR STRATEGJINË ZHVILLIMORE

Ekonomia maqedonase ka strukturë specifike, në pajtim me të cilën një numër relativisht i madh i PBB vendor – rreth 40 % – krijohet në sektorin e shërbimeve prodhuese. Por, shërbimet në pjesën më të madhe, sipas përkufizimit bëjnë pjesë në të mira të pazëvendësueshme. Kurse një pjesë e vogël e tyre tregtohen jashtë kufijve të vendit. Njëkohësisht, edhe ajo pjesë të shërbimeve të cila tregtohen, nuk mundën lehtësisht të evidentohen në treguesit statistikor për shkak të natyrës të tyre të tregtisë e cila në pjesë të caktuar bën pjesë në ekonominë gri (ekonomia joformale), kurse pjesa tjetër zhvillohet në mënyrë virtuale përmes digjitalizimit dhe të ngjashme që në mënyrë shtesë e vështirëson evidentimin e tyre të saktë. Në këtë kuptim, ekzistojnë potenciale të cilat nuk janë të shfrytëzuara, dhe gjithsesi se mund të dinamizojnë procesin e ekonomisë përmes eksportit. Të gjithë këto mundësi duhet të nxiten në mënyrë sistematike nga ana e qeverisë (politika ekonomike).

## PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

Edhe krahas trendit të eskalimit të tensioneve tregtare në korniza botërore në vitet e fundit, proteksionizimi dhe luftërat tregtare nuk duhet të jenë përgjigja e distorzioneve nga integrimet tregtare, që mund të jetë jashtëzakonisht i dobishëm edhe për ekonomitë e vogla në zhvillim dhe ndjekësit teknologjik. Eksporti i Maqedonisë së Veriut shënon rritje të vazhdueshme, por pa ndikim përkatës/proportional mbi rritjen e PBB dhe pa shfrytëzimin e të gjithë potencialeve. Kjo rrjedh nga struktura specifike e eksportit që nuk ka potencial të kontribuojë drejtë realizimit të suksesshëm të strategjisë të rritjes ekonomike të bazuar në ekspansionin eksportues. Një nga hapat drejtë realizimit të asaj strategjie është ndryshimi, respektivisht zgjerimi i fokusit të shkëmbimit të jashtëm-tregtar të Maqedonisë së Veriut drejtë tregjeve "të reja", dmth tregje alternative eksportuese. Në këtë kontekst, tregu rajonal paraqet një potencial të madh për një dinamizim relativisht të shpejtë të eksportit të kompanive vendore në vend.

Në kohën e dominimit të njohurive dhe kapitalit intelektual, që ka imponuar globalizimi, zhvillimi i teknologjive të reja dhe rritja e konkurrencës, shtetet dhe firmat që drejtohen në rritjen ekonomike eksportuese-udhëheqëse, duhet të fokusohen në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e faktorëve të tyre endogjen të rritjes. Rritja e eksportit në shtetet anëtare të BE në të ardhmen duhet të bazohet në zhvillimin teknologjik dhe përfshirjen e zinxhirëve të vlerave të IHD, përderisa nxitja e eksportit nuk duhet të kufizohet vetëm në eksport të produkteve, por duhet të përfshijë të gjithë shërbimet eksportuese me çrast do të vijë deri te shfrytëzimi i potencialeve ekzistuese të pashfrytëzuara në vend.



## LITERATURA E SHFRYËZUAR

**Antràs, P., de Gortari, A. and Itshhoki, O.** (2017). Globalization, Inequality and Welfare, *Journal of International Economics*, No 108, pp.387–412.

**Constantinescu, C., Mattoo, A. and Ruta, M.** (2015). The Global Trade Slowdown: Cyclical or Structural?, *IMF Working Papers*, No 15/6, International Monetary Fund, Washington, DC.

**ECB** (2016). Understanding the weakness in global trade: what is the new normal?, *Occasional Paper Series*, No 178.

**Forbes, N. and Wield, D.** (2000). Managing R&D in technology-followers. *Research Policy*, 29(9), 1095–1109.

**Grossman, G. M. and Helpman, E.** (1991). *Innovation and Growth in the Global Economy*. Cambridge, MA: MIT Press.

**Gunnella, V. and Quaglietti, L.** (2019). The economic implications of rising protectionism: a euro area and global perspective. *Economic Bulletin Articles*, European Central Bank, vol. 3.

**Haugh, D. et al.** (2016). Cardiac Arrest or Dizzy Spell: Why is World Trade So Weak and What can Policy Do About It?, *OECD Economic Policy Papers*, No 18, OECD Publishing.

**Helpman, E.** (2004). *The Mystery of Economic Growth*. Cambridge, MA: Belknap Press of Harvard University Press.

**Michael R. Peneder** (2007), A Sectoral Taxonomy of Educational Intensity, *Journal of Applied Economics and Economic Policy*, 2007.

**Rodrik, D.** (2011). *The Globalization Paradox: Democracy and the Future of the World Economy*, W.W. Norton, New York and London.

**World Bank Group; World Trade Organization** (2015). *The Role of Trade in Ending Poverty*. Geneva: World Trade Organization. © World Trade Organization. <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/22081> License: CC BY-NC-ND 3.0 IGO."

## 8

# TRANSFORMIMI I SISTEMEVE TË MBROJTJES SOCIALE DHE SIGURIMIT SOCIAL NË AFAT TË MESËM

MAJA GEROVSKA-MITEV DHE MILLA CAROVSKA

## HYRJE

Ndryshimet shoqërore që përfshijnë struktura të ndryshuara ekonomike, sociale, demografike dhe familjare, në mënyrë të pashmangshme imponojnë nevojën për ndryshime edhe të sistemeve të mbrojtjes sociale dhe sigurimit social. Regjimet sociale të cilat janë përballur me vështirësi në përshtatjen e ndryshimeve strukturore në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, Esping-Andersen i ka quajtur "pejzazh i ngrirë", duke i referuar në ndërkohë situatave me statu kous dhe rigjeditetit të arranzhimeve në shtetet sociale kontinentale-evropiane (Esping-Andersen, 1996). Në prizmen e rrjedhave të ndryshuara shoqërore në dekadën e tretë të shekullit 21 dhe nevojat që ata kërkojnë, një pjesë e madhe e shteteve sociale sërish mund të quhen "pejzazh i ngrirë". Në fakt, përshtatja e sistemeve sociale duhet të jetë një proces i vazhdueshëm dhe nuk duhet të shihet vetëm përmes ndryshimeve të parametrave të dizajnit ekzistues. Strukturat e reja familjare, format e reja të punësimit, rreziqet e reja sociale, kërkojnë ndryshime të paradigmes, si dhe ndryshimin e logjikës të funksionimit të sistemeve të mbrojtjes sociale, respektivisht nga sistemi i "daljes të fundit" në sistem të "mbështetjes të parë", nga sistemi i reciprocitetit në sistem të plotësimit dhe nga sistemi kurativ në sistem parandalues social.

Përpyekjet reformuese në sistemet e mbrojtjes sociale dhe sigurimit social në Maqedoninë e Veriut ishin karakteristike si për fillimin e vitit 200 (inkuadrimi i sigurimit të financuar kapital pensional dhe invalidor, ndryshime në kohëzgjatjen e sigurimit në rast të papunësisë dhe të ngjajshme.), ashtu edhe në disa vite të fundit me ndryshimet dhe plotësimet e sistemit të mbrojtje sociale dhe fëmijërore (2019), më të cilin janë vendosur rregulla të reja (sh. Shtesa arsimore), është zgjeruar përfshirja dhe janë barazuar shkallët referente ndërmjet të drejtave të ndryshme me çfarë është përmirësuar barazia dhe trajtimi i kategorive të përdoruesve. Megjithatë, nevoja për ndryshimet e mëtutjeshme është e pashmangshme. Nëse shohim në afat të mesëm, sistemet e mbrojtjes sociale dhe sigurimit social në Maqedoninë e Veriut duhet të përjetojnë


transformim në drejtim të: përfshirjes të rreziqeve të reja sociale, përfshirjes të formave jo standarde të punësimit nga sigurimi social, rritjen e financimit dhe diversifikim të burimeve të financimit, zgjerim të universalitetit të të drejtave sociale, si dhe digjitalizim të mbrojtjes sociale dhe sigurimit social.

## 8.1. PËRFSHIRJA E RREZIQEVE TË REJA SOCIALE

Përfshirja e sigurimit social bazohet në mbulimin e rreziqeve të pritura sociale gjatë karrierës dhe jetës të njeriut, si: lindja, sëmundja, lëndimi në punë (sigurimi shëndetësor), përshtatja profesionale, papunësia (sigurimi në rast të papunësisë), invaliditeti, pleqëria (sigurimi pensional). Qasja e tillë tradicionale e "kursimit" për rreziqet sociale në masë më të madhe përfshin kompenzimin në para të rrezikut momental me të cilin përballlet personi i siguruar. Por, duke marrë parasysh ndryshimet demografike të cilat ndodhin në lidhje me zgjatjen e jetëgjatësisë të njeriut, si dhe ndryshimet në tregun e punës në lidhje me numrin në rritje të formave "jotradicionale" të punës, sigurimi social përballlet me nevojën që të zgjerojë përfshirjen e grupeve sociale që mbulon, por edhe të rris pjesën në shërbime në vend të pagesave, si formë e sigurimit social.


Duke u nisur nga rrija e vazhdueshme e popullsisë të moshës mbi 65 vjet, që në periudhën e viteve 2010 – 2019 është rritur për 22,3 % (grafikoni 8.1.), si dhe nevoja e theksuar për mbrojtje afatgjate të kësaj kategorie që në periudhën 2010 – 2018 pothuajse tre herë është rritur (grafikoni 8.2.), është i pashmangshëm diskutimi për mundësitë për futjen e sigurimit për kujdes afatgjatë. Përvojat e vendeve evropiane tregojnë se pjesa më e madhe e shpenzimeve në para për kujdes afatgjatë financohen nga taksimi i përgjithshëm. Përgjithësisht nga kjo është Gjermania e cila ka kontribute të detyrueshme për kujdesin afatgjatë, ndërsa sistemet e Luksemburgut dhe Belgjikës/Flandrisë kanë kombinime të kontributeve dhe taksimit. Në Suedi, vetëqeverisjet lokale kanë të drejtë të vendosin dhe të vendosin

Grafikoni 8.1.  
Struktura e popullsisë sipas grupmoshave në Maqedoninë e Veriut



Burimi: Enti për statistika, viti 2020

Grafikoni 8.2.  
Institucionet dhe shfrytëzuesi i institucioneve/shtëpive për personat e moshuar në Maqedoninë e Veriut



Burimi: Enti shtetëtor për statistika, viti 2019

skema për kompenzime financiare për kujdesin afatgjatë (Spasova et al., 2018). Në Gjermani, e cila ka futur sigurimin për kujdes afatgjatë në vitin 1995, financimi (tradicionalisht) është ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet punëtorit dhe punëdhënësit dhe është 2,55 % në muaj nga rroga-bruto. Kjo mbulon shpenzimet për akomodim në institucion për kujdes afatgjatë. Ky lloj i sigurimit e preferon kujdesin në shtëpi të shfrytëzuesit apo, jetën me mbështetje. Megjithatë, në vitin 2017 reth një e treta e përdoruesve kanë jetuar në institucionin për kujdes afatgjatë, kurse prej tyre 50 % kanë qënë persona me demencia (Ministria Federale e Shëndetësisë, 2017). Ky shembull të përmbushjes të sfidave demografike ndiqet edhe nga Sllovenia, e cila, gjatë vitit 2020, pret miratimin e Ligjit për sigurim për kujdes afatgjatë. Me qëllim që të sigurohet burim stabil i financimit të shpenzimeve të rritura për kujdes afatgjatë, Sllovenia simulon më shumë skenare në raport me atë nëse sigurimi i ri do të jetë i detyrueshëm apo vullnetar dhe nëse do të rriten tatimet

apo do të ketë kontribut të rritur për sigurim social. Sipas vlerësimeve sllovene, ky lloj i ri i sigurimit do të kushtojë gjysëm miliard euro<sup>14</sup>.

Në Maqedoninë e Veriut, kujdesi afatgjatë është fragmentuar ndërmjet sistemit të mbrojtjes sociale dhe sistemit të kujdesit shëndetësor. Kjo ndarje nuk rezultoi me qasjen e integruar ndërmjet dy sistemeve dhe shumë shpesh shfrytëzuesit e të drejtave dhe shërbimeve për kujdes afatgjatë i realizojnë përmes procedurës të gjatë dhe të komplikuar, që kërkon vizitën edhe të qendrave për punë sociale edhe të institucioneve dhe komisioneve shëndetësore në varësi nga lloji i aftësisë të kufizuar apo sëmundjes. Ky dualizëm i sistemit për kujdes afatgjatë rezulton edhe me

14 Deklaratë për media e ministrit slloven të shëndetësisë Alesh Shabader: <http://www.rprogreso.com/slovenia-health-minister-assures-legislation-of-long-term-health-care-reform-to-address-the-needs-of-ageing-population.htm>

paqartësi në lidhje me shpenzimet për financimin e tij. Sipas Eurostatit, shpenzimet për aftësitë e kufizuara për vitin 2017 kanë qënë 1,7 % nga prodhimi i brendshëm bruto (PBB), ndërsa shpenzimet për kujdes shëndetësor 4,2 % nga PBB. Futja e kontributit shtesë për kujdes afatgjatë do të mund të përmirësonte jo vetëm transparencën e shpenzimeve, por edhe stabilitetin dhe diversifikimin e burimeve financiare për këtë dedikim. Gjithashtu, kontributi për kujdes afatgjatë do të siguronte, krahas mbrojtjes pensionale, respektivisht mbrojtjes materiale në pleqësi, mbështetje për shpenzimet për kujdes në shtëpinë e përdoruesve apo shpenzimet për akomodim në institucion. Kjo në mënyrë të konsideruar do të ndikonte edhe në përmirësimin e sigurisë sociale të personave të moshuar. Gjithsesi, inkuadrimi i kontributit të ri apo të rritur për sigurimin social për kujdes afatgjatë duhet të silltet në kontekst edhe të ngarkesës të tërësishme të shpenzimeve për fuqinë punëtore. Sfidat për inkuadrimin e tij në kontekstin nacional i referohen shkallës të ulët të punësimit (47,3 %), si dhe numrit të konsideruar të punësuarve joformal (15,7 %). Në mënyrë shtesë, debati në lidhje me modelin e politikës fiskale, e cila në pjesën e sigurimit social parasheh të bazuarin e tërësishëm të modelit të politikës tatimore, duhet të merret parasysh, me çrast nëse në afat të mesëm e njëjta është realizuar, pjesa e shpenzimeve për financim në kujdes afatgjatë duhet të projektohen në mënyrë përkatëse në zërat taimor. Duke patur parasysh përfitimet e tërësishme, të cilat përveç në nivel individual do të pasqyroheshin edhe në nivel të shkarkimit të detyrimeve familjare për sigurimin e mbështetjes të prindërve nga ana e fëmijëve të tyre, i cili detyrim në rastet e caktuara ekziston edhe ndërmjet të familjarëve tjerë, zgjerimi e sigurimit social me kujdes afatgjatë është i pashmangshëm që në afat të mesëm do të kontribuojë që Maqedonia e Veriut të plotësojë sistemin konservativ të kujdesit, të ketë sistem llogaridhënës dhe të diversifikuar të financimit dhe sigurimit të kujdesit afatgjatë, si dhe siguri të përforcuar sociale të popullsisë më e rritur.

Në mënyrë shtesë, sigurimi në rast të papunësisë gjithashtu duhet të jetë lëndë e zgjerimit, respektivisht për të shtuar mundësinë për shfrytëzimin e tij nga ana e të gjithë të punësuarve për të cilët është paguar kontribut, pavarësisht të arsyeve për paraqitjen e papunësisë. Sistemi aktual i sigurimit në rast të papunësisë ka dispozita që janë në konflikt me të drejtat të cilat rrjedhin nga procesi i punës. Në fakt, Ligji për punësimin dhe sigurimin në rast të papunësisë përkufizon se kompenzimi në para në rast të papunësisë nuk mund të realizohet, mes të tjerash, "personi i papunë të cilit marrëdhënia e punës është ndërprerë për shkak të: ndërprerjes me marrëveshje të marrëdhënies të punës, pushimit të marrëdhënies të punës me dorëheqje dhe mungesa pa arsye nga puna tri ditë me rradhë apo pesë ditë në vjet" (neni. 67, Gazeta zyrtare, nr. 124/19). Mënyra e tillë e trajtimit të papunësisë nuk përputhet me faktin se kontribu-

tet për sigurim në rast të papunësisë janë të paguara pavarësisht arsyeve për pushim të marrëdhënies të punës. Logjika e qasjes të tillë me siguri se rrjedh nga fakti se kontributet i paguan punëdhënësi, dhe jo personalisht punëtori, dhe rrjedhimisht mbrojtja në rast të papunësisë duhet të "meritohet" respektivisht fitohet nëse arsyeja për këtë nuk është drejtëpërdrejtë vet punëtori.

Realizimi i tillë konservativ i sigurimit në rast të papunësisë e bën pagesën e këtij kontributi të pakuptimtë. Masat më të reja për mbështetje të papunësisë si rezultat i Covid-19 përkohësisht kanë ndryshuar këto dispozita, dhe kështu të papunët mund të përfitojnë të drejtën e sigurimit në rast të papunësisë, pavarësisht nëse marrëdhënia e punës ka pushuar me marrëveshje apo me dorëheqje. Kjo masë e karakterit të përkohshëm është e nevojshme që të vendoset si një e drejtë e garantuar e kompenzimit në para në rast të papunësisë, që do të mund të realizohet pavarësisht arsyes të papunësisë. Në mënyrë shtesë, për shkak të faktit se Ligji për kontribute të sigurimit të detyrueshëm social nuk përkufizon si obligues për pagesën e kontributeve në rast të papunësisë, të vetëpunësuarit, bujqit, punëtorët sezonal, të njëjtët janë të përjashtuar nga mundësia për mbrojtje në rast të papunësisë përmes sistemit të sigurimit social. Një nga masat të cilat duhet të ndërmerren në afat të mesëm është hapja e sigurimit social edhe ndaj këtyre formave jostandarde të punësimit, si nga aspekti i integritetit të tyre në sistemin e pagesës të detyrueshme të kontributeve për sigurim në rast të papunësisë, ashtu edhe nga aspekti i mundësisë të pandërprerë për shfrytëzimin e tij (që është elaboruar më shumë në pjesën e ardhshme).

## 8.2. QASJE NË MBROJTJEN SOCIALE DHE SIGURIMIN SOCIAL PËR FORMAT JOSTANDARDE TË PUNËSIMIT

Në pajtim me përkufizimin e Organizatës ndërkombëtare të punës<sup>15</sup> nocioni formal jostandard i punësimit përdoret si ombrellë për arranzhimet e ndryshme për punësim që shmangen nga punësimi standard. Kjo përfshin punësimin e përkohshëm; punën me orar të shkurtuar dhe në thirrje; punë përmes agjencisë për punësime të përkohshme dhe marrëdhëniet e punës me shumë palë; si dhe punësim i fshehur dhe vetëpunësimi i varur.

Të dhënat për format jostandarde të punësimit në Maqedoninë e Veriut, në pajtim me Eurostat<sup>16</sup>, tregojnë se në vitin 2019, 16,2 % kanë qënë të vetëpunësuar, 13,2 % të punësuar me marrëveshje të përkohshme

15 Organizata ndërkombëtare e punës, <https://www.ilo.org/global/topics/non-standard-employment/lang--en/index.htm>

16 Eurostat, 2020: lfsa\_egaps; lfsi\_pt\_a

dhe 4,0 % të punësuar në orar jo të plotë të punës. Vetëpunësimi shënon një rritje të madhe nga punësimi standard me orar të plotë të punës, me çrast pjesa e bujqësisë në vetëpunësim është më e madhe. Në pajtim me analizat e Anketës të fuqisë punëtore, vetëpunësimi më së shpeshti nuk është rezultat i përzgjedhjes, por i mungesës të vendeve të paguara të disponueshme të punë. Më shumë është çështje e mbijetesës ekonomike që mund të vërehet edhe me faktin se shumica e të vetëpunësuarve jetojnë me të ardhura nën rrogën mesatare.

Duke ndjekur përkushtimet në nivel të Bashkimit Evropian, në kontekst të shtyllës Evropiane të të drejtave sociale, gjendja me qasjen formale-juridike, por edhe efektive në mbështetje sociale dhe sigurimin social për “të punësuarit jo-standard” në Maqedoninë e Veriut ka nevojë për përmirësim. Nga aspekti i qasjes formale në mbrojtje dhe sigurim social, personat e vetëpunësuar janë përfshirë në sigurimin e detyrueshëm social, të disponueshëm deri te të gjithë personat aktiv ekonomik. Përfshirë nga kjo është sigurimi në rast të papunësisë, me të cilin nuk janë të përfshirë personat e papunë (përveç atyre që janë të punësuar te personat e vetëpunësuar). Gjithashtu, ekziston rrezik në lidhje me bazën mbi të cilën arkëtohen kontributet për sigurim social. Në mënyrë shtesë, punëtorët e përkohshëm me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve fizike dhe/ose intelektuale (kontrata për shërbime për të cilat nuk janë të punësuar) janë të përjashtuar nga sigurimi pensional dhe invalidor, si dhe nga sigurimi në rast të papunësisë. Kontributet për sigurim shëndetësor janë të detyrueshme vetëm për ato punëtorë të përkohshëm të ardhurat e cilëve janë më të mëdha nga rroga minimale ligjore. Bujqit gjithashtu janë kategori e veçantë dhe janë të përjashtuar nga mundësia për pjesëmarrje në shtyllën e dytë pensionale, si dhe në sigurimin në rast të papunësisë.

Krahas mungesës të qasjes formale, për numrin e caktuar të të punësuarve në forma jostandarde të punësimit, realizimi i qasjes efektive në mbrojtje sociale dhe sigurim është vështirësuar në praktikë. Në fakt, shpeshherë, punëdhënësit nuk i respektojnë dispozitat ligjore për vazhdimin e kontratave në kohë të caktuar të cilët zgjasin pesë vite, në kontrata të përhershme të punës (përveç nëse nuk është përfshirë inspeksioni i punës), dhe qëllimisht ndërpresin kontratat e tilla para fundit në periudhën pesëvjeçare. Gjithashtu, punëtorët jostandard, shpeshherë përballen me vështirësi në përmbushjen e kushteve për përshatshmëri për marrjen e përfitimeve nga sigurimi social (për shembull për shkak të periudhave të ndërprerjes të kontributit). Në rastin e të vetëpunësuarve, problemet me realizimin e të drejtave shpeshherë lidhen me llogaritjen e vlerësimit të të ardhurave mbi të cilat paguhen kontributet sociale.

Duke marrë parasysh këto gjendje, është e nevojshme që të hapet sistemi i mbrojtjes sociale dhe sig-

urimit social deri te të gjithë format e punësimit, duke patur parasysh në ndërkohë hibriditetin e statuseve të tyre. Në këtë drejtim, krahas monitorimit efektiv dhe inspektimit të zbatimit të dispozitave për qasjen formale për të punësuarit jo-standard, është e nevojshme edhe përshtatja e kriterëve për qasje, lartësi dhe kohëzgjatje të kontributeve në pajtim me specifikat në lidhje me kohëzgjatjen e orarit të punës dhe karakteristikave të punës (e përkohshme, sezonale etj.).

### 8.3. RITJA E FINANCIMIT DHE DIVERSIFIKIMI I BURIMEVE TË FINANCIMIT TË MBËSHTETJES SOCIALE DHE SIGURIMIT SOCIAL

Edhe krahas perceptimit publik se shteti shpenzon shumë për mbështetjen sociale, megjithatë, analizat, sidomos të krahasuara me vendet nga rajoni dhe më gjërë, tregojnë se sipas ndarjeve për mbështetjen sociale, Maqedonia e Veriut është klasifikuar si pjesë e grupit të shteteve nga Evropa Qëndrore dhe Lindore me konsum të vogël (Spasova and Ward, 2019). Krahasuar me shtetet e rajonit, shpenzimet për mbështetjen sociale në Maqedoninë e Veriut janë më të ulëta në raport me ato të Kroacisë (21,2 %), Serbisë (19,1 %), Bosnjës dhe Hercegovinës (17,8 %) dhe Malit të Zi (16,8 %) <sup>17</sup>. Siç mund të shihet edhe nga grafikoni 8.3., në pajtim me metodologjinë ESPROS <sup>18</sup>, shpenzimet për mbrojtjen sociale në vitin 2017 kanë qënë 14,3 % nga PBB dhe të njëjtat kanë përjetuar ndryshime të konsideruara në periudhën 2015 – 2017. Pjesë më të madhe në shpenzimet për mbështetjen sociale kanë pensionet, ndërsa pjesë më të vogël janë shpenzimet për strehim, papunësi, dhe përjashtim social.


Në drejtim të përballjes efikase me sfidat kryesore sociale, si papunësia, varfëria, përjashtimi social etj., nevojitet rritja e shpenzimeve për mbrojtjen sociale, respektivisht atyre në fushën e mbrojtjes shëndetësore, aftësia e kufizuar, familjet/fëmijët, papunësia, strehimi dhe përfshirja sociale. Arritja e mesatares të shpenzimeve për mbrojtje sociale në nivel të BE-së (26,9 %) është joreale, por për këtë arsye ndarja për shpenzimet sociale ndërmjet 18 dhe 20 % të PBB në afat të mesëm duhet të jetë qëllim prioritar.

Në drejtim të ngjajshëm, nevojitet edhe diversifikimi i përmirësuar i burimeve të financimit të mbrojtjes sociale. Burimet dominante janë kontribute (8,5 % të PBB) dhe të ardhura tatimore (6,7 % nga PBB), përdirisa burimet tjera (kofinancimi, pjesëmarrja, sigurimi privat, etj.) janë të papërfillshme (0,3 % nga PBB) dhe nuk paraqesin një faktor të rëndësishëm në të ar-

17 Eurostat, 2020: spr\_exp\_gdp

18 ESSPROS – European System of Integrated Social Protection Statistics

Grafikoni 8.3.  
Shpenzimet për mbrojtjen sociale si pjesë nga PBB, sipas funksionit, % në Maqedoninë e Veriut dhe BE 27, viti 2017



Burimi: Eurostat, viti 2020

hurat e përgjithshme për mbrojtje sociale. Struktura e financimit të mbrojtjes sociale është ndërruar në periudhën e viteve 2005 – 2017 në llogari të shpenzimeve të rritura publike, kryesisht si pasqyrim i reformave në lidhje me zvoglimin e shkallëve të kontributit për sigurim social, shpenzimet tranzitore për reformën pensionale, si dhe raporti i atyre që paguajnë kontribut dhe personat e siguruar. Përderisa burimet e të ardhurave pensionale dhe shëndetëore përfshijnë edhe kontribute dhe tatime, degët tjera të mbrojtjes sociale – psh., ndihma sociale, invaliditeti, mbrojtja fëmijërore, në mënyrë dominante financohen nga të ardhurat tatimore.

Në interes të përmirësimit të marrëdhënies kontribute – të ardhura tatimore në llogari të zvogëlim-it të të funditave, nevojitet shmangia e masave dhe politikave publike të cilat promovojnë lirim nga pagesa e kontributeve, si mënyrë për përmirësimin e konkurrencës të punës apo si masa të politikës aktive të punësimit. Masat e tilla janë të dëmshme për perceptimin publik në lidhje me rëndësinë e kontributeve sociale, si dhe për investimin në sigurinë sociale në përgjithësi. Në mënyrë shtesë, për përmirësimin e potencialit të burimeve të ardhshme të financimit për mbrojtjen sociale në afat të mesëm, nevojitet: futja shtesë e kontributeve sociale te kontratat për ushtrimin e përkohshëm të shërbimeve (të cilat aktualisht i nënshtrohen vetëm tatimit personal në të ardhura); formalizimi i shkallëzuar i punës jo të paraqitur me shkallë më të ulëta të kontributeve sociale; si dhe rritje të mbështetjes për pjesëmarrje në tregun e punës te gratë, sidomos atyre bashkësive etnike të cilat janë më pak të përfaqësuara siç janë ajo shqiptare, turke, rome etj.

#### 8.4. ZGJERIMI I UNIVERSALITETIT TË TË DREJTAVE TË MBROJTJES SOCIALE DHE FËMIJËRORE

Ndikimi më i gjërë i Covid-19 thekson nevojën për sisteme transformuese dhe përgjegjëse për mbrojtje sociale dhe fëmijërore. Mbështetja e siguruar përmes shërbimeve sociale dhe kompenzimet në para gjatë muajve të parë të krizës në Maqedoninë e Veriut, që përfshinte lehtësimin e kriterëve dhe kushtëzimin (kontrollimin e të ardhurave nga muaji i fundit në vend të tre muajve të fundit, përfshirjen e aktivizimit si kusht, lehtësimin e kriterëve për pronësi të pronës), kërkesa të thjeshtësuara administrative, metoda të ndryshme të komunikimit me klientët, duhet të paraqes normë të re dhe të vazhdojë pas krizës. Logjika themelore e kriterëve për qasje në pjesën më të madhe të të drejtave për mbrojtje sociale dhe fëmijërore në Maqedoninë e Veriut për një kohë të gjatë bazohet në përpjekjet që të shmangjet mashtrimi, keqpërdorimi dhe varësia ndërmjet klientëve. Rrjedhimisht, qasja në sistemin e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes të fëmijëve është “rezervuar” vetëm për më të rrezikuarit. Kriza aktuale e shkaktuar nga pandemia ka ofruar mundësinë për zëvendësim të asaj “logjike” të sistemit të mbrojtjes sociale dhe fëmijërore me qasje të bazuar në parandalim të rreziqeve, mbrojtje të kërkuarve dhe zgjerim të universalitetit të të drejtave të mbrojtjes sociale dhe fëmijërore.

Hapi fillestar në drejtim të zgjerimit të universalitetit mund të ndërmerret përmes universalitetit të qasjes në shtesën fëmijërore. Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (Gazeta zyrtare, 104/19) tashmë kanë filluar këtë proces, përmes ngritjes të pragut të të ardhurave, që ka mundësuar mbulimin më të gjërë të shtesave fëmijërore, respektivisht me shtesat fëmijërore dhe shtesat për arsim. Ndryshimi i

tillë i pragut të të ardhurave për rritjen e përfshirjes të shtesave fëmijërore prej 9.000 fëmijësh në vitin 2018 të pothuajse 20 000 fëmijëve deri në mes të vitit 2020. Megjithatë, shtesat fëmijërore dhe arsimore janë të bazuara në kontrollimin e të ardhurave, që u mundëson qasje vetëm në ato të ardhura më të ulëta. Futja e shtesës universale fëmijërore për të gjithë fëmijët nga lindja deri në moshën 18 vjeçare do të kishte efekte të disahershme, si: ndikimi domethënës mbi zvogëlimin varfërisë fëmijërore, qasshmëri të lehtë gjatë kohës të periudhave të krizave, si dhe zvogëlimin e stigmatizimit për përdoruesit e tij (që aktualisht ekziston për shkak të kontrollimit të resurseve – të ardhurat, prona dhe të ngjajshmëritë e ekonomive familjare që janë kërkues dhe përdorues). Në shtetet e BE-së, e drejta e tillë universale e shtesës fëmijërore ekziston në Austri, Lituani, Estoni, Finland dhe Gjermani.

Në lidhje me vendosjen e vlerës/lartësisë të shtesës universale për fëmijë, është shumë e rëndësishme që të mos vendoset një prag arbitrar. Raporti i fundit për shtesat universale për fëmijë (ODI/UNICEF, 2020) shqyrton tri qasje që konfirmojnë transferin: 1) në lidhje me linjën nacionale të varfërisë, (2) linjat ndërkombëtare të varfërisë dhe 3) në raport me të ardhurat mesatare apo konsumit të ekonomisë familjare. Në kontekstin tonë nacional, vlera e shtesës universale duhet të përcaktohet duke marrë parasysh lartësinë e rrogës minimale.

Në fakt, që të mos rrënohen nivelet e punësimit, lartësia e shtesës universale fëmijërore duhet të formohet duke marrë parasysh lartësinë e të drejtave të kombinuara të ndihmës në para nga mbrojtja sociale dhe fëmijërore, lartësia e tij e përgjithshme nuk duhet të jetë afër nivelit të rrogës minimale. Inkuadrimi i shtesës universale fëmijërore, gjithashtu, do të bëjë të panevojshme një pjesë të transfereve ekzistuese pro-nataliste në para, siç është shtesa për të porsalindurin, apo shtesa prindërore për fëmijën e tretë dhe të katërt. Në mënyrë shtesë, ai do të ishte në funksion të përforcimit të të drejtave të njeriut, pabarazisë më të madhe, si dhe besimit më të madh social.

Megjithatë, përderisa projektimet fiskale tregojnë se shpenzimet e nevojshme tejkalojnë përfitimet pozitive nga futja e shtesës fëmijërore universale, atëherë i njëjti mund të bazohet në pragun natyror, sipas të cilit do të kufizohej qasja e ekonomive familjare të kuintilit më të lartë të të ardhurave.

Qasja e tillë e pakushtëzuar është bazuar në të drejtat e njeriut dhe mund të promovohet edhe te një pjesë e të drejtave në ndihmë në para nga mbrojtja sociale. Ndhma e garantuar minimale (NGM) (Gazeta zyrtare, 104/19) që ka zëvendësuar ndihmën e mëparshme sociale në para, ofron një qasje më fleksibile, me atë që personat që janë kërkuar, nuk duhet të paraqiten paraprakisht në Agjencinë për punësim, ka siguruar pagesa më të larta të së drejtës dhe ka futur shkallët ekuivalente të cilat kanë përmirësuar barazinë ndërm-

jet përdoruesve të llojeve të ndryshme të ekonomive familjare. Megjithatë, si instrument kryesor për përballjen me varfërinë e të ardhurave, NGM ende është e "ndarë" ndërmjet ofrimit të mbrojtjes të të ardhurave dhe procedurave rigjide për përballjen me rreziqet sociale. Kërkesa e marrëdhënies reciproke nga shfrytëzuesi i NGM për kthimin e të drejtës të dhënë për shfrytëzimin e mbrojtjes materiale është pjesë e parimeve të inkuadruara me ndryshimet ligjore gjatë mesit dhe fundit të vitit 2000, të cilat kanë frenuar aktivizimin si kusht për përdorimin e të drejtës themelore të ndihmës në para nga mbrojtja sociale.

Të kuptuarit e tillë "neoliberal" të aktivizimit, që në vend si e drejtë është futur si kusht, nuk ka treguar efekte të veçanta në Maqedoninë e Veriut, dhe kështu kalimi i përdoruesve nga mbrojtja sociale në tregun e punës nuk është evident në mënyrë të konsideruar. Në këtë drejtim, është i nevojshëm që të kthet "moskushtëzimi" i NGM, përmes heqjes të aktivizimit si kusht për përdorimin e ndihmës në para nga sistemi i mbrojtjes sociale. Heqja e kushtëzimit nuk shënon se përdoruesit e NGM do të parandaloheshin nga shfrytëzimi i masës aktive për punësim, as se aktivizimi do të hiqet si detyrim në Ligjin për mbrojtje sociale. Përkundrazi, aktivizimi do të vazhdonte që të ofrohej përmes Agjencisë dhe Qendrave për punësim, ndërsa në Qendrat për punë sociale do të drejtoheshin përdoruesit drejtë mundësive për punësim. Thjeshtë, ndihma financiare përmes ndihmës të garantuar minimale nuk do të anulohet, nëse përdoruesi nuk ka mundësi për realizimin e aktivizimit.

Duke patur parasysh profilin arsimor të përdoruesve të NGM, qasja e tillë do të kontribuonte për shfrytëzimin real të masave aktive nga ana e përdoruesve të "punësuar" përballë këmbënguljes artificiale për aktivizimin e përdoruesve të cilët as që kanë bazën themelore arsimore (dhe për të cilët nevojitet investim më afatgjatë për trajnime dhe shkathtësi të punës), as që i kanë shprehitë e nevojshme të punës. Në mënyrë shtesë, me qasjen e tillë të sistemit të mbrojtjes sociale do të kthehej roli i tij primar i mbështetësit në vend të kontrolluesit, kurse në kurriz të kesaj, sistemet tjera si ai arsimor, i tregut dhe punës etj., do të përforconte rolin e tij në mbështetjen e qytetarëve me rrezik social dhe ekonomive familjare. Gjithashtu kjo pjesërisht do të zvogëlonte edhe punën administrative të Qendrës për punë sociale dhe do u mundësonte punëtorëve social të drejtë diskrecionale për përzgjedhje të llojit të mbështetjes që duhet t'u ofrohet përdoruesve të NGM, në pajtim me shkathtësitë dhe nevojat e tyre.

## 8.5. DIGJITALIZIMI I MBROJTJES SOCIALE DHE SIGURIMIT SOCIAL

Përdorimi i teknologjive të komunikimit në fushën e mbrojtjes sociale dhe sigurimit social në vend i referohet aktiviteteve të caktuara themelore, si për

shembull, përdorimi i softuerit të klientit për llogarinë mujore të arkëtimit të integruar të kontributeve, evidencën elektronike të orarit të punës, përdorimin e programit për përzgjedhje të adoptuesit përmes rrugës elektronike dhe të ngajshme. Portali nacional për e-shërbime është një fillim i mirë që ofron informata të kontaktit dhe dokumente të nevojshme për kërkuesit, por ende nuk ofron mundësi për e-paraqitje për përdorimin e shërbimeve të sistemit të mbrojtjes sociale dhe sigurimit social.

Efektet më të gjëra nga pandemia me virusin Covid-19 kanë sjellur në pikëpyetje modelin tradicional të ofrimit (fizik) të shërbimeve sociale dhe realizimin e të drejtave sociale. Në drejtim të përmbushjes të sfidave të reja në lidhje me këtë pandemi, si dhe në interes të ofrimit të diversifikuar të shërbimeve sociale dhe mbrojtjes sociale, një nga prioritetet në afat të mesëm duhet të jetë zbatueshmëria më e madhe e ofrimit digjital të mbrojtjes sociale dhe sigurimit social. Gjithsesi, prioriteti i tillë nuk shënon zvogëlimin e kontaktit të drejtëpërdrejtë fizik me klientët, por as që e shpërfill rrezikun e krijimit të përjashtimit shtesë social, respektivisht digjital të kategoritë e rrezikuara të cilat nuk mund të shfrytëzojnë platformat elektronike. Qëllimi i rritjes të digjitalizimit duhet të paraqesë plotësimin e shërbimeve ekzistuese dhe mbështetje dhe zbatimin e tyre të kombinuar, atje ku është e mundur.

Zgjidhjet digjitale në fushën e shërbimeve sociale, përfshijnë një diapazon të gjërë të mundësive siç janë: teste parandalues për vetëvlerësim të rreziqeve të caktuara sociale, diagnozë, terapi individuale dhe grupore, menaxhim të rasteve, matje të rezultatit, intervenime dhe komunikim. Mackrill dhe Ebsen (2017) duke analizuar teknologjinë digjitale në punën sociale me të rinjtë në komunitetin lokal, e drejtojnë shembullin me mjetin „MySocialworker“. Mjeti paraqet një sistem digjital që ka për qëllim që të ndërtojë urën ndërmjet të rinjve me rrezik social të moshës prej 15 deri në 23 vjet dhe punëtorëve të tyre social – udhëheqës të rastit dhe i njëjti ishte lëndë e testimit në tri komuna në Kopenhagen, Danimarkë në vitin 2017. Duke treguar kompleksitetin e punës sociale, si dhe nevojën për trajnim të vazhdueshëm për teknologjitë digjitale dhe aspektet e caktuara etike, Mackrill dhe Ebsen theksojnë se përmes aplikacionit, klientët mund të ndjekin mirëqënien e tyre, shprehinë e mira, çrregullimin e jetës të tyre, kënaqësinë nga shërbimet që i shfrytëzojnë në komunë, ndërsa, këto karakteristika i kanë ndihmuar punëtorit social që të vlerësojë rrezikun, përparimin dhe përdorimin e resurseve. Sistemi i aplikimeve gjithashtu mund të përdoret si mbështetje për ndryshimet dhe vetëndihmë, sespe mund të përkujtojë klientët për sjelljen pozitive dhe t’ju ndihmojë që të mendojnë në mënyrë më sistematike për atë se si realizohet jeta e tyre me ndjekjen e ndryshimeve. Sistemi i aplikimeve është gjithashtu mënyrë për komunikimin e perspektivës të klientit për jetën e tij në bazë javore që ndjek udhëheqësin e rastit.

Përvojat krahasuese tregojnë një zbatueshmëri të veçantë të zgjidhjeve digjitale në kujdesin për personat e moshuar, si në shtëpi, ashtu edhe në institucionet në të cilat janë përkujdesur. Në pajtim me analizat e Eurofaund (2020), si pjesë e projektit moduLAAR/Leichter Wohnen, që është realizuar nga viti 2012 deri në vitin 2015 në shtetin federal të Burgenland, Austri, 50 shtëpi të personave të moshuar (shumica e të cilëve kanë jetuar vet) ishin pajisur me sensor në banjo, në dyer dhe dritare, si parandalim nga fatkeqësitë dhe sistemi i lajmërimit. Këto shtëpi gjithashtu ishin pajisur me pajisje që japin përkujtues (për shembull, të marrin ilaçe) apo për ndërveprimin social. Si pjesë e këtij projekti, është zhvilluar sistemi i njohjes të ngjarjeve në shtëpi (Home Event Recognition System – HOMER) dhe platforma e ndërveprimit ndërmjet përkujdesësve dhe prindërve (OwnCloud).

Digjitalizimi i personave me rrezik social ofron mundësi më të mëdha për zbatimin e kësaj mbrojtje sociale dhe e njëjta përballat me rreziqe më të vogla të aspektit etik apo të aspektit të dehumanizimit të veprimtarisë. Platformat digjitale në fushën e sigurimit social mundësojnë përfshirjen më të lehtë të formave jostandarde të punësimit, por gjithashtu mund të rrisin transparencën e tregut, të zvoglojnë shpenzimet për transaksione dhe të ofrojnë mundësi të reja efikase dhe fleksibile për kompanitë, si dhe përmbushjen e dëshirave të individëve në lidhje me orët fleksibile të punës dhe profesionet e pavarura. Organizata ndërkombëtare e punës propozon formimin e sistemit digjital për sigurim social, për profesionet të cilat kalojnë kufijtë nacional, dhe që do të mund të udhëhiqej nga institucionet ndërkombëtare financiare. Sistemi i kontributeve sipas këtij propozimi do të bazohet në parimin e pagesës vijuese (pay as you earn), i cili më tutje në nivel vjetor do të paguhej në sistemet nacionale për sigurim social (Weber, 2018). Propozimi i tillë mund të mendohet që të lokalizohet, respektivisht në kuadër të sistemit ekzistues të sigurimi social të inkuadrohet në sistemin i cili do i referohej profesioneve dhe kontributeve të cilat paguhet në bazë të përqindjes fikse nga rroga e kontraktuar.

Të gjithë propozimet e përmendura për transformimin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe sigurimit social janë vetëm një pjesë e drejtimeve të mundshme dhe prioritetet e cilat rekomandohet që të ndërmerren në afat të mesëm në Maqedoninë e Veriut. Gjithsesi, zbatimi i tyre kërkon ekzistimin e mëparshëm të më shumë supozimeve, si psh: konsenzusi më shumë partiak për nevojën dhe pranueshmërinë e zgjidhjeve të përmendura në afat të mesëm, profesionalizimi i përforcuar në fushën e mbrojtjes sociale dhe sigurimit social, zero-tolerancë për ndikimet politike dhe punësimet politike, mjete financiare rreptësisht të dedikuara në nivel vjetor nga buxheti i shtetit, si dhe ndarjen e kompetencave më të mëdha të pushtetit lokal në ofrimin e shërbimeve dhe të drejtave në fushën e mbrojtjes sociale.



## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

**Esping-Andersen, G.** (ed.) (1996), *Welfare States in Transition: National Adaptations in Global Economies*, Sage: London.

**Eurofound** (2020) *Impact of digitalisation on social services*, Publications Office of the European Union: Luxembourg.

**Federal Ministry of Health, Germany** (2017) *Peer Review on "Germany's latest reforms of the long-term care system"* Brussels: European Commission.

**Mackrill, T. & Ebsen, F.** (2017): *Key misconceptions when assessing digital technology for municipal youth social work*, *European Journal of Social Work*, DOI:10.1080/13691457.2017.1326878

**ODI/UNICEF** (2020) *Universal child benefits: policy issues and options*. London: Overseas Development Institute and New York: UNICEF.

**Spasova S. and Ward T.** (2019). *Social protection expenditure and its financing in Europe, A study of national policies 2019*, European Social Policy Network (ESPN), Brussels: European Commission

**Spasova, S., Baeten, R., Coster, S., Ghailani, D., Peña-Casas, R. and Vanhercke, B.** (2018). *Challenges in long-term care in Europe. A study of national policies*, European Social Policy Network (ESPN), Brussels: European Commission.

**Weber, E.** (2018) *Setting Out for Digital Social Security*, Research Department Working Paper No.34, Geneva: International Labour Organization.

**Ligji për punësim dhe sigurim në raste të papunësisë**, Gazeta zyrtare, nr. 124/19

**Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve**, Gazeta zyrtare, nr. 104/19

**Ligji për mbrojtje sociale**, Gazeta zyrtare, nr. 104/19

## 9

## DREJTË NJË ARSIMI DHE SHKENCE MË TË MIRË

NIKOLA STIKOV, BRANIMIR JOVANOVIQ DHE DRAGAN TEVDOSKI

Në rrjetet sociale jemi shokuar me atë se arsimi është nën mesatare, por në bankat shkollore në vend të garës kërkojmë rrugë deri te pesa apo dhjeta e lehtë. Në shkencë publikojmë punime në revista predatore, kurse pastaj ankojemi se asnjë universitet maqedonas nuk mund të gjendet në 1000 më të mirët në listë të Shangait. Në konkurset e punës promovojmë meritokraci, por kur duhet të punësohet dikush me CV më të pasur, në skenë paraqitet nepotizmi dhe plutokracia. Që në moshë më të hershme i shmangim rregullat e lojës, dhe nuk është çudi që pastaj pengohemi kur do të vrapojmë në terren.

Ky tekst është një koleksion i sygjërimeve për atë se çfarë duhet të bëhet që arsimin jonë të filloj të krijojë mendje të shkolluara shkencërisht me potencial që të bëhet fuqi punëtore me kualifikim të lartë.

### 9.1. VLERËSIMI MË I DREJTË QË NË MOSHË TË VOGËL

Moeskzistimi i sistemit të drejtë të vlerësimit të sistemit arsimor maqedonas është arsyeja për shkak të së cilës kemi inflacion të notave, inflacion të diplomave dhe mosbesim të përgjithshëm në sistem.

Në botën ideale, notat nuk do të ekzistonin dhe të gjithë do të mësonim nga kureshtja dhe dëshira që të përmirësojmë shoqërinë. Meqënëse një përqindje shumë e vogël e popullsisë është udhëhequr nga këto motive, në çdo sistem ekziston lloji i shpërblimit që stimulon individët që të arrijnë rezultate. Edhe pse shumica prej nesh jemi mësuar me konceptin e 'bonusit' për punëtorët më të mirë në kompanitë private, apo promovimin e individëve të dalluar në administratë, kur dëshirojmë që këto parime të konkurrencës t'i promovojmë te më të rinjtë, këtë e bëjmë me nota, interpretimi i të cilave është problematik. Nëse notat ndonjëherë kanë qënë kriter për konkurrencë, vitet e fundit inflacioni i tyre ka kontribuar që të kemi më shumë nxënës tërësisht të shkëlqyer sesa që ekzistojnë vende të lira në gjimnaze (Maroska-Leova, 2019).

Problemi me notat në sistemin arsimor maqedonas është se nuk ekziston kriter i qartë për dhënien e tyre. Deklarativisht, ai që ka zgjidhur një përqindje të madhe të detyrës apo testit (më së shpeshti 90%) shpërblehet me pesë. Ajo që pesa nuk arrin të përfshijë është nëse detyra ka qënë e lehtë apo e vështirë, as nëse nxënësit tjerë gjithashtu kanë patur sukses që ta zgjidhin. Në kushte të tilla ka shumë gjasa që nxënësit të bashkëpunojnë që të mund të tejkalojnë barrierën për pesë. Një lloj i dëshiruar i bashkëpunimit është mësimi i përbashkët dhe ndarja e materialeve mësimore që të gjithë të marrin notën më të lartë. Një lloj i padëshiruar i bashkëpunimit është përshkrimi dhe gjetja e strategjive për të mashtruar arsimtarin.

Hulumtimet në të cilat krahasohet toleranca ndaj strategjive mashtruese në arsim, tregojnë se në vende lindore mashtrimi në sistemin arsimor tolerohet më shumë se në Perëndim (Magnus et al. 2002). Ekzistojnë shpjegime të shumta të mundshme për këtë fenomen, të cilat janë të lidhura me rregullimin kushtetues dhe me sundimin e ligjit. Megjithatë, një strategji e vlerësimit pothuajse pa përjashtim e zvogëlon përqindjen e mashtrimit, dhe ky është vlerësimi në të cilin nota e individit varet nga rezultatet e të gjithë klasës.

Ky lloj i vlerësimit quhet vlerësimi i lakores të Gausit. Supozimi kryesor është se në çdo grup më të madh të nxënësve, shpërndarja e njohurive është normale (Gaus), prandaj ata që dijnë më shumë se mesatarja, do të marrin notë më të lartë, kurse ata që dijnë më pak se mesatarja, do të marrin notë më të dobët. Në atë rast, detyra e arsimtarit nuk është që të përcaktojë se kush ka përmbushur kriteret për pesë, por vetëm të vendos se çfarë note do të marrin nxënësit mesatar dhe sa më e mirë duhet të jetë se mesatarja për të marrë notë mesatare. Strategjia e zakonshme është që 20 % e nxënësve të marrin pesa, 60 % të marrin katërsha dhe reth 20 % të marrin tresha apo më pak, por shpërndarja e notave është në duart e arsimtarit apo institucionit arsimor. Notimi respektivisht vlerësimi i tillë është pothuajse i pranishëm gjithandej në sistemet arsimore perëndimore dhe atë për disa arsye (secila prej tyre do të përpunohet më detajisht):

**a) Eliminohet rreziku që arsimtari të vendos kritere shumë të larta të cilat asnjë student nuk mund t'i përmbush**

Nëse arsimtarët vazhdimisht krijojnë detyra të reja, atëherë ata vështirë arrijnë që të kalibrojnë të njëjtat në nivel të nxënësve. Ndonjëherë detyrat janë të vështira, dhe nxënësit nuk mund të zgjidhin as gjysëm, ndonjëherë janë të lehta, dhe të gjithë kanë 100 %. Vlerësimi i lakores eliminon problemin e kalibrimit dhe inkurajon arsimtarët që të japin detyra më të vështira. Nxënësit nga ana tjetër, janë në presion që gjithmonë duhet të zgjidhin gjithçka dhe kjo u jep mundësinë që të jenë krijues.

**b) Nxënësit do të kenë tolerancë më të vogël ndaj mashtrimit**

Shkurtimisht, nëse një nxënës e din se do të marr pesë vetëm nëse është më i mirë se nxënësit tjerë, kjo do të ndikojë mbi vendimin e tij nëse do të tolerojë bashkëmohatarin që të mashtrojë apo të përshkruaj respektivisht kopjoje prej tij. Shumë institucione që e vlerësojnë lakoren e Gausit, janë aq të sigurtë në atë se nxënësit nuk do të mashtrojnë, miratojnë kodin e nderit (<https://communitystandards.stanford.edu/policies-and-guidance/honor-code>) dhe aspak nuk i mbikëqyrin nxënësit.

**c) Nxënësit stimulohen që të garojnë njëri me tjetrin dhe krijohet kultura e meritokracisë**

Ky është përfitimi më i madh nga vlerësimi i lakores. U jep mundësi atyre që janë ambicioz që të dëshmojnë dhe të përforcohen që të arrijnë rezultate më të mira. Rezultatet nuk duhet që të jenë gjithmonë publike, sepse ndonjëherë shpjegimi i tyre mund të jetë kundërproduktiv. Mjafton që nxënësi të dijë notën e tij dhe shpërndarjen e notave të të tjerëve, që të dijë si radhitet në krahasim me nxënësit tjerë.

**ç) Ana e errët e vlerësimit të lakores**

Një numër i madh i hulumtuesve konsiderojnë se sistemi arsimor duhet të jetë pa presion për një notë më të madhe dhe se arsytet për ekzistimin e notave janë më shumë ekonomike, dhe jo edukative (Fines 1996). Gjithashtu, është dokumentuar mirë se vlerësimi i lakores ndikon negativisht mbi pakicat dhe e çrregullon shëndetin mendor (Calsamiglia and Loviglio 2019). Gjithashtu, ky sistem funksionon mirë kur grupi është i vogël dhe homogjen (Dubey and Geanakoplos 2010). Përfundimisht, ky sistem bën që nxënësit nga shkollat më të dobëta të marrin nota më të larta krahasuar me atë të cilët mësojnë në institucionet prestigjioze.

Secila prej këtyre vërejtjeve është e vlefshme dhe pikërisht për këto arsye nuk mundet që brenda natës të vendoset sistem i ri i vlerësimit. Gjithmonë ekziston hapësira për qasje të kombinuara, në të cilin një pjesë e aktiviteteve vlerësohen në lakoren e Gausit, kurse një pjesë vlerësohen në shkallë absolute. Lakorja e

Gausit më së miri funksionon kur ka ndryshime edhe në mënyrën e testimit, dhe nxënësit inkurajohen që të shtrojnë pyetje dhe të jenë krijues në përgjigje.

Nga ana tjetër, vlerësimi i lakores të Gausit tashmë ekziston në sistemin maqedonas, por nxënësit nuk janë të vetëdijshëm për të. Çfarë është matura shtetërore nëse nuk është përpjekje për rradhitjen e të gjithë fillestarëve të mundshëm? Një pikë në rradhitje mund të jetë dallimi ndërmjet arsimit pa pagesë dhe pjesëmarrjes të shtrenjtë. A është më mirë që nxënësit të përjetojnë një shok të Gausit në fund të arsimit, apo gjatë 12 viteve ngadalë të përshtaten në faktin se të gjithë jetën do të krahasohen dhe vlerësohen në lakore? Nëse të gjithë pajtohem se duhet të përdorim vlerësimin e lakores në biznes, administratë apo sport, pse atëherë të mos mësojmë fëmijët që në moshë më të vogël se jeta është garë?

Në kushte të virusit korona, institucionet arsimore janë të detyruara që të qasen me metoda të reja të vlerësimit. Ministria e arsimit ka dalur me rekomandime për vlerësimin formativ që ka sjellur pakënaqësi te një pjesë e punëtorëve arsimor (Poprizova, 2020). Vlerësimi i lakores do të mund të plotësonte këtë vakum.


## 9.2. REZULTATET E VLERËSIMIT PISA

Rangimi respektivisht rradhitja PISA është projekt ndërkombëtar i OECD për vlerësimin e sistemeve arsimore në botë përmes testimit masiv të nxënësve 15 vjeçar në tri fusha: matematikë, shkencë dhe lexim. Siç thotë edhe vet emri, ky rangim është në fakt vlerësimi i lakores, vetëm se në këtë rast vlerësohet i gjithë sistemi arsimor, dhe jo nxënësit individual. Rezultatet maqedonase janë largë mesatares të OECD, kurse edhe më shumë shqetëson ajo se vetëm 2 % e nxënësve kualifikohen si nxënës që kanë përmbushur kriteret më të larta (top performers), për dallim nga 16 % në vendet e OECD (grafikoni 9.1.).

Në 15 vitet e fundit cilësia e arsimit bie në të gjithë nivelet, që mund të shihet nga rezultatet e përkeqësuar në matjet e standardizuara ndërkombëtare. Për shembull, testimi i klasëve të teta në kuadër të Trendeve për matematika ndërkombëtare dhe studime shkencore (TMNSSH), ka treguar rezultate më të këqija në vitin 2011 se në vitin 1999. Rezultati mesatar për matematik është zvogëluar nga 447 në 426, më i ulëti në vendet evropiane, kurse nxënësit që kanë arritur standardin minimal ("pika e poshtme referente ndërkombëtare") në matematikë kanë rënë nga 70 në 61 përqind. Trendi në shkencë është edhe më shqetësues, me rënie nga 73 në 53 përqind (Lameva dhe Ramadani, 2013).

Radhitja PISA pasqyron këto tendenca, kështu që në vitin 2015 reth 70 përqind e nxënësve 15 vjeçar nuk


Grafikoni 9.1. Rezultatet e PISA për nxënësve maqedonas përballë atyre nga OECD



Burimi: OECD (2019) PISA 2018 Database.


Grafikoni 9.2. Rradhitja e PISA për zotërimin themelor të matematikës dhe leximit

Rradhitja e PISA në njohjen bazë të matematikës dhe shkencës Shumica e studentëve maqedonas tregojnë rezultate që janë nën ato bazë në Matematike (Rezultatet e PISA, 2015)



Vërejtje: Bosnja dhe Hercegovina është përjashtuar nga mesatarja e Ballkanit Perëndimor.  
Burimi: Banka Botërore (2018) Pasqyra e financave publike në Maqedoninë e Veriut.

Rezultate nga PISA nga IRJ e Maqedonisë janë nën nivelin e pritit (Rezultate nga testimi PISA, 2015)



Vërejtje: Rezultatet nga matematika dhe shkenca tregojnë rezultate të ngjajshme  
Rezultate të bazuara në PISA (OECD) dhe SRP

kanë arritur njohje themelore të matematikës dhe leximit (OECD, 2019), rezultat në të cilin rradhitemi vetëm mbi Kosovën, kurse larg nga vendet tjera në rajon. Është shqetësues edhe dallimi i madh ndërmjet nxënësve më të mirë dhe më të dobët, kështuqë ata në kuintilin më të lartë kanë arritur rezultate sikur të kenë dv vjet më shumë arsim nga nxënësit në kuintilin më të poshtëm. Edhe pse numri më i madh i vendeve tregojnë rritje të rezultatit të PISA me rritjen e PBB, te ne nuk është ky rast (grafikoni 9.2.). Edhe pse PBB për kokë banori është rritur, rezultatet e PISA kanë rënë.

Është e vështirë të identifikohet një faktor për shkak të të cilit janë këto rezultate të dobëta. Një nga trendet shqetësuese është se përfundimi në kohë i arsimit fillor është në rënie, kurse regjistrimi në të gjithë nivelet e arsimit është më i ulët se në vendet tjera të ngjajshme. Madje edhe në moshën parashkollore, vetëm 55 % e fëmijëve në kuintilin më të pasur shkojnë në institucionin parashkollor, në krahasim me mbi 80 % në Serbi. Përqindjet janë ende shumë të ulëta për fëmijët e shtresave më të varfëra, dhe vetëm 0,3 % e fëmijëve të kuintilit më të varfër shkojnë në institucionin parashkollor.

Banka botërore vërteton rradhitjet e larta, dhe kështu në rradhitjen e vitit 2018 mund të vërejmë se Maqedonia e Veriut ndodhet nën mesataren botërore në aspekt të rezultateve nga testimet dhe efektiviteti i arsimit (learning-adjusted years of school). Edhe pse, fëmijët tonë në mesatare përfundojnë 11,2 vjet arsim deri në moshën e tyre 18 vjeçare, njohuritë e tyre përputhen me 6,8 vjet të kaluara në shkollë. Kjo do të thotë se hendeku i të mësuarit (learning gap) në Maqedoninë e Veriut është 4,4 vjet, për dallim nga shtetet e zhvilluar ku mesatarisht 'humben' rreth 2 vjet.

Edhe një problem është cilësia e programit mësimor. Në arsimin fillor në mënyrë të shpejte e futëm programin Kembrixh, por zbatimi është i vështirë për shkak të moskompatibilitetit të sistemit britanik të arsimit me resurset maqedonase.

Çfarë mund të bëhet që të ndryshohen këto trende?

**a) Futja e testeve të standardizuara në moshën e hershme**

Disa sisteme arsimore vendosin një theks shumë të madh në testet e standardizuara (Ozturgut 2011), por në thelb sa më herët fëmijët ekspozohen në sisteme të tilla të vlerësimit, më i vogël do të jetë presioni kur do të rriten. Shembujt me Kinën dhe SHBA nuk përputhen me mundësitë vendore, por mund të shërbejnë si pikë fillestare për standardizimin e qasjes maqedonase ndaj testimit të standardizuar.

**b) Ngritja e nivelit të arsimtarëve (kthimi i respektit në profesion)**

Duke filluar nga kopshtet, reputacioni i mësuesit do të duhej të ishte në nivel më të lartë, sepse kuadri mësimor nuk është shpërblyer mjaftueshëm për punën e tij. Në Republikën e Maqedonisë, Fakulteti Pedagogjik për një kohë të gjatë ka humbur prestigjin. Kemi inflacion të diplomave, kurse në kurriz të kësaj kemi deflacion të mendimit kritik. Një pjesë të kësaj ekziston edhe në shoqëritë e avancuara, por ata mund ta lejojnë këtë sepse kanë traditë të meritokracisë. Për ne është e nevojshme që të kthehet autoriteti dhe dinjiteti i profesionit mësues. Fakulteti pedagogjik duhet të jetë një nga institucionet më prestigjioze në shtet, kurse të diplomuarit e tij të jenë të paguhen mire dhe të respektohen. Vetëm kështu, nxënësit e tyre do të mësojnë të shprehen me shkrim, t'u qasen problemeve në mënyrë analitike dhe të mësojnë për njohuri, dhe jo për notë. Nëse punët në arsimin e ulët i vendosim në këmbë të shëndosha, do të kemi gjenerata të reja të përgatitura që të përballen me sfidat e kohës moderne.

**c) Theksi në mësimin digjital ndërveprues, shkrim-leximin shkencor dhe të menduarit kritik**

Arsimi ende na ka mbetur në shekullin e 20-të dhe i shfrytëzojmë pak resurset digjitale të cilat

i kemi në dispozicion. Ekziston një numër i madh i organizatave të cilat përqipen që të ndryshojnë këtë, megjithatë përpjekjet e tyre janë spontane dhe pa mbështetje insitucionale. Që të stimulohet të menduarit kritik, nxënësit duhet që nga moshë e vogël të ekspozohen në metodologji inovative mësimore, kurse këto metodologji, duhet të zhvillohen në bashkëpunim me shkencëtarët, bizneset dhe partnerët social. Një iniciativë e tillë është "Shkenca për fëmijët" ([naukazadeca.mk](http://naukazadeca.mk)), bashkëpunim ndërmjet mësuesve dhe shkencëtarëve qëllimi i të cilës është kultura shkencore dhe ushtrimi mendor. SHPF bashkëpunon me organizatën joqeveritare angleze (FuseSchool) dhe i përshat përmbajtjet mësimore pa pagesë në gjuhën maqedonase. Pastaj këto përmbajtje sinkronizohen në gjuhën maqedonase dhe ndahen përmes platformave elektronike (onlajn).

**ç) Ndarja më efikase e resurseve në arsim**

Rekomandimet më të rëndësishme të raportit të OECD për rritjen e konkurrencës në Evropën Juglindore janë që të rritet buxheti për arsimin fillor dhe të mesëm, sespe është larg nga mesatarja e vendeve si Çekia, Polonia dhe Sllovenia. Gjithashtu, rekomandohet në investim në zhvillimin e hershëm fëmijëror dhe në rritjen e rrogave të mësuesve (OECD, 2018).

Inkurajon fakti se nga viti 2015 deri në vitin 2018 është evidentuar përparim, por është e vështirë të besohet se për tre vite mund të vijë deri te ndryshimet e konsiderueshme në arsim. Është shumë më e besueshme se rezultatet më të mira janë pasqyrë e seriozitetit më të madh të MASH gjatë realizimit të testit.

Siç ekzistojnë kritika për vlerësimin individual të lakores, ashtu edhe shtrohet pyetja nëse rangimet e tilla duhet të jenë bazë për krijimin e politikave arsimore. Mesatarja gjithmonë i hekuros dallimet ndërmjet sistemeve dhe përqipet që të bashkojë disa parametra socio-ekonomik në një tregues të suksesit. Optimizimi i të gjithë sistemit përmes prizmit të një matjeje padyshim se çon drejtë/ligjit të Goodhardt që thotë se kur masa bëhet qëllim, atëherë ajo pushon që të jetë masë e mirë.

E megjithatë, në situatë kur arsimi uniformohet, kurse bota globalizohet, çfarë na mbetet përveç se të luajmë lojën të cilën e imponojnë lojtarët e mëdhenj? Rradhitja e PISA është larg nga e përsosura, por që të pushojmë të kujdesemi për të, në fillim duhet të kapim hapin, nëse jo me botën e zhvilluar, atëherë të pakën me vendet e rajonit. Vetëm kështu mund të bëjmë një hap përpara edhe në arsimin e lartë.

### 9.3. LISTA E SHANGAIT

Dy pikat e mëparshme ilustrojnë se arsimit fillor dhe i mesëm i vendos maqedonasit në një rol vartës në tregun global të punës. Për fat të keq, madje edhe ata që do të vendosin që të vazhdojnë me arsimin e tyre, janë në pozitë jo të favorshme.

Në vitet e fundit, rritja e numrit të universiteteve ka rezultuar me inflacionin e diplomave. Ky inflacion ishte pjesë e strategjisë nacionale që të kapet hapi me përqindjen e kuadrit me arsim të lartë në Evropë, por është shqetësuese se një pjesë e madhe e këtyre diplomave janë ndara në degë si biznes, administratë dhe drejtësi, të cilat nuk janë të lidhura me inovacion. Sipas rekomandimeve të Bankës botërore, arsimi i lartë duhet të shmang mospërputhjen e shkathtësive me atë që do i udhëzojë studentët drejt shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës (STEM), si fusha të cilat kanë potencial më të madh për inovacion.

Arsimi fakultetit te popullsia e tërësishme e aftë për punë (25 – 64 vjet) është përfaqësuar me 21 përqind, kurse te më të rinjtë (nga 25 deri në 34 vjet) vërejmë rritje deri në 32 % që na sjell afër mesatares evropiane prej 40 %. Ajo që këto numra nuk e përfshijnë është (mos) cilësia e arsimit të lartë. Për këtë do të duhet të kthehemi në rangimin e Shangait për universitetet, ku edhe universiteti maqedonas që është i ranguar më lartë (UKM) nuk mund të rradhitet në 1000 universitetet e para në vitin 2009 ishte në vendin 1568.

Edhe pse ekzistojnë edhe rradhitje tjera të universiteteve, lista e Shangait është veçanërisht e rëndësishme për ne, sepse MASH tre herë ka rradhitur universitetet maqedonase sipas metodologjisë të Shangait. Sipas kësaj metodologjie, 50 % e vlerësimit vjen nga cilësia e arsimit, 36 % vjen nga hulumtimet, kurse 14 % nga impakti shoqëror që e kanë universitetet (ARWU, 2020). Më poshtë janë disa analiza të gjendjes në secilën prej këtyre kategorive, me rekomandime konkrete si arrihet rradhitje më lartë për universitetet tona.

#### a) Rritja e cilësisë të mësimin

Me shumë gjasa dallimi më i madh në arsimin tonë të lartë është se përpqemi të trajnojmë kuadrin në të gjithë disiplinat shkencore. Shtetit të vogël i duhen pak universitete por cilësore. Nevojitet që të përcaktohen strategjitë nacionale dhe të shfrytëzohen burimet njerëzore të cilat i kemi në dispozicion. Këtu mendojmë për kuadrin e dëshmuar të profesorëve, por edhe në diasporën shkencore e cila punon në universitete të njohura botërore. Në këtë mënyrë do të mund të avancojmë arsimin e lartë në disa baza në lidhje me rradhitjen e Shangait.

Nga 13 kriteret e publikuara në metodologjinë e Shangait të lidhura me cilësinë e mësimin, ata që kanë pjesë më të madhe në rezultatin përfundimtar, janë

numri i profesorëve me shkallë më të lartë të arsimit dhe numri i profesorëve që kanë më shumë se një vjet përvojë ndërkombëtare.

Një masë që do i bashkonte kriteret e sipërme është përqëndrimi i kuadrit të cilësisë të lartë në një numër të vogël të programeve studimore dhe stimulimin e partneriteteve me institucionet e huaja përmes të cilave kuadri jonë mësimor do të përfitonte përvojë ndërkombëtare. Edhe pse në të kaluarën kishte përkushtime për krijimin e partneriteteve të tilla (janë nënshkruar memorandume për mirëkuptim me disa universitete të larta), ajo që na ka munguar, është ndërlidhja me diasporën tonë shkencore, e cila mundet më konkretisht të ndihmojë në krijimin e bashkëpunimeve.

Në mungesë të strategjisë shtetërore se si të shfrytëzohet diaspora shkencore maqedonase, një grup i shkencëtarëve i lidhur me bllogun Kantarot ([qantarot.blogspot.com](http://qantarot.blogspot.com)) bëri listën e shkencëtarëve maqedonas jashtë vendit. Lista çdo të mërkurë organizon takime shkencore në të cilat ftojme hulumtues të dëshmuar maqedonas. Për momentin punojmë në analizën e listës që të përcaktojmë se në cilat fusha kemi potencial më të madh arsimor. Së fundi, kjo listë do të jetë e shpallur publikisht dhe do të ftojme publikun që ta plotësojë.

Kjo listë do të luaj rol të dyfishtë: (i) do na bëjë me dije se cilët fakultete në Maqedoninë e Veriut ishin më produktive në edukimin e kuadrit të njohur botëror dhe (ii) do të hap dyert për bashkëpunim me shkencëtarët botëror me prejardhje maqedonase.

#### b) Avancimi i hulumtimit

Në metodologjinë e Shangait, punimet shkencore janë kriteri kryesor gjatë vlerësimit të hulumtimit, me çrast është e rëndësishme që të njëjtat të miratohen nga kolegët (peer-reviewed) dhe të indeksohen në Web of Science.

Ligji për arsim të lartë ka kaluar në përsëritje dhe ka shtrënguar kriteret gjatë përzgjedhjes të titujve në universitete, por përkufizimet për atë që kualifikohet si punim shkencor edhe më tutje janë fleksibile. Një numër i madh i shkencëtarëve maqedonas publikojnë punime në të ashtëquajtura revista predatore, dmth revista që nuk respektojnë rregullat e botimit shkencor (Danevska et al. 2016; Mehmeti, n.d.). Institucionet përpiqen që të ngrejnjë nivelin e punimeve shkencore me atë që do të ofrojnë shpërblime në para për ata që do të publikojnë punim në revistë me impakt faktor, por kjo është larg nga e mjaftueshmja.

Sipa indeksit të revistës Nature, shkencëtarët maqedonas figurojnë në vetëm 18 punime me impakt shumë të lartë në shkencat natyrore (Nature, 2020), kurse shumica prej tyre janë në listë falë asaj

që janë pjesë e ekipeve të mëdha ndërkombëtare. Rrjedhimisht vijon se mënyra më e mirë që të bëhet impakt është që të identifikohen fushat prioritare dhe të bashkëpunohet me shkencëtar të huaj nga këto fusha.

Virusi korona ka treguar se një pjesë a madhe e këtyre bashkëpunimeve mund të realizohen në distancë, dhe kështu pengesat për studentët dhe profesorët tanë do të jenë më të ulëta. Një pjesë e madhe e profesioneve STEM mundësojnë punë në distancë, kurse inovacionet teknologjike e bëjnë bashkëpunimin gjithnjë e më të lehtë. Kjo edhe është mënyrë e mirë që të mos mbingarkohen fondet shtetërore për stimulimin e shkencës, por të aplikohet për grante ndërkombëtare.

### c) Rritja e impaktit shoqëror

Në këtë kategori shqyrtohet se sa shkencëtarët fitojnë dhe i japin industrisë. Një kriter janë investimet e industrisë në kuadrin hulumtues përmes granteve, kurse tjetri është sa hulumtuesit krijojnë pronësi intelektuale përmes së cilës patentohen shpikjet e tyre. Është e qartë se ky zë është i dedikuar në mënyrë ekskluzive për fushat STEM, por ajo merr pjesë me 14 % në vlerësimin e përgjithshëm të universiteteve, dhe nuk mund të shpërfilllet. Lëshimi i patentave është procedurë e shpejtë që jo gjithmonë përputhet me impaktin social (Jaffe and Trajtenberg 2002; National Research Council et al. 2003), sidomos në vendet të cilat nuk kanë kulturë të fuqishme të pronësisë intelektuale. Nga ana tjetër, industria edhe atë si mund të ndihmojë shkencën, edhe përmes granteve të drejtëpërdrejta, edhe përmes promovimit të kulturës startup.

## 9.4. HULUMITMI DHE ZHVILLIMI

Ashtu siç duhet që individët të mësohen për garë të drejtë respektivisht fer me të tjerët, ashtu edhe shteti duhet të njoh fushat ku mundemi që të garojmë me pjesën tjetër të shtetit dhe të zhvillojmë strategjinë R&D respektivisht hulumtim dhe zhvillim e cila do të na bëjë më konkurrues në tregun e punës dhe do të na vendos në hartën akademike të botës.

Inovacionet, të përkufizuara si përmirësime të prodhimtarisë dhe futje të prodhimeve të reja, janë shumë të rëndësishme për rritjen e qëndrueshme të produktivitetit në ekonomi (Easterly and Levine, 2001). Megjithatë, Maqedonia e Veriut e vërteton paradoksin e inovacioneve: vendet në zhvillim investojnë më pak në inovacion se vendet e zhvilluara (Cireira and Maloney, 2017). Niveli i hulumtimitve themelore dhe të zbatueshme në Maqedoninë e Veriut është në nivel jashtëzakonisht të ulët. Shpenzimet bruto vendore për hulum dhe zhvillim (HZH) të katër sektorëve kryesor (kompanive, institucioneve qeveritare, arsi-

mi i lartë dhe organizatave joprofitabile) së bashku janë 0,36 % nga PBB në vitin 2017. Dhe, për krahasim me vendet e BE-së ndaj të cilave jemi përkushtuar, janë mesatarisht 2,13 % nga PBB në vitin 2017 (sipas Bankës Botërore, 2020).

Një nga shpjegimet për këtë gjendje është që Maqedonia e Veriut, si dhe pjesa më e madhe nga vendet tjera post-tranzitore nga Evropa, ka lloje të kapitalizimit të cilin Nölke and Vliegenthart (2009) e quajnë "ekonomia e varur e tregut". Në të, inovacionet ndodhin si transfere në kuadër të kompanisë tranzitore, që është ndryshe nga dy lloje të kapitalizimit (ekonomia liberale e tregut apo ekonomia e koordinuar e tregut) ku transferi i inovacioneve lëviz tregjet dhe ku rol të rëndësishëm luajnë investimet e përbashkëta dhe asociacionet afariste.

Prandaj, ndoshta problemi jonë më i madh nuk është që qëndrojmë prapa vendeve të zhvilluara, por se kemi nivel më të ulët të hulumtimit dhe zhvillimit të vendeve tona fqinje. Kështu, për shembull, shpenzimet e brendshme bruto për HZH të Serbisë janë 0,87 % të PBB dhe Bullgarisë 0,75 % në vitin 2017. Në tabelën 9.1 është prezantuar krahasim me disa nga rezultatet më të rëndësishme të procesit të inovacioneve me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Procesi i HZH mund të lëvizë përpara në Maqedoninë e Veriut nëse ndërmerren hapat në anën e ofertës dhe kërkesës të inovacioneve. Në anën e ofertës, lojtar kryesor janë universitetet, ku nevojitet përforsimi i kapitalit njerëzor për hulumtime shkencore. Hapi i nevojshëm që duhet të bëhet është që të përforsohen kriteret për përzgjedhje në tituj shkencor-mësimor me atë që ato do të bazoheshin në punimet e publikuara shkencore vetëm në revista me impakt-faktor. Kjo do të ndikojë mbi përmirësimin e efikasitetit të mjeteve të përdorura në sistemin nacional shkencor dhe do të mundosojë shpërblimin më të mirë me atë që me të vërtetë merren me shkencë.

Hapi i dytë i rëndësishëm është ndërlikohja e universiteteve me kërkesa të inovacioneve, respektivisht me ndërmarrjet. Një mjet i rëndësishëm që do të stimulojë ndërlikohje të tilla, me grante nacionale për projekte shkencore.

Politikat publike për mbështetje të zhvillimit të sipërmarrjeve duhet të japin prioritet për mbështetje për shpërblim të rezultateve të proceseve, në vend se të subvencionohen resurset (inputet) hyrës. Kështu për shembull, programet e Ministrisë të ekonomisë janë orientuar drejtë resurseve hyrëse në nivel të ndërmarrjes, si furnizim i pajisjes dhe mjeteve, llogo dhe identitet vizuel të produkteve apo shërbimeve, materialet reklamuese, dhe pjesëmarrje në panaire. Gjithashtu, nevojitet që politikat të koordinohen dhe vendosen ndaj një qëllimi të përbashkët. Me vite,

Tabela 9.1.

Rezultatet nga procesi i inovacioneve, Maqedonia e Veriut përballë Ballkanit Perëndimor, viti 2015. (numrat janë produkte absolute dhe të kuantifikuara, proceset e prodhimit, bashkëpunim me universitetet dhe shpenzimet bruto për HZH nga kompanitë private. Në të gjithë parametrat, Maqedonia e Veriut mbetet pas Ballkanit Perëndimor.)

Masa	Maqedonia e Veriut	Ballkani Perëndimor
Futja e produkteve të reja apo të përmirësuara në mënyrë të konsideruar në 12 muajt paraprak	49	58
Janë futur procese të reja apo të përmirësuara në mënyrë të konsideruar, apo ofrimi i shërbimeve në 12 muajt paraprak	37	50
Bashkëpunimi me universitetet për hulumtim dhe zhvillim apo projekte të zhvillimit teknologjik të produkteve të reja apo shërbimet e 3 viteve paraprake	8	17
Shpenzimet bruto dhe HZH nga firmat private	17	37*

Vërejtje: Ballkani Perëndimor: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. \*Mesatarja është vetëm për Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi dhe Serbinë (nuk ka të dhëna për Shqipërinë dhe Kosovën). Burimi: Banka Botërore (2018), fq. 153.

në Ministrinë e ekonomisë ka dhjetëra programe për përmirësimin e kapacitetit të ndërmarrjeve vendore, të cilat nuk janë të koordinuara në mënyrë përkatëse me iniciativat e Agjencisë për sipërmarrësi, Agjencisë për investime të huaja dhe nxitjen e eksportit dhe futjen e stimulimeve më të fuqishme tatimore për kompanitë që do të hapin qendra për HZH.

## 9.5. INVESTIMI NË ARSIM DHE SHKENCË

Mjetet që shteti i jonë investon në arsim në periudhën 2015 – 2018 ka qënë 3,7 % nga PBB, kurse Sllovenia 4,9 %.

Mjetet shënojnë një rënie të vazhdueshme në vitet e fundit, për shkak të dy arsyeve kryesore. E para është se në vitet e fundit ekziston trendi i zvogëlimit të buxheteve shtetërore. Konkretisht, buxheti shtetëror në vitin 2012 ka qënë 36 % i PBB, kurse në vitin 2018 ka rënë në 32 %. Arsyeja e dytë është realizimi gjithnjë e më i dobët i buxheteve të parapara për arsim. Konkretisht, në vitet 2017 – 2018 të paralizuara kanë mbetur 11 % nga mjetet e parashikuara për arsim, ndërsa në tetë vitet paraprake mosrealizimi ka qënë 6 %.

Vlerësohet se investimet e ulëta kanë ndikim mbi rezultatet e dobëta arsimore (OECD, 2019). Për më tepër, një e treta e shkollave në shtet kanë nevojë për rinovim të rëndësishëm (OECD, 2019).

Përveç se investimet janë të ulëta, edhe struktura e tyre vlerësohet si e pamjaftueshme. Sipas një studimi të publikuar nga Banka Botërore, mosefikasiteti i shpenzimeve për arsim të ne është reth 20 %, që është shumë më lartë nga vendet tjera nga rajoni (grafikoni 9.3.). E njëjta në Shqipëri është reth 7 %, në Kroaci dhe Bullgari reth 6 %, në Serbi reth 5 %. Janë të njohura shembujt për projektet e shtrenjta si "Kompjuter për secilin fëmijë" apo libra shkollor me CD. Në arsimin e lartë, shteti vazhdimisht shpenzon shumën më të madhë të parave për universitetet e reja që nuk sigurojnë asnjë cilësi.

Sa i përket investimeve në shkencë, Sindikati i parvarur akademik (SPA) së fundi publikoi "Analizën e financimit dhe disa gjendje në shkencë në Republikën e Maqedonisë së Veriut" (SPA, 2020). Nga analiza shihet se mjetet për shkencë në vitin 2018 janë 16 % më të ulëta nga ato në vitin 2010, pastaj pjesa e buxhetit për punën shkencore – hulumtuese në MASH në buxhetin e Maqedonisë së Veriut është shumë e ulët 0,04 %.

Rrjedhimisht, është e nevojshme që të rriten investimet në arsim dhe shkencë, edhe përmes rritjes të buxheteve shtetërore, por edhe përmes përmirësimit të realizimit. Në mënyrë shtesë, është e nevojshme që të përmirësohet efikasiteti i investimeve arsimore, respektivisht, të investohen mjete në projekte të menduara mirë.


## 9.6. FUNKSIONALITETI I INSTITUCIONEVE

Ne vazhdimisht theksojmë se investojmë pak në arsim dhe shkencë, kurse kur në buxhetin shtetëror do të sigurohen mjete për këtë, ata ose mbesin të pashfrytëzuara, apo shpenzohen në punë joproductive. Miratojmë strategji për zhvillim të arsimit, të cilat mbesin "shkrojnë e vdekur në letër", sepse institucionet nuk kanë kapacitete për t'i realizuar.

Ministria e arsimit dhe shkencës (MASH) ka miratuar "Strategjinë për arsim për vitet 2018 – 2025 dhe Planin e veprimit". Ky dokument në mënyrë të shkëlqyer dokumenton problemet në fushën e arsimit dhe shkencës – arsimin parashkollor, arsimin fillor, arsimin të mesëm, arsimin profesional dhe trajnimin, arsimin të lartë dhe hulumtimin dhe mësimin dhe arsimin e të rriturve. Dokumenti ofron edhe zgjidhje për tejkalimin e problemeve, të përpunuara në plane të veprimit, me afate për realizim. Megjithatë, përshtypja është se Strategjia nuk zbatohet. Deri tani është publikuar Raporti për aktivitetet e realizuara nga Strategjia vetëm për vitin 2018, kurse reformat më të rëndësishme nuk janë vërejtur ende.



Grafikoni 9.3.  
Pasqyra e efikasitetit të shpenzimit të mjeteve për arsim



Burimi: Pasqyra e OECD e evaluimit dhe vlerësimit të arsimit në Maqedoninë e Veriut

Shembulli me këtë Strategji në mënyrë të shkëlqyeshme ilustron ndoshta problemin më të madh në arsimin tonë, dhe ndoshta edhe në të gjithë shoqërinë – mosrealizimin e strategjive të përcaktuara, planet dhe programet. Ndërkohë, problemi nuk është vetëm në mungesën e vullnetit politik për realizimin e reformave të vështira, por edhe në mospasjen e kapaciteteve të institucionet.

MASH nuk ka kuadër të mjaftueshëm për çështjet teknike nga fusha e dizajnit, realizimit dhe vlerësimit të politikave të bazuara në dëshmi (evidence-based policy making). Nuk ka as infrastrukturë funksionale që mundëson një gjë të tillë, respektivisht nuk ka sistem funksional informativ. Ekziston Sistemi i menaxhimit me informatat në arsim (EMIS) që nga viti 2010, që duhet të përfshijë të gjithë institucionet arsimore – MASH, të gjithë agjencitë e saj dhe të gjithë shkollat fillore dhe të mesme në vend, dhe në të cilin duhet të grumbullohen, kontrollohen, përpunohen dhe publikohen të dhënat e shkollave, nxënësve, arsimtarëve dhe kuadrit tjetër. Megjithatë, siç është theksuar edhe në vetë Strategjinë, sistemi ka dobësi të shumta – të dhënat në të konsiderohen të pasakta, mungojnë njerëz që dijnë të punojnë me të dhe sistemi rrallëherë përdoret. Në departamentin e MASH që është përgjegjës për këtë sistem, ka vetëm dy të punësuar.

Agjencitë të cilat janë në përbërje të MASH, dhe të cilat duhet të sigurojnë, mes të tjerave, zhvillimin e arsimit, përshtatjen në arsim me nevojat e shoqërisë, inspektime të institucioneve arsimore, gjithashtu nuk kanë njerëz të mjaftueshëm, sidomos kuadër me shkathësi profesionale, që i pengon në ushtrimin e funksioneve të tyre të rëndësishme. Komunitat, të cilat janë kompetente për menaxhimin me shkollat fillore dhe të mesme, gjithashtu nuk kanë kapacitete të mjaftueshme njerëzore për këtë, as resurse financiare. Numri më i madh i

komunave ka vetëm një person përgjegjës për arsim, që është absolutisht e pamjaftueshme.

As vetë shkollat nuk kanë resurse të mjaftueshme dhe kuadër për realizim të suksesshëm të procesit arsimor. Arsimtarët kanë detyrime të shumta reth realizimit të përmbytjeve vëllimore mësimore, të cilat nuk mund t'i përshtasin, por duhet të realizojnë në përpikshmëri, dhe për këtë arsye nuk kanë kohë të mjaftueshme për punën individuale me nxënësit. Shkollat nuk kanë hapësirë dhe pajisje të mjaftueshme për realizimin e suksesshëm të mësimin. Edhe pse shkollat kanë shërbime të specializuara pedagogjike dhe psikologjike, ata shfrytëzohen vetëm në situatat e caktuara, dhe mësuesit zakonisht nuk kanë njohuri nga këto fusha, dhe për këtë arsye nuk mundin shpesh të përgjigjen në nevojat e nxënësve. Mësuesit shumë rrallë shkojnë në trajnime për zhvillim profesional dhe për këtë vendi është në fund të listës të vendeve në PISA.

Rrjedhimisht, që të mund të bëhen ndryshime thelbësore dhe të mëdha në arsim është e nevojshme që të zvogëlohen kapacitetet e institucioneve arsimore dhe të përmirësohet funksionaliteti i tyre.

## PËRFUNDIM

Rruga para nesh është e gjatë dhe e lodhshme. Është iluzore të mendohet se rekomandimet e sipërme do të realizohen brenda natës. Megjithatë, konkurrenca është çelësi i suksesi për arsimin dhe shkencën maqedonase, kurse kjo mund të arrihet me vlerësim të drejtë nga mosha më e hershme, rritje të prestigjit për arsimtarët dhe profesorët, dhe strategji nacionale për humlumtim dhe zhvillim. Nëse institucionet gjejnë mënyrë që të mbështesin të paktën një pjesë të rekomandimeve të theksuara më sipër, rezultatet do të vijnë vet.

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR


- ARWU (Academic Ranking of World Universities).** 2020. "Macedonian HEIs Ranking 2015–2016". Available at: [http://www.shanghairanking.com/Macedonian\\_HEIs\\_Ranking/Methodology-of-Macedonian-HEIs-Ranking-2015-2016.html](http://www.shanghairanking.com/Macedonian_HEIs_Ranking/Methodology-of-Macedonian-HEIs-Ranking-2015-2016.html), accessed on: 10/10/2020
- Calsamiglia, Caterina, and Annalisa Loviglio.** 2019. "Grading on a Curve: When Having Good Peers Is Not Good." *Economics of Education Review* 73 (December): 101916.
- Danevska, Lenche, Mirko Spiroski, Doncho Donev, Nada Pop-Jordanova, and Momir Polenakovic.** 2016. "How to Recognize and Avoid Potential, Possible, or Probable Predatory Open-Access Publishers, Stand-alone, and Hijacked Journals." *Prilozi (Makedonska Akademija Na Naukite I Umetnostite. Oddelenie Za Medicinski Nauki)* 37 (2-3): 5–13.
- Dubey, Pradeep, and John Geanakoplos.** 2010. "Grading Exams: 100, 99, 98,... or A, B, C?" *Games and Economic Behavior* 69 (1): 72–94.
- Easterly, William and Ross Levine** (2001). "What have we learned from a decade of empirical research on growth? It's Not Factor Accumulation: Stylized Facts and Growth Models". *World Bank Economic Review* Vol. 15, No. 2
- Fines, Barbara Glesner.** 1996. "Competition and the Curve." *UMKC Law Review* 65: 879.
- Jaffe, Adam B., and Manuel Trajtenberg.** 2002. *Patents, Citations, and Innovations: A Window on the Knowledge Economy.* MIT Press.
- Magnus, Jan R., Victor M. Polterovich, Dmitri L. Danilov, and Alexei V. Savvateev.** 2002. "Tolerance of Cheating: An Analysis Across Countries." *The Journal of Economic Education* 33 (2): 125–35.
- Maloney, William F. and Cirera, Xavier.** 2017. *The innovation paradox : developing-country capabilities and the unrealized promise of technological catch-up* (English). Washington, D.C. : World Bank Group.
- Mehmeti, Sami. n.d.** "The Practice of Predatory Publishing in the Academic Community in Macedonia." *CORRUPTION AND WHISTLEBLOWERS*, 101.
- National Research Council, Policy and Global Affairs, Board on Science, Technology, and Economic Policy, and Committee on Intellectual Property Rights in the Knowledge-Based Economy.** 2003. *Patents in the Knowledge-Based Economy.* National Academies Press.
- Nature.** 2020. "Nature Index", Springer Nature. Available at: <https://www.natureindex.com/country-outputs/macedonia>, accessed on: 10/10/2020.
- Nölke, A., and Vliegenthart, A.** 2009. "Enlarging the Varieties of Capitalism: The Emergence of Dependent Market Economies in East Central Europe". *World Politics*, 61(4), 670-702.
- OECD.** 2018. "Competitiveness in South East Europe: A Policy Outlook 2018", *Competitiveness and Private Sector Development*, OECD Publishing, Paris.
- OECD.** 2019. "North Macedonia – Country Note - PISA 2018 Results", OECD Publishing, Paris.
- Ozturgut, Osman.** 2011. "Standardized Testing in the Case of China and the Lessons to Be Learned for the US." *Journal of International Education Research (JIER)* 7 (2): 1–6. OECD (2019) PISA 2018 Database.
- Ламева, Бети и Решад Рамадани.** 2013. „Извештај за постигањата на учениците во Република Македонија : TIMSS 2011.“ Shkup: Qendra shtetërore e provimeve.
- Мароска-Леова, Вероника** (2019). Повеќе одлични ученици отколку места во гимназиите. Available at: <https://nezavisen.mk/povekje-odlicni-uchenici-otkolku-mesta-vo-gimnaziite/>. Accessed on: 10/10/2020
- НАКС (Независен академски синдикат).** 2020. „Финансиска транспарентност и отчетност во високото образование и науката во Република Северна Македонија“. Shkup: Sindikati i pavarur akademik.
- Попризова, Ана** (2020). Препораките за оценување на МОН се несериозни и ќе удрат по грбот на учениците и на наставниците. Available at: <https://www.fakulteti.mk/news/07042020/preporakite-za-ocenuvanje-na-mon-se-neseriozni-i-kje-udrat-po-grbot-na-uchenicite-i-na-nastavnicite>. Accessed on: 10/10/2020.
- Banka botërore.** 2018. „Постигнување посветла иднина за сите – Поранешна Југословенска Република Македонија – Систематска дијагностика на земјата“. Banka ndërkombëtare për ripërtitje dhe zhvillim /Banka botërore. nëntor 2018.
- Banka botërore.** 2020. Индикатори за развој на светот на Светската банка. E disponueshme në: <https://databank.worldbank.org/source/world-development-indicators>

# BIOGRAFIA E SHKURTËR E AUTORËVE DHE AUTOREVE




**Gligor Bishev**, është profesor në Fakultetin Ekonomik në Prilep, zëvendëskryetar i Dhomës ekonomike të Maqedonisë, dhe bartës i funksionit drejtor kryesor ekzekutiv dhe kryetar i KD të Bankës Shparkase Maqedoni. Është krijuesi i monedhës maqedonase dhe programet stabilizuese në vitet e 90-ta. Merr pjesë në reforma të sektorit financiar. DKE dhe kryetar i KD të Stopanka Banka SHA Shkup nga viti 2001 deri në vitin 2013, me çrast e transformon bankën në një institucion të shëndosh dhe fitimprurës. Ka publikuar mbi 300 punime, libra dhe artikuj

**Jane Bogoev** është ekonomist i punësuar në një nga institucionet më të larta zhvillimore ndërkombëtare në fushën e makroekonomisë, politikës fiskale dhe borxhit publik. Ka përvojë në rajone të ndryshme – Afrikë, si dhe në sektorin global për borxhin publik te vendet me zhvillim të ulët dhe të mesëm. Më parë ka qënë i punësuar në Bankën popullore të Republikës të Maqedonisë së Veriut në drejtorinë për hulumtim dhe drejtorinë për stabilitet financiar dhe rregullativë. Jane ka publikime ndërkombëtare në fushën e politikës fiskale dhe ka marrë disa mirënjohje. Studimet e doktoraturës dhe magjistraturës i ka përfunduar në Universitetin “Stradfordshir” në Mbretërinë e Bashkuar.



**Ivana Vučkova** është koordinatore e Fondacionit “Fridrih Ebert”, zyra në Shkup, ku udhëheq me portfolion e aktiviteteve nga fusha e ekonomisë, energjetikës dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Vučkova ka margjistruar në Programin për qeverisje ekonomike dhe zhvillim të Akademisë të OSBE, dhe paraqitet si autore apo bashkëautore e më shumë punimeve dhe botimeve nga fushat e përmendura, duke përfshirë edhe Doracakun e argumenteve për shoqëri të drejtë dhe ekologjike. Në kuadër të zhvillimit të saj profesional dhe personal, ajo përkushtohet për promovimin e politikave të drejta ekonomike, të cilat janë të qëndrueshme, dhe jo në dëm të mjedisit jetësor.


**Maja Gerovska-Mitev** është profesoreshë e rregullt pranë Fakultetit filozofik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Është përfshirë në mësim dhe hulumtim në fushën e politikës sociale, varfërisë, përfshirjes sociale dhe pabarazive sociale. Është zëvendës kryetare e komitetit shkencor-këshillëdhënës të programit të UNESCO “Menaxhimi me transformimet sociale” për periudhën e viteve 2020 – 2023. Është koordinatore nacional (MK) në Rrjetin evropian për politikë sociale të Komisionit Evropian.






**Marija Drenkovska** është ekonomiste-hulumtuese në Bankën Popullore të Sllovenisë, ku është anëtare aktive e grupeve të ekspertëve në kuadër të Sistemit Evropian për mbikëqyrje financiare. Studimet e magjistraturës dhe doktoraturës i ka përfunduar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Ljubljanes, ku ka punuar edhe si studiuese e doktoraturës dhe asistente. Përvojat e saj dhe interesat hulumtuese përfshijnë më shumë fusha nga ekonomia duke përfshirë ekonominë e rritjes, makroekonominë (me fokus të inflacionit dhe projeksionit të lëvizjeve të inflacionit), stabilitetin financiar dhe politikat makroprodente.

**Branimir Jovanović** është ekonomist për Ballkanin Perëndimor në Institutin e Vjenës për studimet ndërkombëtare ekonomike. Ka qënë profesor i ekonomisë në Institutin e shkencat shoqërore dhe humaniste në Shkup, këshilltar i ministrit të financave dhe hulumtues i Bankës Popullore. Ka doktoraturë nga "Tor Vergata" në Romë, Itali dhe magjistraturë nga "Stadfordhir" në Stouk-na-Trent, Britani e Madhe. Fusha të interesit i ka: pabarazinë, varfërinë, financat publike, tatimet politikat publike, të drejtat e punëtorëve dhe tema tjera të ngjajshme.




**Nikolla Popovski** është profesor i rregullt në Fakultetin e ekonomisë pranë Universitetit ndërkombëtar sllavjan "G.R. Derzhavin", në lëndët Financa Publike dhe Ekonomi në sektorin publik. gjatë karrierës të tij ka ligjruar edhe lëndë tjera nga fusha e ekonomisë teorike dhe zhvillimore. Ka publikuar katër libra shkollor universitar dhe tre libra shkencor si dhe mbi 50 punime profesionale dhe shkencore në revista ndërkombëtare dhe vendore, kurse ka marrë pjesë edhe në më shumë projekte shkencore dhe profesionale. Ka patur qëndrim studimor në universitetin Xhorxhtaun në Uashington. Ka qënë kryetar i Kuvendit të RM dhe ministër i financave në Qeverinë e RM.

**Nikolla Stikov** ka diplomuar dhe doktoruar në Universitein "Stenfor" në SHBA, kurse momentalisht është profesor i inxhiniersë biomjekësore në Universitein e Montrealit, në Kanadë. Ai udhëheq disa iniciativa ndërkombëtare për komunikim më efektiv shkencor në fushën e tij të hulumtimit (neurovizuelizimi dhe rezonanca magnetike), kurse njëkohësisht përkushtohet edhe për disponueshmëri më të madhe të shkencës për publikun e gjërë. Nikolla është profesor vizitues i FINKI nga viti 2017, dhe themelues i iniciativës "Kantarot" ([kantarot.mk](http://kantarot.mk)) dhe „Shkenca për fëmijët“ ([nzd.mk](http://nzd.mk)).



**Dragan Tevdovski** është profesor i rregullt në Fakultetin Ekonomik. Është autor i dy librave universitar dhe ka publikuar më shumë punime në revista prestigjioze shkencore. Është fitues i çmimit "Shkencëtari më i mirë i Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në fushën e shkencave shoqërore për vitin 2015", kurse është zgjedhur si një nga profesorët më frymëzues në Maqedoni në bazë të anketës të portalit Fakulteti. Ai ishte ministër i financave në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (vitet 2017-2019). Pas përfundimit të shkrimit të këtij publikimi, ai është këshilltar i drejtorit ekzekutiv të FMN.

**Vanço Uzunov** është profesor i rregullt në Fakultetin Juridik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në lëndët ekonomia e zbatuar dhe ekonomia e të drejtës. Ka marrë pjesë në më shumë projekte shkencore dhe të zbatueshme, kurse ka qënë edhe këshilltar për çështje ekonomike i qeverisë dhe presidentit të RMV. Ka patur qëndrime studimore në Universitetin e Kalifornisë në Berkli dhe në London School of Economics. Është autor i tri monografive, librit universitar dhe mbi 70 punimeve profesionale dhe shkencore.



**Mila Carovska** është emëruar për ministre të arsimit dhe shkencës në 30 gusht të vitit 2020. Në 8 muajt paraprak ka qënë zëvendëse e kryetarit të Qeverisë përgjegjëse për çështjet ekonomike dhe koordinim me resorët ekonomik, ndërsa në periudhën nga 1 qershori i vitit 2017 deri në 3 janar të vitit 2020 ka ushtruar funksionin e ministres të punës dhe politikës sociale.

Ka përvojë të zgjeruar në fushën e planifikimit strategjik për zhvillimin inkluziv dhe disa angazhime si eksperte nga fusha e politikës sociale dhe avancimit të barazisë gjinore dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, njohje të shkëlqyer të politikave nacionale dhe lokale dhe praktikave për përfshirjen sociale të grupeve të rrezikuara, si dhe përvojë afatgjate në krijimin dhe zbatimin e projekteve për përfshirjen e të njëjtave, përvojë në realizimin e analizave dhe hulumtimeve në terren.

## IMPRINT

Friedrich – Ebert – Stiftung, Zyra në Shkup  
Bul. "8 Shtatori" 2/2-5  
100 Shkup  
Maqedoni e Veriut

Personi përgjegjës  
Eva Ellerajt | Drejtore  
Telefoni: +389 2 3093 181 / - 182

[www.fes-skopje.org](http://www.fes-skopje.org)

Kontakti

[Contact@fes-skopje.org](mailto:Contact@fes-skopje.org)

**FRIEDRICH  
EBERT**   
**STIFTUNG**

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Fondacionit "Fridrih Ebert". Ndalohet përdorimi komercial i të gjithë vëllimeve të Fondacionit "Fridrih Ebert" (FES) pa pëlqim paraprak me shkrim nga FES

Përkthimi | lekturimi: Jetmir Ziba

Dizajni dhe vula

 **KONTURA**  
design, graphic projects  
and printing factory

---

*Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë studim shkencor nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e institucioneve dhe organizatave në të cilat punojnë autorët.*



## FOTOGRAFIA E MADHE: EKONOMIA MAQEDONASE NË PERIUDHË AFATMESME DHE AFATGJATE



Përzgjedhja e ekspansionit eksportues si strategji afatgjate zhvillimore do të thotë se ekonomia e shtetit nuk duhet të mbetet (vetëm) “ekonomi e vogël e hapur” por duhet shkallë pas shkalle të bëhet një ekonomi e integruar ndërkombëtare. Kjo nuk është aspak e njëjtë. Duhet të vijë deri te rritja e eksportit të mallrave, por edhe të shërbimeve me një komponentë më të madhe të vlerës të shtuar vendore.



Modeli i ardhshëm i zhvillimit ekonomik duhet të ketë qasje sektoriale në lidhje me tërheqjen e e IHD, në të cilin nuk duhet të mungojnë edhe kompanitë vendore. Ata duhet të përfshihen edhe në zinxhirët rajonal dhe ndërkombëtar të vlerave. Tregu rajonal (i përbashkët) paraqet një potencial më të madh për kompanitë vendore, ku ata demonstronë shkathtësi më të larta konkurruese në raport me nivelin evropian. Këtu janë edhe mundësitë të cilat hapen me rrjedhat e çrregulluara globale ekonomike si rezultat i pandemisë, dhe të cilat do të bëjnë këto hapësira me interes gjithnjë e më të madh për IHD nga BE, dhe do të kontribuojnë drejtë ndërlidhjes më të madhe të kompanive vendore në zinxhirët e përmendur të vlerave.



Nevojiten investime në avancimin e kualifikimeve të fuqisë ekzistuese punëtore dhe për të siguruar rritje të inovacioneve. Në këtë mënyrë, kompanitë maqedonase do të kenë sukses që të jenë ndjekësit e parë të liderëve teknologjik, që do të kontribuojë për përfshirjen e tyre më të lehtë në zinxhirët rajonal dhe ndërkombëtar të vlerave të kompanive të mëdha